

Fjalimi i Nobelit për Letërsinë, 7 dhjetor 2024

HAN KANG:

Drita dhe filli

Sa herë shkruaj një roman, duroj barrën e pyetjeve që lindin, jetoj brenda tyre. Mbërritja në fund të këtyre pyetjeve – gjë që nuk është njësoj si atëherë kur gjej përgjigjet e tyre – ndodh kur arrij në fund të procesit të shkruarit. Atëherë, nuk jam më siç isha kur fillova, dhe nga ajo gjendje e ndryshuar, filloj përsëri. Pyetjet e radhës vijnë, si hallka në zinxhir, ose si domino, mbivendosen, bashkohen dhe vazhdojnë, dhe mua më pushton emocioni i të shkruarit diçka të re.

Përktheu Granit Zela

SHËNIME MBI LIBRAT

Rasti i *Prillit të thyer* të Kadaresë dhe
i *Match Point* të Woody Allen

Kanuni: e ndal apo
e nxit gjakmarrjen?

Nga Mehmet Elezi

(Vijon nga numrin i kaluar)

(fq. 6)

Monografia shkencore e Ph.D.
Oltsen Gripshit: "Edi Rama:
neuroestetika e një artisti"

Nga Teuta Dhima

(fq. 9)

Vëllimi poetik i Mero Bazes

Vëllimi "Shi me baltë",
marrëdhënie simbiotike

poezi-pikturë

Nga Minella Aleksi

(fq. 10)

"Lulja e Vlorës": Kujtimet e një
gruaje hebreje në Shqipërinë e
mikpritjes dhe solidaritetit

Nga Dr. Dorian Koçi

(fq. 11)

Poetja Khosiyat Rustamova

Mund t'i humbasësh
njerëzit dhe duke i dashur

Nga Fatbardh Amursi

(fq. 17)

Romanit më i ri i shkrimtarit Viktor Canosinaj

"Çmimi i atdheut" –
një roman testament

atdhedashurie

Nga Behar Gjoka

(fq. 13)



Grafikë nga Ylli Harumi

Shënim mbi përkthimin italian të *Histori
njerëzish të zakonshëm* nga Ylljet Aliçka

Një humbës që të bën të
qeshësh dhe të qash. Shazivari
dhe logjika e kontradiktave

Nga Fabio M. Rocchi

(fq. 8)

Dy faqe nga botimi i parë
i "Komedisë Hyjnore" të
Dante-s zbulohen në Itali

(fq. 5)

ROLAND BARTHES

dhe antropologjia e
imazhit fotografik

Nga Xhyher Cani, Phd



(fq. 22)

In memoriam

LIRIKU I PAHARRUAR
MUSA VYSHKA

Poeti, mësuesi, pedagogu dhe studiuesi

Nga Enver Kushi

Një vit më parë, më 14 dhjetor 2023, në Tiranë, në periferi të lagjes "Ali Demi", u nda nga jeta një nga poetët e shquar të letërsisë shqipe, do të thosha liriku i madh i poezisë, por edhe prozatori, autori i shumë poezive e tregimeve për fëmijë, pedagogu i Letërsisë Shqipe në Universitetin e Elbasanit.

BIBLIOTEKË

Nuri Plaku

(fq. 14)

Kambanat janë ujkonja urbane

Shazim Mehmeti

(fq. 18)

Dimni asht, me një kambë n'mue

Dhurata Hoti

(fq. 19)

Ungjilli sipas meje

Ylli Pango

(fq. 20)

Dy tregime

Xhevair Lleshi

(fq. 21)

Endem nëpër re me tim bir

Arben Meksi

(fq. 24)

*Karikatura e së shtunës*TRAJTA TË KOMIKES
NDËR VAJET E MIRDITËS

Nga Viktor Gjokolaj

(fq. 12)

Vlerësime, shënime dhe disa kujtime nga
udhëtimet studimore dhe veprimtaritë shkencoreNdihmesa të prof. Jup Kastriotit
në lëmin e dialektologjisë dhe
të onomastikës shqiptare e

arbëreshe

(fq. 14)

Akademik Gjovalin Shkurtaj

Janarin e kaluar, ndërsa po sistemoja gjërat në qilarin e shtëpisë përpara një shpërnguljeje të afërt, hasa në një kuti të vjetër këpucësh. E hapa kutinë për të gjetur disa ditarë që datojnë që nga fëmijëria ime. Midis grumbullit të revistave, ishte një bllok, me fjalët "Libër me poezi" të shkruara me laps në pjesën e përparme. Blloku ishte i hollë: pesë fletë letre pak a shumë të formatit A5 të palosura në gjysmë dhe të lidhura me kapëse. Kisha shtuar dy vija zigzage nën titull, njëri rresht vijonte gjashtë centimetra nga e majta, tjetri anohej poshtë shtatë centimetra djathtas. A ishte një lloj ilustrimi kopertine? Apo thjesht një shkarravinë? Viti - 1979 - dhe emri im ishin shkruar në pjesën e pasme të kapakut, me gjithsej tetë poezi të shkruara në fletët e brendshme nga e njëjta dorë me shkrim të pastër dhe me laps si në kapakun e përparme edhe në atë të pasëm.

Tetë data të ndryshme shenjnin fundin e secilës faqe sipas rendit kronologjik. Rreshtat e shkruar nga vetja ime tetë vjeçare ishin shumë të pafajshme dhe të papërpunuara, por një poezi për prillin më kapi vështrimin. Ajo hapej me vargjet e mëposhtme:

Ku është dashuria?

Është brenda gjoksit tim që fort hov.

Çfarë është dashuria?

Është fija e artë që lidh zemrat tona.

Sakaq, më kthyen dyzet vjet pas, teksa më pushtuan kujtimet e asaj pasdite të kaluar duke sajuar bllokun. Lapsi i shkurtër dhe i fortë me kapakun që i mbulon majën, pluhuri i fshirjeve të gomës, kapësja e madhe metalike që e kisha marrë fshehurazi nga dhoma e babait tim. M'u kujtua se si pasi mësova se familja jonë do të zhvendosej në Seul, kisha një shtysë për t'i mbledhur poezitë që kisha shkarravitur në copëza letre, ose në cepat e blloqeve dhe fletoreve të punës, ose midis shënimeve në ditar, dhe t'i bëja bashkë në një vëllim të vetëm. M'u kujtua edhe ndjesia e pashpjegueshme e mungesës së dëshirës për të mos ia treguar askujt "Librin tim me poezi" pasi të përfundohej.

Përpara se t'i ktheja ditarët dhe bllokun ashtu siç i kisha gjetur dhe të mbyllja kapakun, i bëra një fotografi asaj poezie me celular. E bëra këtë e shtyrë nga ndjesia se kishte një vazhdimësi midis disa prej fjalëve që kisha shkruar atëherë dhe asaj se kush isha tani. Brenda gjoksit tim, në zemrën time që rreh. Mes zemrave tona. Është fija e artë që bashkon - një fije që lëshon dritë.

*

Katërmbëdhjetë vjet më vonë, me botimin e poezisë së parë dhe të tregimit tim të parë një vit më pas, u bëra Shkrimtare. Pas pesë vjetësh, do të botoja veprën time të parë të gjatë letrare, të cilën e kisha shkruar për afro tre vjet. Isha dhe mbetem e intriguar nga procesi i të shkruarit të poezisë dhe tregimeve, por shkrimi i romaneve për mua mbart një tërheqje të veçantë. Librat më kanë marrë pak a shumë nga një vit deri në shtatë vjet për t'i përfunduar, duke dhënë si shkëmbim pjesë të rëndësishme të jetës sime personale. Kjo është ajo që më tërheq te të shkruarit. Mënyra se si mund të thellohem dhe të ndalem në pyetje që ndiej se janë të domosdoshme dhe po aq të ngutshme, sa vendos ta pranoj kompensimin me atë që marr prej të shkruarit.

Sa herë shkruaj një roman, duroj barrën e pyetjeve që lindin, jetoj brenda tyre. Mbërritja në fund të këtyre pyetjeve - gjë që nuk është njësoj si atëherë kur gjej përgjigjet e tyre - ndodh kur arrij në fund të procesit të të shkruarit. Atëherë, nuk jam më siç isha kur fillova, dhe nga ajo gjendje e ndryshuar, filloj përsëri. Pyetjet e radhës vijnë, si hallka në zinxhir, ose si domino, mbivendosen, bashkohen dhe vazhdojnë, dhe mua më pushton emocionin i të shkruarit diçka të re.

Ndërsa shkruaja romanin tim të tretë,

Fjalimi i Nobelit për Letërsinë, 7 dhjetor 2024

HANG KANG:

Drita dhe filli

Përktheu Granit Zela

Vegjetaria, nga viti 2003 deri në vitin 2005, po merresha me disa pyetje të dhimbshme: A mund të jetë ndonjëherë një person plotësisht i pafajshëm? Deri në çfarë niveli mund ta refuzojmë dhunën? Çfarë ndodh me atë që refuzon t'i përkasë species së quajtur njerëzore?

Duke zgjedhur të mos hajë mish si akt refuzimi ndaj dhunës, dhe në fund duke refuzuar të gjitha llojet e ushqimeve dhe pijeve përveç ujit, me besimin se ajo është shndërruar në një bimë. Jonhje, protagonistja e *Vegjetaria*, e gjen veten në situatën ironike të përshpejtimin të shkruarjes drejt vdekjes me përpjekjet që bën për të shpëtuar veten. Jonhje dhe motra e saj Inhje, të cilët janë në fakt bashkëprotagonistët, bërtasin pa zë nëpër makthe dhe episode dërmuese, por në fund janë bashkë. E vendosa skenën e fundit në një ambulancë, pasi shpresoja që Jonhje të mbetet gjallë në botën e kësaj historie. Makina e ndihmës së shpejtë nxiton poshtë rrugës malore që gjarpëron ndërsa motra e madhe vështron ngultas nga dritarja se si shkëlqejnë qartë, si të rilindura, gjethet e lagura. Ndoshta në pritje të një përgjigjeje, ose ndoshta si mënyrë të

protestuari. I gjithë romani qëndron në një gjendje pyetëse. Duke parë ngultas dhe duke sfiduar. Në pritje të një përgjigjeje.

Bojë dhe gjak, romani që pasoi *Vegjetaria*-n, është vazhdim i këtyre pyetjeve. Ta refuzosh jetën dhe botën si akti refuzimi ndaj dhunës është e pamundur. Në fund të fundit, me nuk mund të shndërrohemi në bimë. Atëherë si ta vazhdojmë qëndresën? Në këtë roman të mistershëm, fjalitë me shkronja rmake dhe të pjerrëta ngjishen dhe përplasen, ashtu personazhi kryesor, i cili ka kohë që lufton me hijen e vdekjes, dhe rrezikon jetën për të provuar se vdekja e papritur e shoqes së saj nuk mund të ketë qenë vetëvrasje. Ndërsa shkruaja skenën e mbylljes, ndërsa e përshkrova duke u tërhequr zvarrë nëpër dysheme për të gjetur shtegun e daljes nga vdekja dhe shkatërrimi, po i bëja vetes këto pyetje: *A nuk duhet të mbijetojmë në fund? A nuk duhet që jetët tona të dëshmojnë për atë që është e vërtetë?*

Me romanin tim të pestë, "Mësimet greke", shkova edhe më tej. Nëse duhet të jetojmë në këtë botë, cilat momente e bëjnë të mundur këtë? Një grua që ka humbur të

folurit dhe një burrë që po humbet shikimin po ecin në heshtje dhe errësirë kur rrugët e tyre të vetmuara kryqëzohen. Doja të merrja pjesë në çastet prekëse të kësaj historie. Romani zhvillohet me ritmin e vet të ngadaltë përmes heshtjes dhe errësirës deri kur dora e gruas zgjatet dhe shkruan disa fjalë në pëllëmbën e burrit. Në atë çast të ndritshëm që zgjerohet në një përjetësi, këta dy personazhe zbulojnë pjesët më të buta të vetes. Pyetja që doja të bëja këtu ishte kjo: *A mund të ndodh që duke pasur parasysh aspektet më të buta të njerëzimit, duke përqafuar ngrohtësinë e pakundërshtueshme që qëndron aty, ne të mund të vazhdojmë të jetojmë në fund të fundit në këtë botë të përkohshme, të dhunshme?*

Pasi arrita në fund të kësaj pyetjeje, fillova të mendoj për librin e ardhshëm. Kjo ndodhi në pranverën e vitit 2012, jo shumë kohë pasi u botua *Mësimet greke*. I thashë vetes se do të shkruaja një roman që bën një hap tjetër drejt dritës dhe ngrohtësisë. Do ta mbushja këtë vepër jetë dhe të botëdashëse me ndjesi të ndritshme e të tejdukshme. Shpejt gjeta një titull dhe kisha shkruar njëzet faqe në variantin e parë, kur u detyrova të ndaloja. Kuptova se diçka brenda po më pengonte të shkruaja këtë roman.


*

Deri atëherë, nuk e kisha menduar të shkruaja për Gwangju -n.

Isha nëntë vjeçe kur familja ime u largua nga Gwangju në janar të viti 1980, afërsisht katër muaj përpara se të fillonin vrasjet masive. Kur hasa disa vite më vonë të kthyer me kokë poshtë në një raft librash "Librin me fotografi to Gwangju-s" dhe e shikova kur nuk kishte të rritur rrotull, isha dymbëdhjetë vjeçe. Ky libër kishte fotografi të banorëve dhe studentëve të Gwangju-s të vrarë me shkopinj, bajoneta dhe armë ndërsa i rezistonin fuqije të reja ushtarake që kishin orkestruar grushtin e shtetit. I botuar dhe shpërndarë në fshehtësi nga të mbijetuarit dhe familjet e të vdekurve, libri dëshmoi të vërtetën në një kohë kur e vërteta po shtrembërohej nga shtypja e rreptë mediatike. Si fëmijë, nuk e kisha kuptuar domethënien politike të atyre imazheve dhe fytyrat e shkatërruara u ngulitën në mendjen time si një pyetje themelore për qeniet njerëzore: *A është ky veprimi që bën një njeri ndaj tjetrit?* Dhe më pas, duke parë një foto të një radhe të pafund njerëzish që presin të dhurojnë gjak jashtë një spitali universitar: *a është ky veprimi që bën një njeri ndaj tjetrit?* Këto dy pyetje përplaseshin dhe dukeshin të papajtuësme, papajtuësmeria e tyre një një që nuk mund ta zgjidhja.

Kështu që një ditë pranvere të vitit 2012, teksa provova të shkruaja një roman rrezatues, që pohonte jetën, u përballa edhe një herë me këtë problem të pazgjidhur. Kisha humbur prej kohësh një ndjenjë besimi të rrënjësor thellë te njerëzit. Atëherë, si mund ta përqafoja botën? Më duhej të përballesha me këtë enigmë të pamundur nëse doja të ecja përpara, e kuptova. Kuptova se shkrimi ishte mjeti im i vetëm për t'u përballur dhe për ta tejkaluar atë.

E kalova pjesën më të madhe të atij viti duke skicuar linjat e romanit, duke imagjinuar se maji i vitit 1980 në Gwangju do të formonte një shtresë të librit. Në dhjetor, vizitova varrezat në Mangwol-dong. Kishte kaluar me kohë mesdita dhe vetëm një ditë më parë kishte rënë shumë borë. Më vonë, ndërsa drita u errësua, dola nga varrezat e ngrira me dorën mbi gjoks, afër zemrës. I thashë vetes se romani tjetër do të hidhte dritë drejtpërdrejt në Gwangju, në vend që të mjafohej duke e pasur si një shtresë të vetme e rrëfimit. Mora një libër që përmbante më shumë se 900 dëshmi dhe e lexova çdo ditë nëntë orë me radhë përgjatë një muaji. Kam lexuar çdo dëshmi



të përfshirë aty.

Lexova jo vetëm për Gwangju-n, por edhe për raste të tjera të dhunës shtetërore. Pastaj, duke parë edhe më larg dhe pas në kohë, lexova për vrasjet masive që njerëzit kanë bërë vazhdimisht në të gjithë botën dhe gjatë historisë. Gjatë kësaj periudhe të kërkimit për romanit tim, dy pyetje kryesore ishin më së shumti në mendjen time. Kur ishte në mesin e të njëzetave, kisha shkruar këto rreshta në faqen e parë të çdo ditari të ri: *A mund ta ndihmojë e tashmja të shkuarën? A munden të gjallët të shpëtojnë të vdekurit?*

Ndërsa vazhdova të lexoja, u bë e qartë se këto ishin pyetje të pamundura. Njëpërmjet kësaj përballjeje të vazhdueshme me aspektet më të zymta të njerëzimit, ndjeva se ajo që kishte mbetur nga besimi im i humbur për një kohë të gjatë te njerëzimi u shkërmoq plotësisht. S'kisha rruqë tjetër, veçse të hiqja dorë nga romani. Pastaj lexova shënimet e ditarit të një edukatoreje të re në një shkollë nate. Një i ri i ndrojtur dhe i qetë, Park Yong kishte marrë pjesë në "bashkësinë absolute" të qytetarëve vetëqeverisës që u formua në Gwangju gjatë kryengritjes dhjetëditore në maj të viti 1980. Ai u qëllua dhe u vra në ndërtesën pranë selisë së administratës provinciale ku kishte zgjedhur të qëndronte, pavarësisht se e dinte se ushtarët do të ktheheshin në orët e para. Atë natë të fundit, kishte shkruar në ditarin e tij: "Pse, o Zot, duhet të kem një ndërgjegje që më trazon dhe më dhemb kaq shumë? Unë dua të jetoj".

Duke lexuar këto fjali, e dija me qartësinë e vetëtimës se cilën rruqë duhej të ndiqte romani. Dhe se dy pyetjet e mia duhej të ktheheshin përmby. *A mund ta ndihmojë e shkuara të tashmen? A munden të vdekurit t'i shpëtojnë të gjallët?*

Më vonë, ndërsa po shkruaja atë që do të bëhej romani "Vepra njerëzore", në çaste të caktuara ndieva se e kaluara po e ndihmonte vërtet të tashmen dhe se të vdekurit po i shpëtonin të gjallët. I vizitoja herë pas here varrezat dhe në njëfarë mënyre moti do të ishte gjithmonë i kthjellët. I mbyllja sytë dhe rrezet portokalli të diellit më mbulonin qepallat. E ndieja si dritën e vetë jetës. Ndjeva se drita dhe ajri më mbështillnin me një ngrohtësi të papërshkrueshme. Pyetjet që mbetën me mua shumë kohë pasi pashë atë libër me fotografi ishin këto: *Si ka mundësi që njerëzit janë kaq të dhunshëm? E megjithatë, si është e mundur që ata mund t'i kundërvihen në të njëjtën kohë një dhune kaq dërrmuese? Çfarë do të thotë t'i përkasësh species së quajtur njeri? Për të negociuar një rruqë të pamundur përmes hapësirës boshe midis këtyre dy greminave të tmerreve njerëzore dhe dinjitetit njerëzor, më duhej ndihma e të vdekurve. Ashtu si në këtë roman, te "Vepra njerëzore", fëmija Dong-ho shtrëngon dorën e nënës për ta tërhequr atë drejt diellit.*

Natyrisht, nuk mund të zhbëja atë që u ishte bërë të vdekurve, atyre që kishin humbur njerëzit e dashur ose të mbijetuarve. Gjithçka që mund të bëja ishte t'u jepja ndjesitë, emocionet dhe jetën që pulsonte në trupin tim. Me dëshirën për të ndezur një qiri në fillim dhe në fund të romanit, e vendosa skenën e hapjes në gjimnazin komunal ku ndodheshin trupat e të vdekurve dhe ku u mbajtën shërbimet e varrimit. Atje, bëhemi dëshmitar se si pesëmbëdhjetë vjeçari Dong-ho mbulon me çarçafë të bardhë trupat dhe ndez qirin, duke parë ngultas zemrën e zbehtë blu të çdo flake.

Kur libri u përfundua dhe u botua përfundimisht në pranverën e vitit 2014, u befasona nga dhimbja që lexuesit rrëfyen se ndienin gjatë leximit. Më duhej të merrja pak kohë për të menduar se si ishin të lidhura dhimbja që kisha ndier gjatë gjithë procesit të shkrimit dhe shqetësimi që më kishin shprehur lexuesit e mi. Çfarë mund



të kishte pas këtij ankthi? Mos vallë duam të besojmë tek njerëzimi dhe kur ky besim lëkundet, ndihemi sikur po shkatërrohet vetja jonë? A është ajo që ne dëshirojmë ta duam njerëzimin dhe kjo është agonia që ndiejmë kur kjo dashuri shkërmoqet? A lind dashuria dhimbje dhe a është ndonjë dhimbje dëshmi e dashurisë?

Titulli korean i këtij romani është *Sonyeon-i onda*. Fjala e fundit "onda" është koha e tashme e foljes "oda", për të ardhur. Në momentin që Sonyeon, djali, i drejtohet në vetën e dytë si ti, qoftë intim apo më pak intim, ai zgjohet në dritën e zbehtë dhe ecën drejt së tashmes. Hapat e tij janë hapat e një shpirti. Ai afrohet gjithnjë e më shumë dhe bëhet tani. Kur një kohë dhe vend në të cilin mizoria dhe dinjiteti njerëzor ekzistonin në paralele të skajshme përmendet si Gwangju, ai emër resht së qeni një emër i përveçëm i vetëm për një qytet dhe në vend të kësaj bëhet një emër i zakonshëm, siç mësova duke shkruar këtë libër. Vjen tek ne - sërish dhe sërish nëpër kohë dhe hapësirë, dhe gjithmonë në kohën e tashme. Madje edhe tani.

*

Po atë vit në qershor, pashë një ëndërr. Një ëndërr në të cilën po ecja nëpër një fushë të gjerë ndërsa binte një borë e rrallë. Mijëra e mijëra trunqe të zeza pemësh ishin në fushë, dhe pas secilit trunq të fundit ishte një tumë varrimi. Në një çast, po shkëlja në ujë dhe kur shikova pas, pashë oqeanin që vërshonte nga skaji i fushës, të cilin e kisha ngatërruar me horizontin. Pse ishin ato varre në një vend si ky? pyesja veten. A nuk do të ishin fshirë të gjitha kockat në tumat e poshtme më afër detit? A nuk duhet të paktën t'i zhvendosja kockat në tumat e sipërme, tani, para se të ishte tepër vonë? Por si? Unë nuk kisha as një lopatë.

Uji kishte mbërritur tashmë deri në kyçin e këmbës. U zgjova dhe ndërsa shikoja nga dritarja ende e errët, kuptova se kjo ëndërr po më tregonte diçka të rëndësishme. Pasi shkrova ëndërrën, më kujtohet se mendoja se ky mund të ishte fillimi i romanit tim të ardhshëm.

Megjithatë, nuk e kisha një ide të qartë se ku mund të çonte, dhe e gjeta veten duke filluar dhe hequr fillimet e disa historive të mundshme që imagjinoja se mund të vinin nga ajo ëndërr. Më në fund, në dhjetor 2017, mora me qira një dhomë në ishullin Jeju dhe kalova dy vitet e ardhshme duke e ndarë kohën time midis Jeju dhe Seul-it. Duke ecur në pyje, përgjatë detit dhe në rruqet e fshatit, duke ndier motin e Jeju-s në çdo çast - erën dhe dritën e tij, borën dhe shiun - ndjeva se projekti i romanit bëhej më i kapshëm. Ashtu si me "Vepra njerëzore", lexova dëshmi nga të mbijetuarit

e masakrës, gërmova materiale dhe më pas, në një mënyrë sa më të përmbajtur që mundesha pa i hedhur sytë nga detajet brutale që ndieja se e kisha gati të pamundur t'i shprehja me fjalë, shkrova atë që u bë "Ne nuk ndahemi". Libri u botua gati shtatë vjet pasi kisha parë në ëndërr për ato trunqe të zeza të pemëve, për atë det të valëzuar.

Në fletoren që mbaja gjatë punës për atë libër, bëra këto shënime:

Jeta kërkon të jetojë. Jeta është e ngrohtë.

Të vdesësh do të thotë të ftohesh. Të kesh borë që të të bie mbi fytyrë në vend që të shkrihet. Të vrasësh do të thotë të ftohesh.

Njerëzit në histori dhe njerëzit në kozmos.

Era dhe rrymat e oqeanit. Rrjedha rrethore e ujit dhe ajrit që lidh të gjithë botën. Ne jemi të lidhur. Unë lutem që të jemi të lidhur.

Romani përbëhet nga tre pjesë. Nëse pjesa e parë është një udhëtim horizontal që ndjek rrëfimtaren, Kyungha, nga Seuli në shtëpinë e mikes së saj Inseon në malet Jeju përmes dëborës së madhe drejt zogut të shtëpisë që i është ngarkuar ta shpëtojë, kurse pjesa e dytë ndjek një rruqë vertikale që shpie Kyungha dhe Inseon në një nga netët më të errëta të njerëzimit - në dimrin e vitit 1948 kur civilët në Jeju u masakruan - dhe në thellësitë e oqeanit. Në pjesën e tretë dhe të fundit, të dy ndezin një qiri në fund të detit.

Ndonëse subjekti i romanit zhvillohet nga dy miqtë, ashtu si ata e mbajnë me radhë qiririn, protagonistin i vërtetë dhe personin i lidhur me Kyungha dhe Inseon është nëna e Inseon-ës, Jeongsim. Ajo e cila, pasi i mbijetoi masakrave në Jeju, ka luftuar për të rimarrë qoftë edhe një pjesë të eshtrave të të dashurit, në mënyrë që të mund të mbajë një ceremoni të denjë varrimi. Është ajo që refuzon të mos mbajë zi. Është ajo që duron dhimbjen dhe lufton kundër harresës. Nuk i jep lamtumirën. Duke u kujdesur për jetën e saj, e cila për një kohë të gjatë ishte me plot dhimbje dhe dashuri po aq të fortë dhe të madhe, mendoj se pyetjet që po bëja ishin këto: Deri në çfarë mase mund të duam? Ku është kufiri ynë? Deri në çfarë shkalle duhet të duam që të mbetemi njerëz deri në fund?

*

Tre vjet pas botimit të botimit korean të *Ne nuk ndahemi*, ende nuk kisha përfunduar romanin e radhës. Dhe libri që imagjinoja se do të pasonte më priste prej kohësh. Është një roman që lidhet zyrtarisht me "Libri i bardhë", të cilin e shkrova nga dëshira për t'i dhënë hua jetën time, për një kohë të shkurtër, motrës më të madhe që u largua nga bota vetëm dy orë pasi lindi, dhe gjithashtu për të depërtuar në pjesët tona që mbeten të pathyeshme pavarësisht se çfarë ndodh. Si gjithmonë, është e pamundur të parashikosh se kur do të përfundojë diçka,

por unë do të vazhdoj të shkruaj, sado ngadalë. Do t'i lë pas librat që kam shkruar tashmë dhe do të vazhdoj. Derisa të arrij në një ngushticë dhe të zbuloj se nuk ka më në rreshta që shfaqen. Për aq kohë sa të më lejoj jeta.

Ndërsa largohem nga ata, librat e mi do të vazhdojnë jetën e tyre të pavarur dhe do të udhëtojnë sipas fateve të tyre. Ashtu si ato dy motra, së bashku përgjithmonë brenda asaj makine të ndihmës së shpejtë ndërsa njëra sheh përflakjen e pemëve. Ashtu si gruaja, e cila së shpejti do të rifitojë aftësinë e të folurit, duke shkruar në pëllëmbën e burrit me gisht, në heshtje, në errësirë. Ashtu si motra ime që ndërroi jetë vetëm dy orë pas ardhjes në këtë botë, dhe si nëna ime e re që iu lut foshnjës së saj: "Mos vdis, të lutem mos vdis", deri në fund. Deri ku do të shkojnë ata shpirtra - ato që u bënë bashkë në një shkëlqim të thellë portokalli pas qepallave të mbyllura të syve të mi, që më mbështollën më atë dritë të ngrohtë e të papërshkrueshme? Sa larg do të udhëtojnë qirinjtë - ata të ndezurit në vendin e çdo vrasjeje, në çdo kohë dhe vend të shkatërruar nga dhuna e pamatshme, ata që mbahen nga njerëzit që zotohen të mos thonë kurrë lamtumirë? A do të kalojnë nga fitil në fitil, nga zemra në zemër, nëpërmjet një fijeje të artë?

*

Në bllokun që zbulova në kutinë e vjetër të këpucëve vjet në janar, vetja ime e kaluar, duke shkruar në prill të vitit 1979, e kishte pyetur veten:

Ku është dashuria?

Çfarë është dashuria?

Ndërsa, deri në vjeshtën e vitit 2021, kur u botua *Ne nuk ndahemi*, unë i kisha parë këto dy probleme si më thelbësoret:

Pse është bota kaq e dhunshme dhe e dhimbshme? E megjithatë si mund të jetë bota kaq e bukur?

Për një kohë të gjatë, besoja se tensioni dhe lufta e brendshme midis këtyre fjalive ishte forca shtytëse e të shkruarit. Nga romani im i parë deri te ai më i fundit, pyetjet që kisha mbajtur në mendje vazhduan të zhvendoseshin dhe të shpaloseshin, megjithatë këto ishin dy të vetmet që mbetën të përhershme. Por para dy-tre vjetësh, fillova të kisha dyshime. A kisha filluar me të vërtetë të pyesja veten për dashurinë - për dhimbjen që na lidh - pas botimit korean të *Vepra njerëzore* në pranverën e vitit 2014? Nga romani im më i hershëm dhe deri tek i fundit, a nuk kishte ndjekur gjithmonë shtresa më e thellë e kërkimeve të mia kahun e dashurisë? A mund të ndodhë që dashuria ishte në fakt kuptimi thelbi më i hershëm dhe më themelor i jetës sime?

Dashuria ndodhet në një vend privat të quajtur "zemra ime", shkruante fëmija në prill 1979. (*Është brenda gjoksit tim që hov.*) Dhe sa për atë që ishte dashuria, kjo ishte përgjigja e saj. (*Është fija e artë që lidh zemrat tona.*)

Kur shkruaj, përdor trupin tim. I përdor të gjitha detajet shqisore të të parit, të të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijimit, të përjetimit të butësisë, ngrohtësisë, të ftohtit dhe dhimbjes, vëzhgoj zemrën që rreh dhe trupin që ka nevojë për ushqim dhe ujë, ecjen dhe vrapimin, ndjesinë e erës, të shiut dhe borës në lëkurën time, teksa i mban në duar. Përpiqem t'i fut këto ndjesi të gjalla që ndiej si një qenie e vdekshme me gjakun që rrjedh nëpër trupin e tyre në fjalitë e mia. Sikur po dërgoj një rrymë elektrike.

Dhe kur ndiej se kjo rrymë po përcillet te lexuesi, habitem dhe prekem. Në këto çaste e përjetoj përsëri fillin e gjuhës që na lidh, procesin se si lidhen pyetjet e mia me lexuesit përmes asaj qenie të gjallë elektrike. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time më të thellë për të gjithë ata që janë lidhur me mua përmes këtij filli, si dhe për të gjithë ata që mund të vijnë për ta bërë këtë.

Një vit më parë, më 14 dhjetor 2023 në Tiranë, në periferi të lagjes "Ali Demi", u nda nga jeta një nga poetët e shquar të letërsisë shqipe, do të thoja liriku i madh i poezisë, por edhe prozatori, autori i shumë poezive e regjimeve për fëmijë, pedagogu i Letërsisë Shqipe në Universitetin e Elbasanit. Kam patur fatin ta njoh qysh para viteve '90 Musa Vyshkën, njeriun e veçantë, bisedat me të cilin kanë qënë dhe mbeten të paharruara në kujtesën time. Kur punoja në Muzeun Historik Kombëtar, ai vinte shpesh atje dhe sa herë ulëshim në një nga lokalet pranë këtij institucioni, lexonte poezitë e fundit, që kishte shkruar. Mbjaj mend gjithashtu edhe takimet e shpeshta me të, këto vite në Kryegjyshitën Botërore, ose në një lokal pranë shtëpisë së tij, diku në rrugën "Ali Demi". Musai dallohej jo vetëm për humorin brilant, por edhe për rrëfimet e shumta, që lidheshin me jetën e tij edhe si pedagog. Në këto rrëfime Elbasani zinte vendin kryesor. Ky qytet vinte tek unë me lirinimin e Musa Vyshkës, erërat e luginës së Shkumbinit, ku kujtoheshin paraardhësit e tij, poetët dhe shkrimtarët elbasanas, atmosfera e këtij qyteti nga më të bukurit e Shqipërisë.

Musa Vyshka lindi në Elbasan në viti 1942 dhe pas studimeve në qytetin e lindjes, erdhi në Tiranë, në Fakultetin e Filologjisë të Universitetin e Tiranës, ku në vitet 1963-1964 studioi në Degën Gjuhë-Letërsi. Ai punoi disa vite si mësues në shkollat e Elbasanit dhe Cërrikut. Musa Vyshka është një nga themeluesit e Katedrës së Letërsisë në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", ku punoi si pedagog dhe përgjegjës i Departamentit të Letërsisë për një kohë të gjatë, deri në vitin 1999, kur doli në pension.

E kam të vështirë të rrok ose të analizoj krijimtarinë e gjerë të Musa Vyshkës. Vlerësimet e mëposhtme për poezinë e tij, mendoj se janë modeste. Le të jenë ato një homazh për emrin dhe veprën e paharruar të poetit dhe njeriut Musa Vyshka, mikut tim të vyer, që s'është më tani, por jeton dhe do të jetojë, siç shkruan ai, në poezinë kushtuar Shkumbinit:

Me vjen një valë në përjetësi,
Kërcen gurë mbi gurë si kumuri,

.....
Më ndjek me gurgullima e mallëngjime,
Nga djepi gjer në fund të jetës sime.

Liriku i përherëshëm dhe Elbasani

Kur në vitin 1963 do të botohej libri i parë me poezi i Musa Vyshkës me titullin kuptimplotë "Ne njëzetvjeçarët", krahas befasisë së këndshme me të cilin e priti lexuesi shqiptar, pati edhe një gëzim të shumëfishtë nga opinioni dhe mendimi letrar i kohës.


Poetë të tjerë si Fatos Arapi, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Dhori Qiriazi, Vangjush Ziko dhe më pas Shefki Karadaku, prej vitesh e kishin kaluar prapë në moshë të artë të të njëzetave, duke nxituar me dinjitet drejt niveleve të larta cilësore të letrave shqipe. Musa Vyshka ndonëse ishte më i riu mes tyre, me librin e tij të parë trokiti dhe hyri me dinjitet në botën e letërsisë shqipe. Tashmë viti 1963 duket i largët. Nuk është më djaloshi njëzetvjeçar Musa Vyshka, liriku i papërsëritshëm nga qyteti i Elbasanit, ku lirinimi dhe lirika burojnë dhe janë pjesë e pandarë e jetës së tij. Libri i tij poetik "Vijmë dhe shkojmë", me këtë titull shumëkuptimplotë, duket se bën lidhjen mes kohëve: të shkuarës, çastit të papërsëritshëm të së tashmes dhe të së ardhmes. Lidhëza "dhe" ose thënë ndryshe "dhe- ja" si një urë metaforike, është ajo që lidh kohërat, brezat, ëndrrat e njëzetvjeçarëve të dikurshëm me rrjedhat e pamëshirshme të kohës. Musa Vyshka

In memoriam

LIRIKU I PAHARRUAR MUSA VYSHKA

Poeti, mësuesi, pedagogu dhe studiuesi

Nga Enver Kushi



është vetëmurosur në themelet e kësaj ure lidhbriggjëshe kohërash dhe fatësh njerëzore që në moshën njëzetvjeçare, duke u folur brezave me zërin e poezisë së tij brilante.

Ky është libër jo vetëm i kohëgëzimeve të njeriut dhe poetit Musa Vyshka, por edhe i kohëhidhërimeve të tij. Kumtet e poezisë së Vyshkës burojnë nga realiteti shqiptar i së shkuarës, së tashmes, por edhe të së ardhmes. Në planin krahasues nëse në librin e parë "Ne njëzetvjeçarët" kemi më shumë dritë më shumë diell, naivitet dhe dëlirësi rinore, në botimet e mëvonshme, veçmas në këtë të fundit, krahas dritës janë shtuar kohëgritë, muzgjet, qiejt me shira dhe erëra, si dhe ca bubullima të thella, që dalin nga thellësitë e tokës dhe jo nga



qiejt. Dihet se poetët e shquar të të gjitha kohërave janë përpjekur të kërkojnë dhe sendërtojnë botën ideale. Të paisur me ca shqisa të tjera, ndryshe nga njerëzit e zakonshëm, poetët e vërtetë bubullojnë dhe bëhen zemërakë, kur bota ku ata jetojnë është ndryshe nga idealja. Poetët dhe në përgjithësi krijuesit e sendërtojnë ndryshe botën. I tillë ka qënë dhe është edhe poeti Musa Vyshka. Kredon e tij poetike ai e shpalo në të gjitha poezitë e këtij libri. Ai i beson të mirës, ëndërron përherë të bukurën, shpirtin e dëlirë e të dashuruar të njeriut ose siç shkruan:

Besoj se çdo buzëqeshje është lule e shpirtit të ndershëm


Që zbut çdo urrejtje dhe i kthen armiqësitë në dashuri.

Besoj që kalendari si një plak i urtë e ka grisur inatin e djeshëm

Dhe i vë në kurorë dritës së re një përfaqim të ri.

Diku tjetër, ashtu si Naimi ynë i madh tek vjersha "Fjalët e qiririt" Vyshka e identifikon vetëm me njeriun e mirë që qiriun "E ngre lart në qiell, e bën fanar/ T'u ndrisë rrugën njerëzve n'errësirë".

I ndjeshëm, lirik i papërsëritshëm dhe i përherëshëm dhe në harmoni të plotë me natyrën dhe të mirën njerëzore, Vyshka ka krijuar poezi me shumë dritë, diell, fluiditet, ku njeriu dhe natyra janë në krahët e njëri-tjetrit dhe ku shpirti i vërtetë si dhe mirësia e bukuria njerëzore të ngazëlajnë...Fëmijëria, rrugica e vjetër, zëri i nënës dhe babait, hijet e vdekëtarëve që befas poeti i ringjall, duke i rikthyer në pragje shtëpish elbasanase, zëri i kumurisë, ditët e verës dhe malli gërryes i Isuf Myzyrit, janë disa nga përjetimet e



kohës nga vijmë ose më saktë, të kohës dhe qytetit nga vjen Musa Vyshka.

Poeti është i lidhur me mijëra fije me qytetin e tij, Elbasanin. Janë me fat ata krijues, kur në veprën e tyre, arrijnë të njësohen me vendlindjen. Poeti Musa Vyshka është njëri prej tyre... Poezia në Elbasan është edhe shpirt, edhe ëndërr, edhe këngë, edhe mall, edhe tingull, edhe dhimbje, edhe vdekje...Ajo mbi të gjitha është gëzim, jetë, dritë...Elbasani në themelet e tij ka pranverën, gëzimin njerëzor... Këtu lirika buron. Këtu shpirti njerëzor ka bukurinë e përherëshme të rinisë. Në këtë qytet gjithashtu befas gëzimi kthehet në lot dhe ky i fundit në shi dhe bubullimë, me largime të befta për në pyll, vetmi, mall gërryes për atë që ka lënë pas dhe pret e pret në dritare.

Ky është edhe shtrati i poezisë së Musa Vyshkës. Herë-herë deradian, naimian apo lasgushian dhe herë – herë migjenian. Dallgëzimet shpirtërore të poezisë së tij janë në brendësi e jo në sipërfaqe. Realiteti shqiptar si ai i paraviteve '90, por edhe ai i pas këtyre viteve, është larg botës ideale të sendërtuar prej tij. Dhe lexuesi ndjen dhimbjen klithëse të poetit Musa Vyshka, dëshpërimin uluritës e ca zëra që të trondisin me të vërtetat që kumtojnë ... Shkrimtari i madh Stefan Cvajg në një nga esetë e tij ka shkruar: "Nuk ka art të madh pa demonizëm, pa fjalët që përcillen si mërmërimë drejt muzikës së gjithësisë".

Në poezinë e Musa Vyshkës ndjen mërmërimën dhe zërat e kohës, asaj të së shkuarës, së sotmes dhe së ardhmes. Dhe këto mërmërima të brendshme dhe zëra vijnë mjeshtërisht nëpërmjet fjalës poetike, tingëllimit dhe muzikalitetit të veçantë që ka fjala në poezitë brilante të Vyshkës. Poeti Musa Vyshka ka kultin e fjalës. Fjala për të është e shenjtë dhe për rrjedhojë nuk duhet shpërdoruar. Me vargun, figuracionin, gjuhën ai është model i elegancës, në kutimin e vërtetë të fjalës. Eleganca buron nga bindja dhe respekti i kahershëm i poetit për fjalën dhe hyjnizimin e saj.

Mes një djepi e një varri

Në një ditë të paqte, të vjeshtës së tretë të këtij viti, takova Agim Vincën. Është fat që e njoh atë, jo vetëm si personalitet i letërsisë dhe kulturës shqipe, që ka dhënë një ndihmesë të madhe edhe në Historiografinë e Letërsisë, por edhe një nga njerëzit më me kulturë, të ditur, korrektë edhe shumë njerëzorë. Nga xhamat e kafenesë, diku pranë Televizionit Shqiptar, dukej e plotë vjeshta e Tiranës, me diell të bollshëm dhe një qetësi të çuditëshme. Ai më riktheu një libër të Stefan Cvajgut "Në luftë me Djallin", që ja kisha dhënë për ta lexuar. Më pas më dha një letër, që i ndjeri Moikom Zeqo, i kishte dërguar më 20 gusht 2007. Pastaj më foli për disa poezi të Moikom Zeqo, që i kishte përkthyer dhe që profesori i kishte komentuar në një emision të veçantë, në Radio Sarajeva, mos gaboj në vitin 1988. Pastaj biseda kaloi tek



poeti Musa Vyshka. Profesor Vinca më tha, se e kishte takuar një a dy herë Musain në Tiranë. Pas këtyre fjalëve ai me kujdes, me shumë kujdes, sikur të kishte diçka në dorë nga shpirti i poetit Musa Vyshka, hapi një letër të palosur në katërsh. E kam ruajtur këtë poezi, tha profesori dhe po ta dhuroj ty Enver, meqë e ke patur mik dhe se e di që do të shkruash tek "ExLibris" për të, me rastin e një vjetorit të vdekjes së tij. E mora në duar këtë letër dhe poezinë e shkruar në të. Poezia titullohet "Pasi lexova Ana Kareninën". Ajo është shkruar në një letër A4, siç duket nga ajo letër e prodhuar në fabrikën e Kavajës, ose të Lezhës.. Poezia ka 20 vargje e ndarë në katër strofa. Në fund është emri "Musa Vyshka" shkruar me stilolaps. Do t'i rikthehem kësaj poezie dhe disa dorëshkrimeve të tjera, që ai më ka dhuruar.


Këto ditë gjeta disa prej tyre, që m'i ka dhuruar më 16 tetor të vitit 2018. Në një nga faqet bosh, ose më saktë pas poezisë "Mos e kthe kokën pas", kushtuar poetit Fatos Arapi dhe shkruar kur ai ishte gjallë, kam këtë shënim: E martë, 16 tetor 2018. Mëngjes i diellit vjeshte dhe me një ndriçim

të pazakontë. Është ora 9, kur më thanë se ka ardhur Musa Vyshka. Dal dhe e kërkoj në hapësirën e qetë, si në rrëfimet e poetëve mistikë, në Kryegjyshatën Botërore. E shoh nga larg. Ma bën me dorë. Ecën ngadalë, shumë ngadalë... Flasin për Fatos Arapin, që iku para pesë ditësh. Pastaj për Lasgush Poradecin. Shkodrën dhe poetët e mëdhenj të këtij qyteti, si Fishta, Mjeda, Migjeni, Frederik Reshpja. Them se ky i fundit është lirik i vërtetë i dhimbjes së qiejve dhe reve, dhimbjes njerëzore etj.etj.

Në fund po citoj të plotë poezinë "Vijmë dhe Shkojmë", që ai ma dhuroi atë tetor të paqtë, kur u takuan në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane:

Vijmë dhe shkojmë,
si gjithë të tjerët.
Mes një djepi dhe një varri..
Një shpirt digjet...
Shekulli dëgjon,
e askush nuk përgjigjet
Për ata që vijnë vonë
E për ata
që ikin herët...

Tiranë, dimër i motit 2024



DY FAQE NGA BOTIMI I PARË I "KOMEDISË HYJNORE" TË DANTE-S ZBULOHEN NË ITALI

Dy faqe nga "botimi i parë" i kryeveprës "Komedia Hyjnore" të Dante Alighieri-t, që datojnë nga shekulli XIV, janë zbuluar në qytetin italian La Spezia.

Zbulimi i dorëshkrimeve të rralla, shpallur nga kryebashkiaku i qytetit, Pierluigi Peracchini të shtunën dhe raportuar nga agjencia e lajmeve ANSA, doli gjatë rivendosjes së arkivave të shtetit.

Dy faqet i përkasin këngëve të "Purgatorit" dhe "Parajsës" në veprën epike të Dantes të cilën poeti dhe filozofi mesjetar e përfundoi një vit para vdekjes së tij në 1321.

Përveç faqeve të "Komedisë Hyjnore", u zbuluan edhe dokumente të lidhura me të ashtuquajturën "Pax-Dantis", një marrëveshje e shekullit XIV që i dha fund konfliktit mes familjes fisnike Malaspina dhe Bishopëve të Lunit, theksojnë një lidhje të drejtpërdrejtë të Dantes dhe historisë së La Spezia-s.

Kryebashkiaku Peracchini tha se qyteti po vlerëson, së bashku me ministrinë italiane të Kulturës, një mënyrë për t'i ekspozuar dorëshkrimet e çmuara.

Lidhja e Dantes me La Spezia daton që nga periudha e ekzilit të tij prej Firences, nga 1301 deri në vdekjen e tij dy dekada më vonë në Ravenna, ku u varros.

"Komedia Hyjnore" është një poemë e gjatë narrative që përfaqëson një vizion të shekullit XIV për pasjetën, përshkruan udhëtimin e Dantes përmes tre realmeve të të vdekurve: Inferno (ferri), Purgatorio (purgatori) dhe Paradiso (parajsa).



Dante, i cili filloi ta kompozonte veprën në ose rreth 1308, shkroi 14,233 vargjet e poemës në gjuhën e përditshme, duke përdorur dialektin toskan mbi atë latin, e cila ishte gjuha e rezervuar për lexuesit më të edukuar.

Ky vendim novator nënkuptonte se vepra ishte e arritshme nga masat dhe çoi në emërimin e Dantes si "babai i gjuhës italiane".

Sot, kryevepra e Dantes mbahet gjerësisht si vepra më e shquar në letërsinë italiane dhe një prej veprave më të mëdha të letërsisë botërore.

Çdo vit Italia feston me një ditë kombëtare në nder të tij më 25 mars, data që studiuesit i kanë dhënë fillimit të udhëtimit drejt pasjetës në "Komedinë Hyjnore".

Marrë nga *Wanted in Rome*
Përktheu E.H.



Për disa raste të shmangies nga Kanuni Hahni flet me gjuhë thuasje groteske, gjithësi dëshmi e besueshme e kapardisjes së njohur shqiptare dhe ballkanase. Nëse në familjen e atij që vret është ndonjë burrë "me randsi e trim, atëherë njerëzit e të vramit e kanë për nder e ngushëllim në qoftë se mund ta vrasin këtë", thotë. "Nganjherë kërkohen shumë kurbane nga farefisi i katilit (gjakësit - m.e.), sepse shqiptari lavdërohet kështu: "Çdo njeri nga farefisi jem vlen sa për gjashtë burra". Mbasi çdo gjak i derdhun kërkon një kurban të tij nga familja anmike dhe gjaku trashëgohet brez mbas brezit, ky zakon brenda pak vjetësh ka zhdukun shumë familje".

Edhe Mark Milani gjen shpjegim të karaktere të veçanta. Ka ndodhur që janë vrarë për disa breza, "pasi ka mes tyre njerëz të tillë që duan të vrasin më shumë, në vend që të marrin gjakun *nji për nji*". Robert Elsie citon nga shenimet e gjeografit gjerman Kurt Hasert (Hassert), gjatë udhëtimit në Shalë (1897). Ndodh, sipas tij, që gjakmarrja keqpërdoret "si shkas për t'i hequr qafe rivalët dhe për t'i përvetësuar pronën dhe gratë e tyre". Këto sjellje mbështeten "deri diku në deklarata të rrejshme të dëshmitarëve", të bëra "zakonisht nga frika".

Vijimi pa mbarim i vrasjeve nuk ndodh për çdo gjakmarrje, shton Mark Milani. Ndodh më fort kur është puna me marrë gjakun e vëllamit ose të mikut të premë, të "probatinit ose të mikut që i ka përmendur emrin". Përsëri Hasert: "Ndonjëherë as të huajt nuk janë plotësisht të sigurt. Në rastet e skajshme të armiqësisë quhet nder po të vriten mysafirët, sepse mikpritësi i tyre është i shtrënguar të marrë hakun dy herë", gjaku i mikut shpaguehet me dy. Gjithësi vrasja e qëllimshme e mikut dëshmohej tepër rrallë.

Kanuni është autoritar, por ja që fuqia e tij nuk është absolute. Njerëz të çartur e provokojnë. Thuaj ti kanun gjak për gjak, thuaj gjaku peshon njëlloj, si i të mirit, si i të keqit. Për gjakun tim gjykoj vetë. E di unë sa peshon gjaku i burrave të derës sime.

Kanuni rrudh supet i mërztur. Ç'faj kam unë për dikë që nuk merr vesh, qysh me ia ba me këtë soj robi kryefortë e mendjeqyqë?

Ndodh që zjarrin e ndez dikush i tretë, që shqipton një fjalë të papjekur, pa u thelluar ose me ligësi. Dikush që mbase s'ka të bëjë fare me palët. Dhe *nji fjalë pa vend çart pleqinë e njiqind burrave*. Kallëzojnë për këtë ngjarje në Krasniqë:

Vrasin një burrë, ai i le fëmijët të vegjël, prush për tokë. Jep e merr pleqitë. Pas shumë mundimesh ia dalin, vëllezërit e viktimës pajtohen me gjaksin. Dorasi paguan për gjakun.

Dikush i largët po shkon rrugës në punë të vet dhe rastësisht ndesh një vocërrak, bir jetim i viktimës, kah kullot një lopë.

- A po ju qet tambël baba?, e pyet.

I vogli s'e kupton. Ç'ne qumësht baba, ai është nën dhë! Kallëzon në shtëpi për pyetjen e çuditshme. Ironi fort e hidhur: keni blerë lopë me paret e gjakut të babës. Keni ndërruar gjakun e babës me qumështin e një lopë!

Vëllai i viktimës dridhet. Në katund e në fis s'e paskan miratuar pajtimin, i paskemi nxirë fytyrën vetes. Po na quajtkan të ligj e tutës!

Kap pushkën, del e ia numron në ballë vrasësit, i cili zihet tradhmend. S'kish arsye me u ruejtë, a nuk qenë qenë pajtuar? E palon për dhë.

Për familjen e të porsavrarit kjo ishte vrasje e papërligjur, thyente pajtimin e bërë faqe burrave, sipas ligjeve të Kanunit. Njerëzit e tij trenohen krejt. Vrasin xhaxhain e jetimëve, që po kujdesej për ta. Familja e tij ia merr gjakun. Pastaj prapë pala tjetër. Dhe sërish tjetra. Përroi i gjakut me shkulma. Ku me u kapë me ba pajtim?

Herë-herë shkak i ployës në këtë mjedis me drejtpeshim të brishtë mund të bëhet një rastësi prej atyre që ndodhin fort rrallë. Fillea e zezonës të Prillit i Thyer i Kadaresë është vrasja e një bujtësi të largët i cili, falë një rrethane të pandriçueshme, përballë së cilës edhe pleqnarët më në zë ndihen të çarmatosur, duket sikur është vrarë në bukë të mikpritësit. Pra sikur është prerë mik.

Ai e kishte dëgjuar prej t'et dhe i ati e kishte

Rasti i *Prillit të thyer* të Kadaresë dhe i *Match Point* të Woody Allen

Kanuni: e ndal apo e nxit gjakmarrjen?

Nga Mehmet Elezi

(Vijon nga numrin i kaluar)



dëgjuar prej atit të vet historinë e armiqësisit të tyre me familjen e Kryeqyqëve. Ishte një histori e zakonshme me njëzet e dy varre nga secila palë, gjithsej dyzet e katër varre...

Dhe e gjithë kjo kishte ndodhur shtatëdhjetë vjet më parë, në atë natë të ftohtë tetori, kur në derën e kullës së tyre kishte trokëllitur një njeri...

I zoti i shtëpisë, gjyshi i Gjorgut, i kishte hapur derën dhe e kishte futur brenda të panjohurin. E kishin pritur sipas zakonit, i kishin dhënë të hante, e kishin vënë të flinte dhe në mëngjes herët, prapë sipas zakonit, një njeri nga familja, vëllai i vogël i gjyshit, e kishte përcjellë bujtësin e panjohur gjer në kufi të fshatit. Atje, porsa ishte ndarë me të, ishte dëgjuar një krismë dhe i panjohuri kishte rënë i vdekur përdhe. Ishte vrarë mu në kufi të trojeve të fshatit... Përcjellësi kishte kthyer shpinën kur miku u vra, pra i vrari nuk binte mbi të. Mirëpo këtë nuk e kishte parë askush... E megjithatë do t'i besohej fjalës së tij, sepse Kanuni i besonte fjalës, pra do të besohej se përcjellësi qe ndarë me mikun dhe i kishte kthyer shpinën në çastin e vdekjes, sikur këtu të mos dilte një pengesë... I panjohuri kishte rënë me fytyrë përmbys nga katundi, pra familja e Berishajve, që i kishte dhënë bukë dhe strehë dhe që kishte pasur për detyrë ta mbronte të panjohurin gjersa të dilte nga trojet e fshatit, duhej tani t'ia merrte gjakun.

- nga Prilli i Thyer -

Fatalitet i trefishtë.

Mbi bujtësin e largët, që humb jetën.

Mbi shtëpinë e Gjorgut, ku e presin dhe e përcjellin mikun sipas protokollit të rreptë të maleve, por për një rastësi që ndodh vetëm një herë, i ndjeri rrezohet me kryet në drejtimin e paduhur, zakonisht të pamundur, duke bërë pluhur gjithë përkujdesjen për të. Mikpritësit papritmas e gjejnë veten mikpëmë.

Dhe mbi shtëpinë e Kryeqyqëve, të cilët kanë vrarë tjetrin pasi ka dalë nga hija e kullës ku kish bujtur, e kanë vrarë në bukë të askujt, s'i kanë borxh kurrkujt mbi dhë përveç, ndoshta, familjes së të ndjerit, por për të njëjtin fatalitet, për shkak të mënyrës se si një dorë e mbrapshtë e padukshme e ka përplasur - me krye në drejtim të katundit - duket sikur i kanë prerë mikun familjes pritëse. Dhe bien në gjak.

Në raport me serialin e vdekjes që fillon, secila palë ndihet pa faj dhe përnjëmend është pa faj. Secila palë duket me faj dhe askush nuk vërteton dot bindshëm të kundërtën. Secila palë mendon ose ndien se vrasja e mashkullit të saj gjykuar me kanun ishte padrejtësi, prandaj asnjëra nuk mund të rrijë pa marrë gjak, kur tjetra vret.

Edhe me mjetet e teknikat e sotme policore të filmave të Hollivudit lëmshi duket pa zgjidhje. Diçka si te filmi i Udi Allenit (Woody Allen) *Match Point* (2005), ku një rastësi e vogël, ose disa rastësi të vogla, u japin drejtim të shtrembët hetimeve të policisë më profesioniste e më të pajisur të rruzullit, në mënyrë të pakthyeshme. Vrasësi mbetet i pazbuluar, krimi i vishet një tjetri që nuk dëshmon dot, e ka gojën të mbushur me dhë. Askush nuk mund të fajësojë të drejtën dokesore për gjëmën rrenuese që zë fill të një rastësi e cila nuk mund të zbardhet, ashtu siç askush nuk mund të fajësojë sistemin ligjor amerikan për përkimet ose rastësitë që përshtellojnë në mënyrë të pandreqshme krejt fillin te *Match Point*. Cili kod a sistem ligjor i botës mund të parashikojë të gjitha rastet e mundshme, të cilat teorikisht janë pa kufi? (P)loja vazhdon deri të sosën të gjithë gurët.

4. NUK JAM MISIONAR NDËSHKIMI, JAM MISIONAR PAJTIMI

Si gjyqtar, Kanuni shpall të përfunduar përbaljen e përgjaksme sapo ajo bëhet *nji me nji*. Parimi i tij është drejtësia. Marrja e gjakut duhet bërë vetëm baras. Asnjë pikë më shumë. Nga kurrnjëra palë.

Megjithatë nderimin më të lartë nuk e gëzon duke e mbyllur ndeshjen me barazim e paanësi.

Pikët më të shumta i fiton duke "anuluar"

ndeshjen pa dalë në log përbalçit (dyluftuesit) me dhëmbët shtrënguar. Pra duke shkimur gverrin qysh në nisje, duke shuar shkëndijën pa marrë flakë. Ky është misioni themelor i tij. Fillimisht "Kanuni i Lekë Dukagjinit i vendos punët, i ndreq zemrat..." thotë Gjeçovi. ¹ Peter Bartli, duke folur për institutin e pleqve dhe të pleqësisë, shpreh afërsisht të njëjtin shllim: "Detyra e tyre ishte të zgjidhnin të gjitha problemet e përditshme, të shuanin grindjet...". Pra të mos lejonin me u trashë sendet deri te derdhja e gjakut. Duket qartë se Lekë Dukagjini u përpoq "t'u vinte fre krimeve, duke vendosur ndëshkime të ndryshme", vëren Edit Durhami. Asaj i vjen keq se princin e Dukagjinit e kishte shkishëruar papa, këtë nuk e meritonte, sepse "duke vendosur djegien e shtëpive dhe gjobat, ai ka bërë çmos që të pakësonte zakonin e lashtë të gjakut".

Më keni keqkuptuar, qorton me ftohtësi Kanuni. Nuk jam misionar ndëshkimi, jam misionar pajtimi.

Nga një këndshikim tjetër thjesht fizik: hapësira për nenet që i kushtohen paqimit e pajtimit është dukshëm më e gjerë se hapësira e neneve për marrjen e gjakut.

Për gjakmarrjen janë dy krerë (kapituj): *Vrasa si vetëgjyqësi (gjakmarrja)* dhe *Dorasi e të ramit në gjak*. Këta dy krerë kanë gjithsej tetë nene.

Ndërsa për ndaljen e gjakut te pjesa *Ndërmjetësia dhe pajtimi* janë jo dy, por katër krerë. Titullohen përkatësisht *Ndërmjetësi, Pajtimi, Çmimi i Pajtimit* dhe *Riti i Pajtimit*. Këta kanë njëmbëdhjetë nene. ²

Përmasën e Kanunit si kufizues e ndalues i vëllavrasjes Fishta e shpreh qartë në parathënien e botimit të parë (1933). Kjo parathënie është njëherësh sprovë e shkëlqyer për qytetërimin shqiptar, vështruar edhe në raport me qytetërimet e tjera.

"Vrasja ndërmjet dy familjeve hasme nuk shtyhet në një numër të pacaktuem" shkruan ai. Në të kundërt, "të vramen gjakësin dy familjet marrin e japin njena me tjetrën si me gjithë familjet e tjera të bajrakut, mostjetër, në atë masë sa shtetet e qytetnueme të Europës mbas Luftës Botnore".

Dom Ernesto Koci del me përfundim të ngjashëm. Sipas tij, "gjendja e të kenit në gjak ngjatë derisa të kryhet marrja e gjakut... ose derisa të bahet paqja; e me marre gjakun do me thanë bash me u vra në numër të barabartë".

Drama e parandalimit të gjakut zhvillohet nëpër katër akte.

Akti i parë: PLEQNARI

Çelet sipari. Në skenë ftohet pleqnari. Logjika e tij është sa e thjeshtë dhe e kapshme, aq përthequese.

A shkoi kali te ara a ara te kali?

Kuajt e katundit banin dam në ara e livadhe. U ba kuvend:

1. me i thurë arat e livadhet;

2. mos me i lëshue kuajt me kullotë lirshëm, por me i mbajtë mshelë ndo me i ruejtë me çoban.

Ra kali i njanit e ia prishi arën shoqit. U kapën keq.

Njani: pse s'e thure arën, a e kemi pasë ba me kuvend me i thurë krejt?

Tjetri: pse e lëshove kalin, a e kemi pasë ba me kuvend me i mbajtë kuajt ngujuet?

Të dy kishin të drejtë, po puna u dashke da. Shkojnë te Azem Hoxha.

- A shkoi kali te ara a ara te kali?, pyet Azem Hoxha

- Jo, shkoi kali te ara.

- Atëherë damin ka me e pague i zoti i kalit!

Mehmet ELEZI



*Hebrenjtë dhe
Republika e Kanunit*

sprovë, botim i dytë i plotësuar

INSTITUTI I FISHTA

¹ Parathanë e Gjeçovit.

² Sipas strukturimit që i është bërë lëndës në Akademia e Shkencave e RPSSH, E drejta..., vepër e cituar.

Ke vra çikën tande

Nji burrë kish pasë një çikë të fejueme, çika nuk pret ditën e dasmës, por kërcet e ik te burri tinëz. I ati preket, pse s'prite moj bijë me të përcjellë qysh asht rendi, por ike hajnisht? I ndohet mbrapa dhe e vret të bijën.

Baba i dhandrit, ku e kish pasë të fejueme çikën, ia lyp gjakun: ma ke vra nusen e djalit, i thotë. Ky ia kthen: kam vra çiken teme. Isë Buletini, dajnae këtë punë.

Isa Buletini kish qenë te Azem Hoxha i Dollapit, në Koçanaj. Thotë po ia lã Azem Hoxhës me e da.

*Azem Hoxha pyet babën e çikës:
- Kur e vrave çikën, qe veshë në tesha çikash a në tesha nusesh?
- Në tesha çikash qe veshë.
- Ke vra çiken tande, nuk i ke borxh kujt.*

Nan rrugë a mbi rrugë?

U ankuen te Azem Hoxha i Dollapit se i kishin dalë përpara në rrugë një çike në shpat mbi lumë, e kishin çnderue me zor.

*Azem Hoxha mendohet.
- Ku ka ba vaki kjo punë, pyet, nan rrugë a mbi rrugë?*

*- Mbi rrugë, i thonë.
Shpati i lumit nëpër të cilin priste rruga e hollë, krejt i thiktë.*

- A jo, po të ish me e ngrehë zhag me zor, ma kollaj e ka pasë me e shti pjetposhtë nan rrugë se me e ngrehë thikë përjetë mbi rrugë. Mbi rrugë asht dalë me kambë të veta, pra s'ka pasë zor aty.³

Njeriu që ta shkim zjarrin

Në një familje të madhe në Rrafsh rrogëtari i shpisë lidhet me çikën e të zotit të shpisë. Të rinjtë i japin fjalën shoqi-shoqit dhe ikin bashkë. Marre e faqe e zezë, rrogëtari i pabesë e bukëshkalë, vendosin me e vra. Mëdyshja ishte: me vra edhe çikën apo vetëm atë?

Thërrasin Xhemajl Abrinë (Obrinë). Ai merr mashën dhe kap një gacë të madhe në vatër.

- Me ta qitë këtë gacë në prehën, kush të shpëton prej zjarrit?, i thotë të zotit të shpisë. Vjen Xhemajl Abria prej Drenice me të ndihmue apo të shpëtojnë njerëzit që ke afër?

Pleqnia u nda: në vend të gjakut, dasma. Xhemajl Abria shkrep alltinë, për hajr u qoftë dhe u trashëgofohin!

Në të katër rastet që u përshkruan, kurrkush s'e luajti dot gjyqësinë. Të katër herët sherri i shua qysh në vezë. Ani pse tepër delikat, në lojë ishte nderi. Nderi që peshon më rëndë se jeta, më rëndë se vdekja.

Pleqtë e Kanunit janë të panjollë, burra të besueshëm. Gjyqtarë të ndershëm, të paanshëm. Nuk janë emëruar me dekret në atë detyrë, e kanë fituar me meritë, me mendjen dhe figurën e panjollë. Siç vëren Kadareja, shpesh me një fjalë të tyre ndalnin rrëke të tëra gjaku, që do të shkretonin për dhjetëra vite fise të tëra. Gjyqësi të tilla të famshme, zgjidhjet, formulimet ose kompromiset e shkëlqyera të pleqnarëve kalonin gojë në gojë njëlloj si bëmat heroike.

Të dy s'kemi vend atje

Shkojnë me e marrë Xhemajl Abrinë për një pleqni dhe, kur ban me u nisë, e ndigjojnë kah flet vetmeveti: "A po shkon ti a unë? Të dy s'kemi vend. Këtu po të lã e këtu me të gjetë!"

*Me kë po flet Xhemajl Abria?
Me veten e vet. I drejtohet kështu kajtjes (lakmisë, ëndjes, interesit vetjak). I thotë ti mos me më shoqnue.*

Pleqnonte gjithmonë kah e drejta. Pa fije animi kah interesi.

Për këtë arsye shumëkush besonte se ai ishte njeri i mbërrimë (i shenjtë).⁴

Me veshin tjetër ndigjoj tjetrin

Shkon njeni te Sali Rrusta i Deçanit me pleqnue një punë. Ndërsa fliste ky, Sali Rrusta mbyll njanin vesh me gisht. Çuditet tjetri kur e sheh ashtu dhe e pyet Sali Rrustën:

- Pse kur po flas unë ti po e mshel njanin vesh me gisht?

- Po e msheli njanin vesh me gisht se me këtë vesh më duhet me ndigjue palën tjetër, se edhe ai tjetri ka me thanë diçka. E kur t'i ndigjoj të dy palët, atëherë muj me pleqnue drejt, tha Sali Rrusta.⁵

Megjithatë, janë pleqtë e Kanunit kurdoherë të kulluar?

Njerëz të gjallë, nuk mund të përjashtohen prej joshjeve e dobësive njerëzore. Por nuk përjashtohen as prej mekanizmave të kontrollit. Vendimet e pleqnarëve janë tej e tej të dukshme, ato filtrohen nëpër syrin e krejt bashkësisë. "Vetingun" ua bën i mençuri i të mençurve, i drejti i të drejtëve, populli. Nëse ndonjëri ndodh me u thye prej nëndoresh, lakmish, miqësish, trysnish, ndaj tij ka ndëshkime institucionale. "Në vjetë 1907 flamuri i Kryezetit i gjobiti krent e flamurtarin për do pleqni të paudhëta e të bame me krah e pajambajtas, thuhet në një shënim të Gjeçovit. Mbasi u ra në hetim vogjlja e flamurit këtyne pleqnive të shtrembëta, u mblodhën burrë për shpi simbas dokjet, dhe u muerën gjobë 100 desh e një ka". Gjeçovi thotë se ata u hetuan prej pleqve të dytë. Dhe përveç gjobës e faqes së zezë, prit edhe falimentimin si pleqnar. Atë, që i shkon fytyra me qëndrime kësisoj, rrallëkush e merr më për plak.

Njihet edhe praktika e vrasjes së pleqnisë. Kur dikush nuk pajtohet me zgjidhjen, sheh hapur padrejtësi në të, qet pushkë duke shpallur vrava pleqinë (e akëcililit). Çështja rifillon nga e para me pleq të tjerë. Akëcili, të cilit ia vrasin pleqinë, ka bërë një lloj vetëvrasjeje morale. Nuk është më i dëshirueshëm si plak kanuni, ka bjerrë besimin e bashkësisë.

Kur parandalimi është i pamundur dhe zjarri merr hov, hapet sipari, zdririt rishtazi skena. Në lojë hyn një tjetër personazh.

Akti i dytë: NDËRMJETËSI

Ndërmjetësi në të kapmet (zënkat e përplasjet me armë) është para së gjithash institutet më të bukura të kodit tradicional", vlerëson Atë Zef Valentini. Sjell një shembull nga letërsia, nga Oso Kuka i Fishtës, i cili "ve në veprim institucionin e ndërmjetësit, brof në këmbë duke uluritur fjalën rituale *jam ndërmjet...*". Vetëtimthi ulen shpatat, thua u këputën krahët në shpatull a u pre diku rryma që i ushqente me energji.

Ndërmjetësi ndërhynd edhe me ndalë

⁵ Salih Zogiani, Anekdotat shqiptare 5, Prishtinë 2012.

gjakun, kur mosmarrëveshjet kanë marrë flakë papritmas e janë harbuar. Edhe "Me kenë të vramë njiqind vetë në njanin krah e në tjetrin kurrnji, si të hijë kush ndërmjet, pushka do të prajë, zjarmi do të shuhet", thuhet në Kanun. "Me ba me u qitë poshtë fjala e ndërmjetsit, ajo lagje qi të fillojë pushkën ia pret mikun ndërmjetsit".

Mjafton me thanë dikush "për hatrin tim", shkruan Nopça, dhe kjo formulë në Shqipëri bën mrekulli, si në asnjë vend të botës.

"Ndërmjetës mund të jetë burrë a grue, djalë a vajzë a edhe prifti".

Pesha e gruas si ndërmjetëse është edhe më e madhe. Ashtu siç është edhe më e sigurtë ndorja e një gruaje.

Pas pak do batore të shpeshta martinash shoshuan natën e shurdhët...

*Dhe një zë plake:
- Gruēja ndërmjet, Zoti ju bekoftë, grueja ndërmjet!*

Pastaj çdo gjë ra fashë...

- nga romani i A. Demaçit *Gjarpinjë e Gjakut* -

Janë tetë të vrarë, gjaku rrjedh "si gjarpinj", trupat ende të ngrohtë, por sa thërret gruaja që hyn ndërmjet, burrat e kërlëshur ulin armët.

Ndërmjetësi synon "armëpushim", si nevojë e ngutshme, e atypëratyshme. Vjen si zgjidhje afatshkurtë. Fill i lëshon vendin tjetërkujt. Dikujt që synon më shumë, zgjidhje afatgjatë.

Zdririt skena.

Akti i tretë: PAJTIMI

Janë bërë përpjekje, takime, negociata. Në parim palët kanë mbërri në një mendje: me u pajtue. Parashtrajnë kushte.

Ritet e pajtimit me djeq në derë e me dorasin duarlidhur, me sy e fytyrë mbuluar, dialogu me fjali të shkurta, të prera, i përfaqësuesve të palëve, janë rrëqethës. Të denjë për drama dhe skena të mëdha, që i rrok vështirë edhe fantazia e një Spielbergu.

Kur gjithçka shkon mirë, përmbyllja nuk është vetëm pajtim.

Shumë herë përmbyllja është shëndoshje, shërim. Mund të mbërrijë deri te *vllaznimi i gjakut*. Dy ish-hasmët bëhen vëllamë, pinë gjak te gishti i shoqi-shoqit. "Ndër njimi përgzime qesin pushkë e bahen si vllazën të ri një nanet e babet".

Kjo do të thotë se gjithçka quhet përfundimisht e shkuar dhe e harruar. Asnjë shenjë a dregëz nuk mbetet.

Kisha katolike ka besueshmëri e peshë në këto pajtime. Edhe ndër myslimanë. Sipas një pohimi që sjell M. Krasniqi, imzot Pjetër Bogdani (1655-1689), ipeshkëv i Shkupit, njëherësh shkrimtar e luftëtar, atdhetar i madh, brenda tri orëve kish pajtuar 24 gjaqe mes myslimanëve të fisit Krasniq dhe katolikëve të fisit Gash. Nopça shkruan se në vitet 1904-1909 ka qenë shumë e frytshme

puna e misioneve jezuite. "Në Malsi të Madhe një mision i tillë mundi të pajtonte me 1909 dyzet e dy gjaqe. Dhe disa vite më parë sukcesi i një misioni tjetër në Mirditë ka qenë gati një mrekulli".

E kundërta kishte ndodhur me përpjekjet e administratës turke. Kur disa komisione pajtimi nisën me veprue në krejt Shkodrën, gjindja nuk donin me i zgjidhë çështjet "në mënyrën e re", parapëlqenin "mënyren e trashëguar prej shekujsh"; për pasojë brenda dhjetë ditëve ndodhën "jo më pak se shtatë vrasje". Edhe mirditasit "ishin të pakënaqur nga vendimet e komisionit", edhe atje vijuan vrasjet. Dorëzan bëhej qeveria turke, thotë Nopça, por sa pare bën. "Secili e ndiente veten më të sigurt kur kishte dorëzan më të varfrin malsor se sa sulltanin në Stamboll".

Në Kosovë tradita e pajtimit dhe faljes së gjakut u pasurua me përmasë të re, në skena masive me mijëra vetë, shikues dhe aktorë. Për herë të parë në histori gjaku nuk i falet gjakësit. I falet Kombit. Krasniqi shkruan se "pajtimi i gjaqeve në Kosovë më 1990 është bërë vetëm për interesin kombëtar, pa kurrfarë kompensimi për familjet e dëmtuara".

Ideja për këto skena madhështore kish dalë prej zgafellava me minatorë të Trepçes dhe prej burgjeve serbe të mbushura me shqiptarë. Emra intelektualësh të njohur udhëheqin si misionarë: Anton Çetta, Zekeria Cana, Mark Krasniqi. Në dy vjet pajtohen rreth dy mijë gjaqe. Ka ndodhur ndonjëherë kështu?

Po ia falim Kosovës. Falë i qoftë Kosovës. Falë i qoftë shqiptarisë.

Akti i katërt: KUVENDI

Lajme të këqija. Çështja nuk është mbyllur gjak për gjak, siç përcaktohet në Kanun. Dhe s'ka gjasë me u mbyllë shpejt.

Zjarri brafullon rrezikshëm, flaka del jashtë kontrollit.

Bie i pari mbi një me një. Dy me një. Përgjigjet me armë ana tjetër, dy me dy. Pastaj prapë, tre me dy. Tre me tre. Katër me tre...

Pleqtë harxhojnë mundësitë që kanë. Huq. Qysh me ba?

Sipari hapet sërish. Ngadalë, zymtësisht. Skenë e gjerë, e mrrolët. Sa gjerësia e bjeshkëve.

Çështja është përcjellë te institucioni më i lartë kanunor, te kuvendi. Gjyqtarët, pleqtë më të zëshëm të maleve, janë mbledhur. Yndyra e mendjes, e burrnimit. Vetë "kuvendet merreshin me shuarjen e gjakmarrjeve të zgjatura...".⁶

Në këtë mënyrë, sipas studiuesit Blerim Reka:

"Ky kod i lashtë dhe i pashkruar i të drejtës shqiptare i dha... traditës dhe kulturës njerëzore filozofinë shqiptare pajtuese, me të cilën me shekuj kishte proceduar dhe zgjidhur konfliktet brendakombëtare me rrugë të negociatave..."


"Kur s'kishte as kombe e as shtete në kuptimin bashkëkohor të fjalës, as ligje, as gjyqe e as drejtësi të një demokracie parlamentare, shqiptarët jo vetëm që pleqnin në drejtën sipas normave dhe procedurës së vet burimore, por kishin krijuar edhe mekanizmat e zgjidhjes dhe parandalimit të konflikteve përmes rrugës paqësore: me bisedime dhe ndërmjetësime.

Dispozita të caktuara të Kanunit të Lekë Dukagjinit na dalin kështu edhe si pararendëse të doktrinës shumë të mëvonshme që do të krijohet në Perëndim, asaj të Conflict Prevention & Conflict Resolution, pra të parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve përmes negociatave dhe medijimit (ndërmjetësit - m.e.)".⁷

(nga libri *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit*, sprovë, botim i dytë i plotësuar, Tiranë, 2019)

⁶ Akademia e Shkencave e RPSSH, E drejta..., vepër e cituar.

⁷ Blerim Reka, Elementet e zgjidhjes dhe parandalimit të konflikteve sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, Voka - 4, Tetovë 1997.



³ Halil Elezi, 500 kallëzime popullore me bisht, Tiranë, Gj. Fishta, 2011.

⁴ Xhemajl Bajrami, Xhemajl Abria, pleqnar i Kosovës, Koha, Prishtinë, 2010.

Sapo është botuar në Itali, nga botimet Castelvechi, *Piccole coincidenze della vita coniugale*, përkthimi italian i *Histori njerëzish të zakonshëm* nga Ylljet Aliçka, nën kujdesin e Fabio dhe Kriselda Rocchi. Teksti i mëposhtëm – një reflektim kritik mbi veçoritë e romanit – është pjesë e një shkrimi më të gjerë që do të botohet së shpejti në Itali.

Tiranë, mars 1991. Një burrë ecën i vetmuar nëpër rrugët e qytetit me një çantë në dorë brenda së cilës gjenden disa sende të mjera personale. Ka një pamje të pakuruar. I përballur me një ndjenjë hutimi në rritje, ai vëzhgon posterat që shpallin zgjedhjet e para të lira në Shqipëri pas periudhës së gjatë të regjimit socialist të Enver Hoxhës. Sapo ka dalë nga burgu dhe kërkon lajme për të birin, për të cilin nuk di asgjë pas ndarjes së turbullt nga gruaja e tij e dytë. Po ashtu, nuk arrin të gjejë as vajzën për të cilën përfundoi në burg pasi tentoi ta mbronte gjatë një zënke me një deputet arrogant. Fatbardha – kamarierja që mbrojti dhe me të cilën u dashurua – ka shkuar në Itali me anijen Vlora, si shumë bashkatdhetarë të tjerë. Ky burrë që endet në rrugët e Tiranës pak ditë para hyrjes së saj në modernitetin global është Shazivari, protagonist i këtij romani.

Duhet të pranojmë menjëherë që Ylljet Aliçka, duke filluar nga kjo skenë që mbyll kapitullin e shtatë, ka një aftësi përshkruese të lakmueshme: ai arrin të depërtojë në shpirtin e një personazhi prej letre për ta bërë atë të gjallë, autentik, duke e vendosur vetëm një hap larg një tridimensionaliteti krejt të besueshëm. Karakterizimi psikologjik i Shazivarit, ashtu si për figura të tjera të këtij romani, nuk ndodh përmes përshkrimeve të ndërlukuara introspektive, por, përmes vendosjes së një sërë mikro-ngjarjesh në një strukturë të fortë narrative. Gjatë tetë pjesëve (dhe epilogut përfundimtar) që përbejnë rrjedhën e romanit, asistojmë sistematikisht në shkatërrimin e shpresave të protagonistit, i cili përballet ashpër me një seri të gjatë humbesh: zhdukja e hallës së dashur, tradhtitë e shumta të grave të tij të pabesa, humbja e të birit, për të cilin mesa duket nuk do të ketë më lajme, talljet e kolegëve, humbja e vendit të punës dhe i statusit të mësuesit e në fund, përvoja frustruese riedukative në burg.

Kategoria e të zakonshmes dhe strategjia e njeriut-shënjestër

Shazivari është pra një humbës, një humbës që në fillim të librit duket se i meriton të gjitha kritikën që i bëhen për shkak të budallallëkut të tij të dukshëm, fatkeqësive që i ndodhin dhe incidenteve që i pengojnë planet. Ai është i fiksuar nga projekte që mund të thuhet se i përkasin një natyre të borgjezisë së vogël, ndonëse të përjetuara në kontekstin e një vendi të mbyllur prej dekadash në ideologjinë marksiste-leniniste: një grua besnike me të cilën të hapë zemrën, një shtëpi, një të ardhme të siguruar, disa para më shumë të fituara nga punë të fshehta. Ambicie të vogla, krejt proporcionale me një njeri pa pretendime të mëdha. Sjellja e tij e ngathët dhe prirja e tij qesharake për të nxjerrë përfundime të nxituara janë të destinuara ta dënojnë vazhdimisht Shazivarin. Edhe pse fillimisht lexuesi mund të prirret të shohë Shazivarin si një personazh qesharak, gradualisht, me zhvillimin e romanit, ai fiton më shumë dimensione njerëzore. Në fillim të tregimit, pra, lexuesi përgatitet për të vëzhguar një skicë mjaft argëtuese, ku garojnë shkurtpamësia dhe frikacakëria. Këto dy antivlera shtohen nga *milieu* absolutisht i zakonshëm, i përditshëm, siç sugjeron titulli original, pjesë e të cilit janë personazhet kryesore; ai *milieu* që rrjedh nga shekulli i XIX dhe që rryma realiste e romanit evropian - veçanërisht atij francez dhe rus - kishte studiuar në thellësi, duke

Shënim mbi përkthimin italian të *Histori njerëzish të zakonshëm* nga Ylljet Aliçka

Një humbës që të bën të qeshësh dhe të qash. Shazivari dhe logjika e kontradiktave

Nga Fabio M. Rocchi

nxjerrë në sipërfaqe fate paradigmatike të destinuara jo vetëm për dështim, por mbi të gjitha për anonimitet. Kur shkrimtari rus Ivan Gonçarov, për shembull, sjell në skenë në romanin e tij *Një histori e zakonshme* (1847) Aleksandrin entuziast dhe të marrë, ai krijon një dialektikë mes qytetit të madh dhe provincës që shërben për të përqeshur me mirësi naivitetin e të riut të papërvojë, të cilit nuk i mjaftojnë leksionet e cinizmit të dhëna nga xhaxhai Pjotr për të hapur sytë. Shazivari, i vendosur në mënyrë të përsosur në këtë gjenealogji personazhesh vetëm një hap larg të qenit karikatural, ndjek pra nga afër gjurmët e një kritike sociale me natyrë humoristike.

Megjithatë, kjo nuk duhet të duket si një anakronizëm, dhe ekzistojnë të paktën dy arsye që e bëjnë të mundur një pohim të tillë. E para: edhe pse romani i Aliçkës është shkruar në vitin 2023, duhet marrë parasysh konjunktura për të cilën ky zhanër në Shqipëri ka pasur një jetë shumë më të shkurtër krahasuar me letërsinë e tjera përfundimtare; le të kujtojmë që romani i parë në gjuhën shqipe daton në vitin 1892, *Marzia o kshtenimi n'filles t'vet*, i shkruar nga dom Ndoc Nikaj. Ky vonesë e konsiderueshme, e shkaktuar nga çështje kulturore dhe gjuhësore dhe më tej e rënduar nga ardhja e imponimeve të realizmit socialist në mesin e viteve '40, nuk lejoi që të zhvilloheshin dhe të përparonin

tendencat e *novel* dhe *romance*, të afirmuara tashmë që nga shekulli i XVIII në Angli e më tej të përhapura edhe në kontekstin evropian. Me fjalë të tjera, ka munguar plotësisht faza e përballjes me një narrativë të analizës dhe introspeksionit të vërtetë social, fillimisht sepse kushtet nuk ishin ende të pjekura dhe më pas sepse censura dhe partia drejtuan në mënyrë të detyrueshme krijimtarinë e intelektualëve. E dyta: një nga veçoritë më interesante të romanit të ideuar nga Aliçka është aftësia për të ndryshuar intonacionin, pa asnjë sinjal që na lejon ta parashikojmë diçka të tillë, duke aluduar komiken e duke ndryshuar ambientimet me shpejtësi. Në këtë mënyrë, i mohohet disa herë përkatësia ndaj një nëngjinie të paracaktuar. Nuk kemi të bëjmë, për ta thënë qartë, me atë kundërshti të vazhdueshme, korrozive dhe të pavullnetshme që qëndron pas shpinës së shokut të zellshëm Zylo të Agollit (*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, 1973). Synimi karikaturist është vetëm fillestar; ky lloj realizmi, i praktikuar tashmë në rrethana të tjera nga Aliçka, ka nevojë për një viktimitë sakrifkuese për të shprehur jo aq një vetëkënaqësi denigruese, sa një pikëpamje thellësisht të vetëdijshme për dinamikën njerëzore. Viktima bëhet, në njëfarë mënyre, një pretekst për të shkruar më tej. Merrni, për shembull, figurën e Benjamin Bensos, i cili shfaqet në kapitullin e katërmëdhjetë



të *Metamorfoza e një kryeqyteti*. Beniamini është një poet që ka gëzuar njëfarë privilegji në kohën e Timonierit Enver; megjithatë, pas tranzicionit, bie në fatkeqësi dhe detyrohet të shkruajë nekrologji për të siguruar mbijetesën, herë pas here duke bërë gabime të rënda që e vënë në vështirësi. Aliçka nuk i kursen asgjë: turpin, poshtërimin, rrahjet. E vendos në qendër të rrefimit, por ndërkohë na tregon edhe shumë gjëra të tjera, si rritjen e papritur dhe të çrregullt të Tiranës, ose evolucionin e degraduar dhe të komercializuar të sistemit të arteve. Tema, sekondare por megjithatë urgjente në reflektimin bashkëkohor, fshihet pas personazhit dhe gjen në atë histori një *pendant* domethënës të Martin Shpiragu, një skulptor i refuzuar në atdhe që përfundon duke shitur statuja kitsch në stendat e atij muzeu të kontradiktave në qiell të hapur që është bërë Firence në dekadat e fundit.

Shazivari, pra, është thjesht një tjetër nga këto krijesa-shënjestra të cilat Aliçkajt i nevojiten për të zhvilluar subjektin dhe për të depërtuar thellë në mendimin e tij. Megjithëse është krijuar brenda paradigmes së mediokritetit të zakonshëm, të një ekzistence që për karakter nuk është e aftë të fluturojë shumë lart, ai nuk sillet aspak si një i paaftë i fillimit të shekullit XX. Për t'u përfshirë në atë tipologji personazhi i mungojnë aspektet patologjike dhe ato që lidhen me neurozën, si dhe paaftësia absolute për të kryer veprime. Shazivari kryen shumë veprime, por problemi është se çdo logaritje e tij del e gabuar që në parakushtet e saj. Ai është, më prozaikisht, thjesht një i dobët që vuan dhe që në mënyrë të vetëkënaqësi kërkon një farë konsiderate. Në sajë të kësaj ndjeshmërie të tij, mbi të cilën hapen sporadikisht çarje lirike të shprehura përmes dialogut, Shazivari fiton faqe pas faqeje të drejta dhe dinjitet në sytë e lexuesit. Këmbëngulja e tij e pavetëdijshme për të mos kuptuar logjikën e jetës shfaqet përmes një artifici retorik, atë të përsëritjes, ku shohim formulave konsistente që kthehen e rikthehen gjithmonë identike në të folurit e në detajet – supra me paçe, gota e vogël e rakisë, udhëtimi me ndonjë makinë të rastit, rrobat e vjetëruara – që e karakterizojnë në kuadër të një detyrimi të përsëritur. Edhe fjalimi i gjatë që zë vend në dialogun grotesk përfundimtar mes tij dhe Dulejmanit duhet parë në këtë këndvështrim. Shazivari duket se ka fituar një formë të re mendësie në burg, falë aktit të leximit. Pas një studimi të kujdesshëm të librit të Jacques Monod, *Rasti dhe domosdoshmëria* (1970), duket se ka reflektuar mbi jetën dhe domethëniet e saj, duke maturuar një qëndrim mjaft të ngatërruar që vendos në qendër të veprimeve një lloj determinizmi të rastësishëm, totalisht të ndarë nga vullneti i individit. Nga ai libër dhe nga mendimi i Monod, Shazivari është në gjendje të kuptojë vetëm disa pasazhe, duke i thjeshtuar dhe banalizuar ato, dhe duke i reduktuar sërish në një karikaturë. Dimensio i tij i privilegjuar nuk është ushtrimi i mendimit, e aq më pak veprimi: është në nënshtrimin ndaj vetvetes dhe zakonshmërisë së tij që Shazivari jep më të mirën e vetes, duke respektuar strategjinë e krijesës-shënjestër që Aliçka ka parashikuar për të që në rreshtat e parë të romanit.



Piktori, eseisti, kuratori, historiani dhe kritiku i artit shqiptar Ph.D. Oltsen Gripshi, paraqitet kësaj rradhe me një studim mbi krijimtarinë e artistit Edi Rama. Ky studim monografik titullohet *Neuroestetika e një artisti* (Në psikologjinë e krijimtarisë së Edi Ramës) dhe është sjellë nga shtëpia botuese Onufri. Një studim i thellë mbi veprën e artistit që na ofron një pasqyrë të zhvillimit të tij artistik, teknikave që ka përdorur dhe mesazheve që shfaqen e përcillen në veprën e tij. Këndvështrimi nga e ka parë veprën e artistit është i qartë që në titull dhe është argumentuar hap pas hapi: *Neuroestetika e një artisti*. Neuroestetika përfshin studimin se si truri ynë reagon dhe përpunon veprat artistike duke eksploruar lidhjet midis përvojës estetike dhe strukturave e funksioneve të trurit. Disiplina në fjalë hulumton mënyrën se si elementët pamorë të artit, si: ngjyrat, format dhe kompozimi aktivizojnë pjesë të caktuara të trurit dhe ndikojnë në emocionet, perceptimin dhe në kujtesën tonë.

Në këtë studim monografik, ngrihet një marrëdhënie autor – artist që ndikon drejtpërdrejt në të kuptuarit dhe më pas në prezantimin e veprës së artistit, ku autori pozicionohet në rolin e ndërmytesuesit midis artistit dhe publikut. Ky binom artistik do të na udhëheqë në një udhëtim njohjeje ku autori dhe artisti, bashkëpunojnë për të na sjellë një përvojë të plotë të krijimtarisë artistike. Hapat e studiuesit Gripshi në këtë rrugëtim janë të sigurt dhe na sjellin një analizë të plotë të veprës, plot objektivitet dhe thellësi mendimi, një analizë të stilit, teknikave që ai përdor dhe simbolikës në veprën e artistit Rama. Ndihma që studiuesi jep në këtë rast është përmbushja e misionit të tij në interpretimin e veprës së artistit dhe ngritja e një ure komunikimi midis tij dhe publikut.

Analiza e veprës së Edi Ramës është një analizë a arrirë, ku autori ka ruajtur ekuilibrin midis fakteve dhe perspektivave të tij vetjake, duke krijuar kështu një baraspeshë mes tyre. Teksti ka një strukturë të mirëorganizuar dhe ndarje logjike të cilat shërbejnë si pjesë të një të tere që na vjen në fund të kësaj analize studimore të thellë. Përmendim këtu: **Plazma e psikologjisë së kohës përmes membranës abstraksioniste lirike në nënvetëdijen e një artisti ku më pas kemi degëzime si: Parathëniet e një piktore; Psikologjia si psiskika e imazhit fenomenologjik; Neuroestetika: sinteza e imazhit arketipal mendor; Estetika semiotike: thelbi gnoseologjik përtej formave; Midis imagjinatës dhe reales; Imagjinata, përjetimi, krijimi; trupi: çelësi i ontologjisë së imazhit; Krijimi si shëmbëllturyrë antropike e realitetit; E pavetëdijshmja si paradigmë e gjuhës pamore dhe Imazhi mnemonik përtej psikologjisë dhe estetikës bashkëkohore.**

Përsa i përket stilit të shkrimit të këtij studimi monografik ai është shkruar në mënyrë të atillë që të ndiqet lehtësisht nga kategori të ndryshme lexuesish duke u bërë jo vetëm një dokument historik, por edhe një burim frymëzimi për dashamirësit e artit dhe për studiuesit e ardhshëm. Studimi është shoqëruar me imazhet e veprave të përzgjedhura të artistit Rama të realizuara në kohë të ndryshme për të patur një fushëpamje të gjerë të krijimtarisë së tij dhe përshkrime pamore cilësore, ku kulminacioni i këtij studimi shkencor që përbashkon brenda tij historinë e artit, neuroestetikën, filozofinë e artit dhe semiotikën, qëndron në përshkrimin dhe njesimin e vizualitetit: veprat përshkruhen në mënyrë të atillë që lexuesi të krijojë një përfytyrim të qartë të qasjes estetiko-konceptuale dhe teknikës së artistit, edhe kur nuk ka qasje direkte te imazhet. Në ndihmë të lexuesit vjen fjalorthi në fund të studimit, i cili jep shpjegime për

Monografia shkencore e Ph.D. Oltsen Gripshit: “Edi Rama: neuroestetika e një artisti”

Nga Teuta Dhima



termat profesionalë të përdorur gjatë analizës studimore të veprës. Monografia studimore është dygjuhëshe: në shqip dhe në anglisht, duke i dhënë mundësi artit dhe kulturës shqiptare të prezantohet në arenën ndërkombëtare dhe të promovojë dialogun ndërkulturor.

Studimi monografik kushtuar veprës së artistit Edi Rama, ashtu si edhe çdo monografi tjetër studimore merr rëndësi, pasi siguron një dokumentim të qëndrueshëm të veprave dhe krijimtarisë së artistit. Ndodh jo pak herë që veprat artistike janë të vështira për t'u ruajtur, ndaj mbledhja dhe analizimi i tyre i bën ato të arritshme ndër breza.

Duke u studiuar krijimtaria e një artisti, krijohet edhe një fushëpamje historike dhe kontekstuale. Studimi kritik dhe përmbledhja e të gjithë krijimtarisë

ndihmon për vendosjen e veprave të artistit në kontekstin e periudhës dhe lëvizjes artistike të kohës. Kjo gjë bën të mundur që të kuptojmë më mirë ndikimet historike, kulturore dhe ato vetjake që kanë formësuar stilin dhe tematikat e artistit. Sipas historianit të artit Ph.D. Gripshit, piktura e Ramës i përket një astraksionizmi lirik pasbashkëkohor dhe ajo çfarë vërtet e spikat pikturën e tij, është përfshirja psikoshpirtërore në paraqitjen me sinqeritet të karakterit vetjak. Abstraksionizmi lirik pasbashkëkohor në analizën që Ph.D. Gripshi bën në këtë monografi shkencore e identifikon si rrymë të lindur me artin e Ramës. Një rrymë e re, e cila përqendrohet te shprehja emocionale, intuitive dhe shprehja e lirë e nënvetëdijes së artistit përmes formave, ngjyrave dhe gjesteve të pikturës

abstrakte. Artisti Rama në imazhet që konkretizon në letër nuk tregon atë që sheh, por atë që ndien, atë që objekte apo situata të caktuara kanë përcjellë tek ai duke e nxitur të krijojë një realitet të ri, siç është piktura e tij.

Veprat e artistit Rama, thekson Ph.D. Gripshi, janë të shumëanshme, ato variojnë nga piktura në qeramikë. Dy teknika të kundërta mes tyre, ku njëra sfidon sipërfaqen e sheshtë, ndërsa tjetra sipërfaqen e modeluar e shndërron në pikturë. Komunikimi që kalon përmes estetikës semiotike është gjithmone i njëjtë: bukuria e brendshme e psikikës nga ku burojnë imazhet imagjinare plot energji ngjyrash dhe lëvizjesh.

Duke vëzhguar veprat artistike të Ramës, nuk mund të mbetesh indiferent ndaj formës së tyre. Një pikë me rëndësi ku studiuesi është ndalur duke na sjellë pohimin se forma në artin e Edi Ramës, është një mënyrë për të arritur shprehjen e vetvetes. Ai e përdor formën jo vetëm si element semiotik komunikues përmes shenjave, por edhe si element ontologjik të përmbajtjes së artit formal.

Në këtë udhëtim njohjeje me artistin Rama, nuk mund të lemë pa përmendur, vendin që i jep studiuesi Gripshi, imagjinatës në krijimtarinë e artistit. Imagjinata është pikënisja e krijimit të imazheve abstrakte antropomorfe në artin e Edi Ramës. Në veprat e tij, imagjinata është pika ku kryqëzohen arti dhe dija, të cilët na krijojnë një përmasë të tretë, atë të abstraksionit lirik.

Kur flet për krijimin si shëmbëllturyrë antropike e realitetit studiuesi Gripshi i jep një mbyllje shumë interesante kësaj ndarjeje studimore të cilën po e sjell: *Për një analizë sa më të plotë të krijimtarisë së Ramës nuk mjafton vetëm ta njohësh atë si genie natyrore fiziologjike, apo si genie shoqërore politike; por është e nevojshme të njohësh aftësitë e tij për të shkruar përtej reales përmes artit pamor. Ai si artist, duke riformuar realitetin nëpërmjet formave astrakte dhe veprimeve krijuese, arrin ndryshimin e fatit që pësoi si genie fiziologjike dhe shndërrimin e asaj që i caktoi shoqëria, në tingull vlere antropologjike.*

E pavetëdijshmja si paradigmë e gjuhës pamore, është një nga ndarjet që paraqitin mbylljen e studimit për krijimtarinë e artistit Rama, ku ashtu si gjuha ka të njëjtën strukturë themelore, gramatikën, edhe artisti Rama ka gjuhën e tij pamore, stilistike, për të komunikuar me masën dhe vëzhguesin e atrit që krijon përtej vetvetes. Gripshi citon Frojdin për të na sjellë dy boshtet e rëndësishme të gjuhës në raport me interpretimin e pavetëdijes: *boshtin e ngjeshjeve – zëvendësimeve (metafora) dhe boshtin e zhvendosjeve-kombinimeve (metonimia). Metafora dhe metonimia sipas Gripshit janë thelbesore në analizimin e pavetëdijes si paradigmë e gjuhës pamore në krijimtarinë e Ramës.*

Monografia shkencore mbi krijimtarinë e artistit Edi Rama na ofron ne lexuesve, një interpretim të thelluar dhe të udhëhequr mirë mbi vlerat e veprës së artistit. Jo pak herë mund të ndodhë që veprat abstrakte, ose me një simbolikë të ndërlikuar mund të jenë për t'u interpretuar për shumë shikues. Analiza e tyre na ndihmon të nxjerrim në pah mesazhet dhe ndjenjat që artisti ka dashur të përcjellë. Në përfundim të këtij udhëtimi njohës ku binomi autor – artist si një marrëdhënie kyçe na ka shoqëruar, mendoj se Ph.D. Oltsen Gripshi me studimin e tij ka dritësuar, vlerësuar dhe interpretuar thellësisht veprën e artistit Edi Rama duke arritur në një përfundim gjithëpërfshirës të cilin e gjejmë edhe si citat hyrës në këtë monografi shkencore kushtuar artistit: *Piktura e Edi Ramës mishëron materien ekzistencialiste si pararendëse e imagjinatës së përbërë nga kohë – hapësira, pasi ky hulumtim shkencor nuk i përket piktorit, por pikturës së tij, sepse Ai është vetë ky libër...*



Vëllim poetik që tërhoqi vëmendje në ambjentin kulturor të Tiranës. Autori vuri në dukje se poezitë në libër janë "përjetime reale", përmes të cilave ka shprehur gjëra që nuk mund t'i shprehte në një formë tjetër arti të shkruar. Poetë dhe studjues të poezisë thonë se, një poezi është një deklaratë me fjalë për një përvojë njerëzore. Nëpërmjet informacionit shqisor nga këto përjetime, imagjinata e poetit të goditur emocionalisht eksploron temat komplekse si dashuria, humbja, bukuria, dilemat njerëzore, gjëndja degraduese njerëzore, etj, dhe krijon atë që quhet e vërteta subjektive e poetit e cila, si "deklaratë me fjalë e tij" përcillet të lexuesi përmes të vërtetave subjektive, si një metaforë ku një vëmendje e veçantë i kushtohet ngarkesës emocionale të gjuhës. Struktura e vëllimit në katër "dosje përjetimesh të autorit" e ndihmon lexuesin për të kuptuar sesi është filtruar dhe transformuar përvoja reale, faktike, përmes këndvështrimit dhe thjerrëzës krijuese të poetit në të "vërtetën subjektive" të tij.

Duke lexuar poezinë "Atdheu" përjetimi imagjativ më sillte në vëmendje imazhe që i kisha të para diku, të përjetuara në formë tjetër, sikur të isha i familjarizuar me to. Besoj se duhet të jesh shumë i lidhur me atdheun për të arritur që, përjetime tronditëse ndjenjash t'i transformosh emocionalisht në krijesa artistike si poezi, por edhe si pikturë, skulpturë, muzikë, etj.

Nën efektin emocional të poezisë "Atdheu" imagjinata projektoi imazhin e gjallë të pikturës së Edison Gjergos "Epika e yjeve të mëngjesit". Piktura po më fliste me të njëjtën atmosferë emocionale si në poezi. Kushedi sesa të vërteta të dhimbshme i kishin rënë mbi kurriz atdheut, që të përjetuara tronditshëm nga piktori, imagjinata ia kish transformuar në imazhe piktoreske në "fabrikën e tij të ngjyrave. Piktura më përcillte emocione të thella për gjëndjen njerëzore me dramën e luftës, dilemat, brengat, dyshimet, pendimet, humbjet, braktisjet, brerjet e ndërjegjes të partizanëve përpara agimit dhe udhëkryqeve të perspektivës. Në historinë e poezisë shqipe ka shembuj të poetëve të njohur shqiptarë ku poezia, për shkak se shpesh përdor imazhe, simbole dhe gjuhë të pasur shqisore, është veçanërisht e përshtatshme për këtë marrëdhënie simbiotike me pikturën. E rilexova "Atdheun", më goditi fuqishëm rileximi, gjuha figurative, simbolizmi, aliteracionet, metafora, më lëvizën imagjinatën përmes thjerrzave të pikturës të cilën, një studiuese e kish quajtur "Ligjërata e së vërtetës". Intuitivisht poezinë "Atdheu" e quajta "Poezia e imazheve të vërteta". Imazhi ia shtoi thellësinë dhe pasuroi narrativën poetike, duke e bërë atë më interesante dhe të paharrueshme. Në këtë rast asociacioni poezi-pikturë si një dilemë ekzistenciale për piktorin në vitet e egra të diktaturës dhe për poetin pas përmbysjes së diktaturës në vitet e kaosit të shoqërisë, si lexues më lejoi të shoh, dëgjoj, shijoj, prek dhe nuhas historinë estetike. Atë që sa më shumë lexojmë, aq më shumë kuptojmë se nuk e njohim.

Mendova mos ndoshta asociacioni poezi-pikturë i këtij momenti ishte një përkim i rastit që nuk do përsëritej me poezitë e tjera të vëllimit. Për të mirën time isha i gabuar.

"Marsh nëntokë, Vdekja e minatorit, Somnabul, Nata e parë" etj, janë disa tituj poezish me vizatime portretesh bashkëpunëtorësh të inxhinierit poet, ku vetmia, varfëria, hallet familjare, ftohtësia e nëntokës, jeta e izoluar thellë brenda pyjeve e maleve, fytyrat e tyre të markuara nga dilemat e konflikteve të brendshme, të palumtura, jeta që bëjnë, me shumë pak

Vëllimi poetik i Mero Bazes

VËLLIMI "SHI ME BALTË", MARRËDHËNIE SIMBIOTIKE POEZI-PIKTURË

Nga Minella Aleks

shpresa për të ardhmen e fëmijëve, të ngjallin ndjenjë trishtimi, portrete që sfidojnë perceptimin sentimental të realitetit, edhe pse janë këta individë që i japin shoqërisë vlera të çmuara financiare, fatkeqësisht përkundër një jete tepër të mundimshme e plot privacione. Emotionalisht tronditës solidariteti me këta shpirtëra të pastër, keqardhje për luftën e tyre të përditshme me nëntokën. Mënyra sesi poeti Baze e inxhinieron makinën e fjalës dhe shpreh botën e ndjenjave të minatorëve tregon se është njohës i mirë i natyrës e psikologjisë njerëzore. Gjatë leximit të këtij "cikl i minierës" më qëndronte në vëmendje imazhi vizual i pikturës "Patatengrënësit" e Van Gogh. Ndoshta nga koha kur e kisha parë, më kish mbetur në kujtesë imazhi i jetës së paidealizuar të fshatarëve të varfër që mblidhen në mbremje në një dhomë të errët ku i vetmi burim drite vjen nga feneri me naftë në qendër të saj, varur në trarët e tavanit bën që atmosfera të dominohet nga ngjyra të errëta dhe të zymta, të dhimbsen me shprehjet e fytyrës që mbeten në një thellësi të tyren, pandryshueshmërisht mosbesuese, ku i pazakonshëm detaji me duart dhe fytyrat në ngjyrë dhe modelim si

patatet me të cilat ushqehen. Piktori duhet t'a ketë përjetuar emocionalisht shumë keq gjëndjen e vështirë, dëshpërueshëm pesimiste, të fshatarëve në kohën kur zhvilloheshin tratativava të lodhëshme, pafundësisht të zgjatura, për çmimet në shitjet e patateve Europë-Amerikë, që në betejën për mbijetesë bëheshin tepër të komplikuar nga prania e të tretëve. Sikur të mos kesh njohuri mbi autorin e pikturës, dhoma e errët mbi tokë e "patatengrënësve" dhe ata vet, ngjajnë identikë me një moment ngrënieje vakti të minatorëve në një galeri të errët miniere thellë nëntokë. E kritikuar shumë fillimisht "Patatengrënësit" sot mbahet si një nga më të mirat e Van Gogh.

Më sjell në mend atë që shkroi Horaci në shekullin e parë para Krishtit: "Siç është piktura, po ashtu është poezia". Njëra flet me heshtje, tjetra me fjalë. Në historinë e arteve poezisë i detyrohen të gjithë të tjerat, sepse në qindra vjet poezia ka ndikuar në artet e tjera dhe anasjelltas. Që nga antikiteti poetët kanë formësuar jetën e njeriut. Thonë se fuqia e poezisë qëndron në aftësinë që ka për të hedhur një dritë mbi botën, në vizionin që na zbulon të vërtetat mbi jetën. Veçova një tjetër poezi




nga vëllimi. Në poezinë "Nëna dhe zogjtë" poeti i ka ngritur një monument shpirtëror dashurisë së nënës për fëmijën, për djalin që e pret të kthehet nga shkolla në shtëpi për pushimet e dimrit. Të gjithë i duan zogjtë, këtë krijesë të egër që e adhurojnë sytë dhe veshët tanë, simbol i lirisë në fluturim. Edhe pse zogjtë i adhuron, i dhimbsen, i ushqen, verigen e zgjedhur të rrushit në oborr nëna e poetit nuk ua lejon që ta trazojnë. E ruan për djalin, me sytë nga rruga, e pret të vij nga shkolla, rri, rri dhe del, ngre duart lart me fshesën e oborrit në dorë, mermërin e u kërkon këtë të mos ia prekin, e kam të djalit u thotë. Këtë ndjenjë dhe emocion të fuqishëm i ka dhënë poetit dashuria e nënës, goditje shpirtërore që me forcën e fjalës krijon imazh të gjallë që e përcjell drejt lexuesit. Ka pafundësi formash të shprehjes së dashurisë nënë-bir, por kjo e ruajtjes së veriges së rrushit për djalin, është ndjesia e fortë përjetuese në trurin e poetit. Nuk do çuditim nëse një ditë piktori që do e lexojë këtë poezi, do e hedhë në kanavacë si përjetimin e fuqishëm emocional vetjak. Në krye theksova se poezitë e vëllimit "Shi me baltë" janë poezi imazhesh të gjalla. Ka një poezi në kujtim të dy miqve të vet të larguar nga kjo botë, Olldashi dhe Runa, i vajton me ndjenjë dhe mungesën e vuan thellë. Bashkëbisedon në heshtje me ta, herë butë e herë më ashpër, u shpreh dhimbjen, brerjet dhe pendimet, bukur, në mënyrë figurative, me fjalë krenarie për miqësinë me ta. Nuk mund të të lërë indiferent,

Të gërryen në shtresat e "arkivit të nënvetëdijes" dhe të nxit imagjinatën drejt imazheve pamore apo dëgjimore të përjetuara kohë më parë.

Më krijon asociacion me një imazh tjetër dhimbjeje që shpreh piktori Vilson Kilica për mikun e tij Jakup Kerraj në pikturën e titulluar "Në varrimin e piktorit". Kaq tronditëse ka qenë humbja, nuk ka mundur të durojë më tej por i kthyer në shtëpi mbas varrimit të këtij piktori ka derdhur në kanavacë emocione të fuqishme, gjithë çka i vuante zemra për kolegën e talentuar.

Më bën të përjetoj paralelisht të dyja përvojat shprehëse të ndjenjave, të piktorit dhe të poetit. Kur ndodh që imagjinata krijuese e poetit "pikturon" me fjalë, injekton mendim imagjativ drejt imazheve vizuale dhe dëgjimore brenda lexuesit, e influencon atë drejt një rritjeje iluminuese. Prandaj e vërteta e një poezie mund të ndryshojë në varësi të përvojave kuptuese të vetë lexuesit, duke i shtuar një shtresë tjetër pasurie përvojës poetike. Është thënë dhe vazhdon të thuhet se: "Syri i njeriut shikon vetëm atë që mendja është e përgatitur që të kuptojë, shikon mendja, jo syri. Nëse them që kjo është mënyra ime e përjetimit emocional të vëllimit "Shi me baltë", do të thotë se ky është perceptimi im subjektiv, padyshim i ndryshëm ose jo, nga ai i një lexuesi tjetër dhe anasjelltas.

Në fund bëj pyetjen: a mund të rilexohet "Shi me baltë" njëlloj si rilexohet një prozë triller interesante? Mendoj "Po" mbasi brenda tij ekziston në një marrëdhënie simbiotike poezia e ndjenjës me imazhet, kujtimet, trillet letrare, fotografitë dhe ëndrrat e arteve të tjera.



“Nuk ka asnjë gjurmë të diskriminimit kundër hebrenjve në Shqipëri, pasi Shqipëria është një nga vendet e rralla në Evropë sot ku paragjykimi dhe urrejtja racore nuk ekzistojnë, edhe nëse shqiptarët janë ndarë në tri besime.”

—AMBASADORI AMERIKAN NË SHQIPËRI,
HERMAN BERNSTEIN, 1930-1933

Libri ‘Lulja e Vlorës’, i shkruar nga doktoresha Anna Kohen, është një rrëfim i rrallë dhe prekës për jetën e një gruaje hebreje të lindur në Vlorë, Shqipëri. Kohen na ofron një pasqyrë intime të jetës së saj në Shqipërinë komuniste dhe historinë e komunitetit hebre, duke sjellë një dritare për një kohë dhe vend të vështirë, që mbetet kryesisht i panjohur për lexuesit ndërkombëtarë. Ky libër, më shumë se një përmbledhje kujtimesh, është një testament për solidaritetin e jashtëzakonshëm të shqiptarëve ndaj hebrenjve, një marrëdhënie që ka kaluar përmes shekujve me histori të mbushura me sfida, por edhe me momente të jashtëzakonshme humanizmi

Anna Kohen kujton përjetimet e saj në një Shqipëri të izoluar nga pjesa tjetër e botës, por gjithashtu të ngrohtë dhe mikpritëse ndaj komunitetit të saj. Historia e familjes së Anna Kohen fillon në vitin 1938, kur prindërit e saj, së bashku me gjyshin dhe gjyshen, u vendosën në Shqipëri. Në atë kohë, ata u bashkuan me një komunitet të vogël hebrenjsh Romaniotë që kishin ardhur nga Janina dhe ishin vendosur në Vlorë. Ky komunitet, edhe pse i vogël në numër, kishte një kohezion të jashtëzakonshëm. Pas Luftës së Dytë Botërore, kur në Shqipëri u instalua regjimi komunist, familja Kohen, edhe pse shtetas grekë, nuk arriti të largohet nga Shqipëria, duke mbetur e bllokuar në këtë vend ku lindi dhe u rrit Anna së bashku me tre motrat e saj.

Ajo përshkruan jo vetëm sfidat e përditshme të jetës gjatë periudhës komuniste, por edhe aktet e vogla dhe të mëdha të dashamirësisë që karakterizuan marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe hebrenjve. Një ndër episodet më prekëse në libër lidhet me ruajtjen e identitetit hebre nga fqinjët shqiptarë, të cilët shpesh ndihmonin familjet hebreje të ruanin traditat dhe vlerat e tyre fetare, edhe kur rrezikonin vetë. Kohen sjell në kujtesë momente të vogla, si festime të fshehta të Pashkës hebraike, apo mbështetjen e fqinjëve për të fshehur simbolet hebraike gjatë kohës kur feja ishte ndaluar nga regjimi. Qyteti i Vlorës mbetet një monument i mikpritjes në kujtesën kolektive të shqiptarëve për hebrenjve në territoret shqiptare në shekullin e XV. Në shekullin e XV, 528 familje hebreje u vendosën në këtë qytet pas përndjekjes së inkuizionit në Spanjë. Në shekullin e XVI, Vlorë u shndërrua në një qendër shqiptaro-hebre, ku komunitetet bashkëjetuan në harmoni, duke ndarë jo vetëm hapësirat e banimit, por edhe ekonominë dhe kulturën. Në këtë periudhë, hebrenjtë sefarditë zhvilluan tregtinë me qytetet e bregut perëndimor të Adriatikut, duke përdorur portin strategjik të Vlorës. Kohen thekson se bashkësia hebreje e Vlorës ishte një nga më të mëdhatë në rajonin e Rumelisë, pas Selanikut, dhe kjo pasuri kulturore dhe ekonomike ndikoi pozitivisht në zhvillimin e qytetit. Libri është një dëshmi e rëndësishme e pranisë së komunitetit romaniot hebre në Shqipëri. Hebrenjtë Romaniotë, ndryshe nga herbenjtë Ashkenazi të Europës Qendrore dhe Lindore apo Sefarditë me origjinë nga Spanja dhe Portugalia, kishin një kulturë dhe histori unike, që shpesh është lënë në

“Lulja e Vlorës”: Kujtimet e një gruaje hebreje në Shqipërinë e mikpritjes dhe solidaritetit

Nga Dr. Dorian Koçi

hije nga ngjarjet më të mëdha historike. Përmes kujtimeve të saj, Kohen shpjegon se ky grup hebrenjsh, përfshirë ata nga Janina, Vollosi dhe Kavalla, kishte ruajtur traditat e veta për shekuj me radhë. Në librin e saj, ajo ndan momentin kur, pas leximit të një libri në vitet ‘80, kuptoi për herë të parë që ishte Romaniote, një fakt që e lidhte atë me një prej komuniteteve më të vjetër hebreje në rajon. Kjo reflektim ndihmon lexuesin të kuptojë më thellë ndërlidhimet e identitetit hebraik dhe diversitetin brenda vetë kulturës hebreje.

Një pjesë thelbësore e librit i dedikohet periudhës së Luftës së Dytë Botërore, kur Shqipëria u bë një strehë për hebrenjtë që i shpëtuan Holokaustit. Anna Kohen përshkruan përpjekjet heroike të shqiptarëve për të mbrojtur hebrenjtë nga ndjekja naziste, duke i fshehur në shtëpitë e tyre dhe duke rrezikuar jetët për të siguruar mbijetesën e këtyre familjeve. Një shembull i prekshëm është strehimi i hebrenjve në fshatin Trevllazër të Vlorës. Familja e Kohen gjeti strehim në fshatin Trevllazër, në familjen Lazaj, ku u mbrojtën nga banorët myslimanë, të cilët ndanë gjithçka me ta. Familjet shqiptare aty jo vetëm që i strehuan hebrenjtë, por ndanë

gjithçka që kishin me ta, duke treguar një solidaritet të jashtëzakonshëm. Këto akte të humanizmit janë dokumentuar edhe në arkivat ndërkombëtare, si në Muzeun Yad Vashem në Izrael, ku shqiptarët janë njohur si “Të Drejtët midis Kombeve.” Dokumentet e ruajtura në Muzeun e Holokaustit në Uashington dëshmojnë për këto përpjekje, me emrat e 2,264 hebrenjve të shpëtuar nga shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këtë ndihmë dhe solidaritet të shqiptarëve me hebrenjtë e ka njohur edhe vetë komuniteti hebraik i Shqipërisë që në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, ku mes të tjerash spikat shkrimi i Inxhinierit hebre Samuel Mandili më 20 shkurt 1945 në Gazetën “Bashkimi”: “Të gjithë hebrenjtë që erdhën nga Shqipëria u shpëtuan falë mirësisë bujare të popullit shqiptar që e konsideronte detyrën morale për të mbrojtur të gjithë emigrantët e persekutuar në shtëpitë e tyre [...] Qëndrimi i mrekullueshëm dhe fisnik i popullit shqiptar duhet të njihet sepse ata meritojnë të gjithë mirënjohjen e botës dhe të çdo njeriu të arsimuar [...]”


Libri ‘Lulja e Vlorës’ nuk është vetëm një rrëfim personal, por edhe një dokument historik që ndriçon një



aspekt të rrallë të marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe hebrenjve. Ai na jep një pasqyrë unike të solidaritetit dhe bashkëjetesës që u përballën me sfida të mëdha, duke përfshirë pushtimin nazist dhe diktaturën komuniste Për shqiptarët, ky libër është një kujtesë e virtyteve që kanë karakterizuar historinë e tyre: mikpritja, solidariteti dhe humanizmi. Ndërkohë, për komunitetin hebre, ai është një dëshmi e rëndësishme për një kapitull të ndritshëm në historinë e mbijetesës së tyre. Rëndësia e këtij libri pasqyrohet edhe në përpjekjet e sotme për të dokumentuar dhe përjetësuar këtë histori. Në Vlorë, po përfundon ndërtimi i Muzeut Hebraik, një projekt që synon të ruajë dhe të promovojë trashëgiminë hebreje në Shqipëri. Ky muze do të shërbejë jo vetëm si një qendër kujtesë, por edhe si një urë midis brezave, duke ndriçuar vlerat universale të bashkëjetesës dhe respektit të ndërsjellë. Në këtë kontekst libri i Dr Anna Kohen merr një rëndësi të veçantë pasi shërben si një dëshmi kryesore e jetës social hebraike në Vlorë deri në vitin 1966, vit në të cilin ajo largohet nga Shqipëria.

Dr Anna Kohen, përmes kujtimeve të saj, tregon jo vetëm për sfidat e së kaluarës, por edhe për fuqinë e shpirtit njerëzor për të kapërcyer vështirësitë. Pas largimit nga Shqipëria në vitin 1966, ajo vazhdoi studimet për stomatologji në Greji dhe më pas u vendos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vitin 1991, me ndihmën e organizatave hebraike, ajo arriti të transferonte 37 anëtarë të familjes së saj në SHBA, një akt që pasqyron përkushtimin e saj ndaj familjes dhe komunitetit. Angazhimi i saj ndaj shqiptarëve nuk u ndal këtu. Si kryetare e organizatës së grave shqiptaro-amerikane “Motrat Qiriazit” për më shumë se 25 vjet, ajo ka organizuar aktivitete edukative dhe humanitare për shqiptarët në të gjithë botën. Gjatë krizës së Kosovës në vitin 1999, Kohen luajti një rol aktiv në ndihmën humanitare për refugjatët shqiptarë, duke demonstruar lidhjet e saj të thella me popullin shqiptar. Për këtë kontribut, në vitin 2004, ajo u nderua nga Presidenti i Shqipërisë me medaljen “Për Merita të Veçanta Civile.”

Libri ‘Lulja e Vlorës’ është një thirrje për të mos harruar të kaluarën dhe për të mësuar nga vlerat e solidaritetit dhe humanizmit që e karakterizojnë atë. Përmes një stili të thjeshtë dhe të ndjerë, Dr Anna Kohen i fton lexuesit në një udhëtim në kujtimet e saj, duke ndarë gëzimet, dhimbjet dhe shpresat e një kohe që ka kaluar, por që mbetet e gjallë në kujtesën e saj. Ky libër nuk është vetëm një testament për jetën e një gruaje të jashtëzakonshme, por edhe një monument për virtytet e një kombi që, pavarësisht sfidave, ka treguar gjithmonë anën më të mirë të njerëzimit. Për shqiptarët dhe hebrenjtë njëkohësisht, ai mbart një trashëgimi të çmuar, që frymëzon brezat për të ndërtuar ura të reja mirëkuptimi dhe bashkëpunimi në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar.



Kur qesh ba camardhok, nana më merrte shpesh në ceremonitë mortore jo vetëm në fshatin tonë, por edhe në zona të tjera. Në fillësë nuk doja, qaja e ndjehesha keq. Nuk e duroja qenien time pranë një njeriu që nuk jeton ma, që nuk flet as frymon. I qeshë bindur vullnetit të çuditshëm të nënës sime.

Më tregonte e ritregonte vdekjen dhe përcjelljen e katër djemve të saj e vëllezërve të mi, që kishin ardhë e ikur nga kjo botë para se unë të vija në jetë. Fillova ta ndjej fort e më fort dhembjen e saj. E, që asohere i kam në kujtesë imazhet tronditëse, mënyrën se si vinin gratë e katundit dhe të miqve të largët.

Me një rregull e solemnitë, banin një hap e thoshin një varg. Në fakt e këndonin me një drithërimë therëse. Pas tyre rreshti tjetër përsëriste si rregull po ato fjalë, e jo rrallë korrektonin ndonjë lapsus, duke i dhënë vajtimin ritmin e kërkuar.

Prologu i vajeve ishte idhnimi që kishte sjellë lajmi se miku a shoqi kishte ndërruar jetë. Mandej në një farë mënyre rrëfehej nekrologjia e të vdekurit, bëmat, punët e mira, gjeneza familjare, gjendja civile e tij. Kënga e vajit në frymën e saj të përgjithshme kishte si mision ta sjellte profilin e njeriut që kishte ndërruar jetë, pozitivisht. Thuheshin atë ditë të fundit mbi dhe fjalë të mira, ani se nuk ishte e gjitha ashtu.

*

Ka gjithfarë vdekjesh. Djemtë e rinj si me ta pre kocin, sillnin gjamë me trand bjeshtë e male. Por, diku vritej tjetri për ngatërresa, për hajni, për qentë (keto ishin shumë të rrezikshme), për shkelje morali. Kishte vdekje prej kalit si në legjendat tona, prej pakujdesisë me armë, prej budallallëkut, ndonjeherë.

Kësisoj, vajet nuk ecnin si në vaj. Vajtojat nuk e ndinin vedin mirë pa ja përmend në një mënyrë atë që e rëndonte profilin e të ndjerit. Sidomos, kur vajtojat e çonin në qiell me lëvdata të pameritueme, ku dukej bufonata, grotesku, trajtat e komikes në përgjithësi. Në këto rasa fillonte reagimi i rendit tjetër të vajtojcave. Në fillim, me përmbajtje e me tone qortuese për vajtojat, por kthjellonin edhe të pranishmit se i ndjeri nuk ishte aq sa e naltonin vajtimoret, përkundrazi ka qenë një njeri i ngratë.

Fjalët e vajit ndiheshin me dy palë veshë, që rreshti tjetër të ishte i qartë përse ishte thënë. Por, kur vijojej të teprohej pafund me lëvdata, atëherë vajtoja e radhës merrte detyrën me e çart atë atmosferë hipokrite. Po me se, me nderhyrje te drejtuesja? Jo. Ajo, nëpërmjet vargjeve therëse e herë-herë me humor, aq sa me të ba me u shkye prej gazit, bash në mort.

Nëpër kohë kam shënuar shumë episode të rrëfya në vargje, ku trajtat e komikes, sarkazma, ironia jo rrallë e kanë shtang kortezhin e mbarë ceremoninë mortore.

*

Më, 1983, një bijë e Bardhajve të Selitës, e datëlindjes 1924, më rrëfëi se si e kishin vajtuar burrin, dy gratë e tij, në mort. (Në Mirditë kisha nuk lejonte dy kunorë, por raste të rralla ka pasur e, kjo ndodhte kur gruaja e parë ose nuk lindte fëmijë ose nuk kishin djalë. As kjo nuk përfillej nga kanuni i kishës. Ajo i shkishëronte dhe e varroste jashtë varreve të katundit).

Në viset e Veriut të Shqipërisë, gruaja ka tagër me e qa me fjalë burrin e saj, por vetëm e pa ia prit askush, duke ju drejtuar me togfjalëshin:

Or, tremthi em! (Or, trimi im)
Gruaja e parë vajtoi:
Kur e vejshe vargjun e sahatit,
Or tremthi em,
E ja vejshe shalën kalit,
Or tremthi em,
Shtangshin krenët e bajrakut
Or tremthi em,
T'rrishin pushkët në frangji,
Or tremthi em,

TRAJTA TE KOMIKES NDËR VAJET E MIRDITËS

Nga Viktor Gjokolaj



Gjushojshin qetë në hulli,
Or tremthi em!

I ndjeri kish qenë një burrë i urtë, por një shkretan, që nuk e kishte shoqin. Jo vetëm që nuk kishte kullë e kalë, e qe me plugue tokën, por kishte jetue në mjerim.

Kur gruaja vajton burrin ndiqet me respekt e kureshtje të veçantë, por në këtë rast gati shpërthyen të qeshurat.

Gruaja e dytë e korrigjon të parën, por me një humor të rrallë.

Ajo vajtoi:
Ej, ti s'ke qënë asoj burri,
Or tremthi em,
Veç ke pas një vargj unuri,
Or tremthi em,
S'ke pas kulla e saraje,
Or tremthi em,
Po ke pas një ksojë me kashtë,
Or tremthi em.
Pula mrena e bishti jashtë,
Or tremthi em!

Si shpallet më bukur komikja nuk ka. Kur kjo situatë krijohet, bash në ceremoninë mortore të një njeriu që ikën këso bote, në praninë e të afërmëve, miqve, shokëve merr ngarkesë të veçantë. Jo vetëm kaq, por mesazhi që jepet është i kthjelltë: ta përcjellim të ndjerin me kangavajin që meriton se ndyshe e rëndon më shumë jetën e tij modeste.

*

Kishte ndodh që, pa dashje, qe vra një bari në mes të moshës. Për t'a ba ngushëllimin sa ma prekës, vajtoja e çon në qiell statusin e bariut të gjerë, duke iu drejtuar:

"-Or filani, or kapidan!"
Reagimi është ba vrikthi nga vajtoja tjetër që priste radhën:
"-Na, po qajmë e po vajtojmë,
Shoqja-shoqen s'po e ranojmë,
Se janë vra turli-turlish,
Jo s'po vrasin, një çoban dhish!

Ndër male të Mirditës dhe jo vetëm, për shkelje të moralit kriste edhe pushka e vritej njeriu pa një pa dy. Edhe pse shumë e rëndë dhe e përdhosur shuarja e tij, gjindja ngrehte mortin e fjalëtorët merrnin udhën.

Në këso ceremoniale me ngarkesa të pazakonta, vajtimoret binin në hall, sidomos ato të miqve. Duhej thënë e vërteta, sidoqoftë.

Në Fan, një i spaças e kishte shkel etikën me një grue të re. E patën vra. Në vaji merret disi në mbrojtje gjaksi se kish qit pushkë për nder. Pos të tjerash ajo tërheq vemendjen të pranishmëve:

"Kush të kalojë nëpër Fan,
Mos ta ktheje kryet m'njant anë,
Se merr plumbin anë e mbanë!.."

Po shënoj edhe një episod tjetër me këtë argument, pra si e kanë vajtuar të vramin e zënë në flagrancë për amoralitet. Vajtoja këtu është racionale. Episodin e trajton si një moment fatkeq se njerëzia nëpër gjithë kohët ka ba flirte e shkelje të rënda deri në inçeste...

"Të gjith' kta, qi t'kan' rrethue,
or meku em!
N'pyll kan' hi, por s'kan' zhabllue,
or meku em!
M'spatë kan' pre, por s'kanë tokllue,
or meku em,
Por ty, t'met me e pague,
or miku em!"

*

Vdekjet e papritura e kanë vënë vajtojçen përballë përgjegjësive për sqjarimin e rrethanës.

Kishte vdek një nuse e re. Pa e filluar vajin, kanë ba pyetjen e zakonshme se nga i erdhi vdekja e papritur. Njëra nga gratë e shtëpisë ka thanë se nusja kishte pirë një kafe. Në rreshtin e dytë të vajit, ajo ka pyet me sarkazëm:

"Ajo kafe, që t'kanë dhanë
Ka qe e idhët paska qanë?!.."

Njerëzit kanë shtag para kësaj akuze të beftë. Kanë ndie dhe prindërit. Është dashur që i zoti i shtëpisë të bëjë be se vdekja e bijës së tyre kishte qenë një vdekje natyrale, se kafeja që kishte pirë bashkë me gratë e tjera nuk ishte shkaku i vdekjes së saj.

*

Në zonën e Rubikut, një i ri refugjat kthehet i vrarë nga policia greke. Vdekja ishte e randë. Pas fjalëve hyrëse vajtoja i drejtohet të ndjerit me plot sarkazëm:

"Fort kjo zemër po na dhem,
or meku em!
Po a thue bane ndoj gabim,
or meku em!
Se do gjana, s'kan durim,
or miku em!"

Mesazhi është i kthjelltë: Në dheun e huaj duhet të sillësh mirë e të mos bajsh faj se durimi ka një cak.

*

Nëpër eksplorimet e mia për këtë argument, kam identifikuar se vajtojcat kanë reaguar me sarkazëm edhe ndaj zhvillimeve politike ndër stinë të ndryshme.

Në Fan, aty nga viti 1948, vrasin një të arratisun, ma shumë për me u ruejt se u kishte dhanë bukë njerëzve të malit. Vajtoja, që e njihte mirë traditën e maleve tona për nderimin e mikut (mirditasit, në pjesën dërmuese u kishin dhënë bukë e kishin ndihmuar miqtë e njerëzit e zakonshëm për të nderuar vatrën e tyre e traditën se ishte turp mos me prituri e përcjellë atë që të vjen në shtëpi e jo thjeshtë kunder shtetit), dëshmon:

Paj janë ul malet,
or meku em,
E janë çue prrojnati,
or meku em!

Qartësisht ironizon pushtetin e ri, që po ban padrejtësi e po shkel mbi traditat shekullore të mikpritjes.

Në vitet '90-të në Thkellë, pasi i thotë punët e mira të të ndjerit, vujtjet e tij në kooperativën bujqësore, e mbylli vajin me këto fjalë:

"Se e dashtuna Partia e Punës,
or vllau em,
Na e pat pru shpirtin n'maje t' hunës,
or vllau em!.."

*

Nëna ime, si e thashë dhe kryehere, kishte përjetue një dramë me ikjen e katër djemëve të saj. Kisha vënë re se ajo, kur ishte vetëm niste e vajtonte, herë për njërin e herë për tjetrin, por edhe për të katër djemtë e shuar. E ndigjoja me vemendje atë elegji të nënës për bijtë e saj. Njëherë guxova e i thashë se tash nuk duhet me vajtu. Më dha të drejtë. "- Tash po rriteni ju e nana do knoje për ju, në gëzimet e dasmat tuaja. Fjala del prej shpirtit edhe kur dhemb edhe kur gëzon. Të kisha ditun shkrim, do t'i shkruaja. Njeriu gjithëherë qanë për hallet e dhimbjet. Ai nuk qan vetëm të dekunin, por qan dhe hallin e fatin e tij".

Më tregoi se si një grua e martuar te një shtëpi e varfër, qante hallin e fatin e saj me këto fjalë:

S'e kam ardh ke ky lanok,
of, moj nana eme!
Jam veshun me spathok,
of, moj nana eme!
Jam ngjesh me një konop,
of, moj nana eme!
Kam pa ftyrën n'nji lugj qeni
of, moj nana eme!
Jam kref me një boç arrneni,
of, moj nana eme!

Me i pas zili gjithkush këto fjalë. Një autoparodizim i fatit të mjerë.

*

Mirdita po e përcjellë ndër breza kangën e vajit. Rrallë mungojnë vajtimoret nëpër ceremonitë mortore në këto vise, edhe pse me ndonjë devijim të vogël si fjala vjen, disa vajtojnë vetëm, solo e pa pritje e përcjellje si ka qenë motit. Vajtojat janë barde tipike. Perpos vargjeve hyrëse a përmbyllëse, që thuajse thuren në çdo vaji, vargjet e tjera improvizohen drejtpërdrejt në ceremoninë e varrimit dhe interpretohen (këndohen prej sosh). Në kronikën e këtyre ceremonive, këto barde të shquara kanë shpalosur jo vetëm dhembjen për shuarjen e mikut, shoqit a njerëzve të dashur, por kanë reaguar ndaj shmangieve të identifikuar gjatë ceremonisë mortore. Shpesh edhe me sarkazëm, ironi e trajta të komikes, ashtu si u përpoqem ta shkruajmë në këtë esse.

Titulli i romanit më të ri, “Çmimi i atdheut”, i shkrimtarit Viktor Canosinaj, menjëherë të rifut në një botë letrare të njohur, po kaq edhe engimmatike, në kuptimin që atdheu është aty, por përjetimi i tij, te secili njeri, është një marrëdhënie e individualizuar, një ndjesi personale, pavarësisht se buron nga vetëdija, e lindur dhe e kultivuar. Teksti “Çmimi i atdheut”, pason pesëmbëdhjetë tekste romanesh për të rritur, me larmi tematike dhe shtjellime estetike, duke qenë njëri ndër autorët e përveçëm të letërsisë së sotme shqipëre, ndonëse shpërfaqet me një kohështrirje të gjerë imagjinare, gjithnjë si marrëdhënie simbolike, krahas famës së merituar si shkrimtar për fëmijë dhe të rinj, ndërkaq te ky tekst sugjeron disa aspekte të dhëniemarrjes me atdheun. Nga çmimi që përfaqëson ose ideja e parë, e çmimit të atdheut, është se kurrë ai nuk ka çmim, sepse realisht nuk ka asnjë vlerë në shpinë të tokës, për të vlerësuar përmasën e atdheut. Rrjedha e ngjarjeve të sjellë në mend idenë e Hippolyte Taine, te libri “Filozofia e artit”, që përcakton: ...shkrimtarët janë psikologë, dhe arrijnë të tregojnë jo vetëm të gjitha variacionet, por edhe të gjitha pasojat...[1]. Pastaj, në ngjarjet që rrjedhin në raportet ndërkohore, në dhëniemarjet shoqërore dhe individuale, me gjasë si një rregull i pashkruar, në fatin e personazheve, del në pah fakti tronditës, që megjithatë atdheu e ka një çmim, ndonëse shpalohej me dy pamje, të larguara gjer në skaje, së pari të japësh jetën për atdhe, kur e lyp nevoja, së dyti, tanimë një pamje e përmbytur, atdheu edhe të vret dalëngadalë. Në fakt të vret njerëzia me panjerëzi, jo atdheu i kodrave dhe maleve, i fushave dhe deteve, lumenjëve dhe liqeneve. Piskama, etike dhe estetike, e shpallur në faqet e librit, mbi “çmimin e atdheut”, ndërkohë merr një trajtë tjetër, gati kozmogonike, atëbotë kur fati i personazhit/personazheve, lidhet shpirtërisht me një testament, të një idividi jo të zakonshëm, lidhet ngushtësisht me porosinë, gati hyjnore: “Amaneti im i Fundit është që ta doni atdheun edhe kur ai të vret...”, të Dhimitër Paskos, mjeshtrit të prozës dhe rrëfimit, në letrat shqipe. Rimarrja e amanetit, të pashoq në dëshminë e atdhetarisë, në faqet e romanit “Çmimi i atdheut”, as më pak e as më shumë, tregon se ky testament, në kohë dhe hapësirë, vetiu është shndërruar në një mesazh përtrimës, si dhe prekja në këtë vatrë, kur atdheu po braktiset, po bjerret çdo ditë, shënon një akt shpirtëror dhe estetik, që meriton vëmendje...

Implikimi i autorit

Libri për vlerën e atdheut, paraprihet nga një shënim autorial, që kryen funksionin e një parateksti. Kjo situatë paraprirëse e romanit shënon një “implikim” të autorit, ndonëse qëllimor, gjithsesi përfaqëson një sugjerim autorial për të dekoduar tekstin e romanit. Dalja hapur e autorit, me pohimin: “...të nderuar lexues, personazhet e këtij romani janë fryt i trillimit artistik të autorit”, si një reagim autorial. Në letërsi në përgjithësi, edhe në shkrimin e prozës, sidomos të romanit, rol parësor dhe formues, ka përjetimi imagjinari i realitetit letrar, që dukshëm shpalon një botë të trilluar. Romani është dëshmi e vështrimit të botës përqark, gjithnjë me sytë e autorit, të përthyer në rrathët e imagjinare në botëperceptimin etik dhe estetik. Vetiu vjen sugjerimi i Roland Barthes, veçojmë pohimin: “Romani është Vdekje; ai nga jeta bën një fat, nga kujtimi një akt të dobishëm, e nga zgjatja një kohë të drejtura dhe domethënëse. Por ky shndërrim mund të përmbushet vetëm në sytë shoqërisë. Është shoqëria ajo që imponon Romanin...”[2]. Rrethana e “implikimit” të autorit, gati e pashmangshme e sendërtimit të ndërthurjes së reales me imagjinaren, ka bërë të jemi në letërsi. Aspekti tjetër, në rrafsh “implikues” të autorit, shpallet sërish në shënimin: “Ata janë frymëzuar nga fisi i mjegullt Bargjini, fisi Toptani...fisi Bushatliu...”, duke sjellë në vëmendje fise dhe familje të shquara, figura dhe personazhe të historisë shqiptare. Pra, nga sa ofron teksti romanor, duke ruajtur lidhjen me realitetin, si shtysë e prototipave,

Romanit më i ri, “Çmimi i atdheut”, i shkrimtarit Viktor Canosinaj,

“Çmimi i atdheut” – një roman testament atdhedashurie

Nga Behar Gjoka

Rrafshet e ligjërimit

Romani “Çmimi i atdheut”, në strukturim dhe në pentagramin rrëfimor, dy shtyllave të formësimit të prozës romanore, parashtrihet si materie letrare, në këto rrafshet ligjërimit:

A – Ndarja me disa kapituj kryesorë, të organizimit të materies letrare, e cila përbëhet nga njëzet e katër të tillë, që janë episode të gjata. Koha letrare, zë fill me dorëzimin e italianëve dhe ardhjen e gjermanëve, në vitet e Luftës së Dytë Botërore, e cila shkon deri në vitin 1947, koha kur për shqiptarët nisi viti zero, një metaforë e papritur e udhëtimit për theqafje, sepse aty ngjet shtetëzimi i pasurisë dhe shkatërrimi përfundimtar i pronës private. Kjo kohë historike, gjithsesi ngërthen në gjirin e vetë, epokën e luftës, humbjen e fashizmit, triumfin e sovjetizmit, që përkon me hedhjen e themeleve të botës së re, edhe në Shqipëri. Varësisht paraleles së segmentit kohor, të mishëruar në kohën letrare, kemi transformimin e vendit ku luhen ngjarjet, si dhe të protagonistëve/personazheve, të cilët shkojnë deri në përmbyse të plotë shpërftyruese.

B – Ndarja tjetër, pjesë e strukturës romanore, pak më ndryshe, vjen e shënuar me germa, duke filluar me shkronjën -a, ku ngjet ikja në kohë, deri në caqet e pranisë

së Perandorisë Osmane, të marrëdhënies së arbnoro-shqiptarëve me të, si dhe përcillet një dëshmi letrare, si dhe një gjurmë e historisë sonë, kohës së largët. Episodi që vjen i prezantuar me shkronjën -b, zbret në rrathët e legjendës së fisit, e cila shpalohej si përshkallëzim ekzistencial. Për të vijuar me -c, që bazohet në gojëdhëna, për të projektuar të kaluarën e largët. Te shkronja -d, shfaqet kështjella famëmadhe e qëndresës arbnore. Pastaj kapitulli me -e, i cili të shpie në motet e ngritjes së fortesave të hershme. Në vijim kemi episodin me -f, që përcjellë zallamahinë e dasmës. Për të ardhur te germat -g, ku sërish gëlojnë gojëdhënat, me germën -gj, ku ngjet kthimi në atdhe i Donat Damianit, për të vijuar me shkronjën me -h, pas arratis nga ishulli Egje, e më në fund me shkronjën -i, ku zbulohet jeta e fshatit. Pra, në dhjetë episode që emërtohen me shkronja, ku autori me vetëdije “arratiset” në disa gjurmë të historisë sonë, të përrallëzuara, njëherit duke ndërthurur kohët e ndryshme.


C – Shkrimi i letrave, me status të dëshmisë reale të protagonistëve kryesorë të tekstit. Një dëshmi e rrallë e gjendjes dhe fatit të personazheve është letra e Vesianës për Revigun, të jatin, ku prekim tronditjen nga rrjedha e ngjarjeve, po kaq ndeshim dashurinë e madhe të vajzës, ku veçohet pyetja: “Cili është atdheu im? Çfarë është ai për mua?”, sepse nga nëna ishte gjermane. Po në ato tone ligjërimore, të një dhimbe pakufi, është edhe letra e Revigut për të bijën, mbase tragjizmi i thellë, që shqiptohet në sugjerimin: “...të ndërtohet një atdhe tëndin...atdheu është ai vend ku ti ndihesh e lirë dhe e lumtur...”(2023: 364), sepse Shqipërinë, atëbotë e mori peng komunizmi.

Narratori dhe kronikani

Materia e romanit “Çmimi i atdheut”, si formë ligjërimit, sendërtohet si formësim i përveçëm narrativ. Për të endur realitetin letrar, të epopesë për atdheun, tanimë duke parashtruar, situatën e çmimit të atdheut, por edhe të fatit të qenies shqiptare, në projektimim e prozëshkrimin, të poetikës së prozës, si e formuloi T. Todorov, në hapësirën tekstologjike, autori ka marrë dy pozicione ligjërimit, atë të narratorit të gjithpranishëm dhe të autorit kronikan. Ideja e Zh. P. Sartri se: “...letërsia afirmon menjëherë pavarësinë e saj; ajo nuk do të reflektojë më shabllonet e mendimit të kolektivitetit, identifikohet me shpirtin, d.m.th me pushtetin e përhershëm për të formuluar dhe krijuar ide.”[3], shqiptohet si një univers letrar në këtë roman. Vetiu, në tekst kemi të plazmuar dy platforma të qarta ligjërimit, të gjithpranisë së librit, si univers real, që ndriçon pikën e kthesës së rrokullimës që mori fati i atdheut dhe qenies shqiptare, në kohën e luftës dhe në mbarim të saj. Në anën tjetër, rrëfimtari – kronikan, që hedh vështrimin nga fati historik, duke e sjellë në formën e përrallës, pra tipikisht si një ligjërimit i përrallëzuar, e zgjeron pentagramin rrëfimor. Kuptohet që realiteti letrar i tekstit romanor “Çmimi i atdheut”, e ka thurur ngrehinën e prozës, nëpërmjet dy tipeve të rrëfimtareve:

Së pari: Narratori i gjithpranishëm, që sendërgjon realitetin konkret, kohën letrare, që përkon me ardhjen e gjermanëve dhe agresivitetin e fitimtarëve komunistë, për të shkatërruar të pasurit, që plasohet me protagonistin e romanit, Revig Domani, një situatë e shpaluar në njëzet e katër kapituj, që emërtohen me numra. Narratori i gjithdijes, shpërfaq rrjedhën e ngjarjeve, konturon fatin e personazheve, njëherit formaton bërthamën e romanit.

Së dyti: Autori – kronikan, një vlerë e shtuar e pentagramit narrativ, pra tanimë duke u distancuar nga realiteti, nga koha e mbrapshtë e përmbyseve të mëdha, më anë të legjendave dhe gojëdhënave, dëshmime historike të ekzistencës së tyre përmes ligjërimit gojor, që ngjesh dhe përplotëson amën narrative, duke e përçuar në formë përrallëzimi, në dhjetë ndarje, tanimë të emërtuara me shkronja.



Prof. dr. Jup Kastrati (1924-2003), "Mësues i Popullit", "Mjeshtër i Madh i Punës", është një nga figurat e dalluara të albanologjisë, bibliograf, filolog, hartues tekstesh për shkollën e lartë, gjuhëtar dhe historian i përkushtuar i gramatologjisë shqiptare e më gjerë. Kush e ka njohur nga afër, studentët dhe kolegët, miqtë e dashamirët e tij të shumtë, nuk mund të harrojnë kurrë dijet e tij shumë të gjera, informacionin dhe njohjen shumë të saktë e të imtë të botimeve për gjuhësinë dhe albanologjinë në përgjithësi, si dhe pasionin e përkushtimitin e tij proverbial për hulumtime e studime shkencore. Stilografin e tij ngjyrëvishnje e kishte kurdoherë në dorë dhe mbante shënim me zell e vrull studentor edhe kur i kishte fituar të gjitha gradat e titujt shkencorë, edhe pasi kishte shkruar e botuar mbi 900 punime, që kapin shifra të rreth 15.000 faqe shtypi shkencor: disertacione, monografi, studime, artikuj shkencorë popullarizues, përshtatje të letërsisë arbëreshe në gjuhën e sotme, përkthime në gjuhën shqipe nga gjuhë të huaja etj.

Jup Kastrati, po të përdornim një metaforë të anëve të Mbishkodrës, ishte një *lis me rrema të mëdhenj*, që **dan në shenj** nga të tjerët: veprimtaria e tij studimore, hulumtuese, e kumtuar dhe botuar, shtrihet në disa fusha: histori e gjuhësisë shqiptare, histori e albanologjisë dhe e gramatologjisë; histori e letërsisë shqiptare, me pykëzim e spikamë të veçantë në letërsinë e arbëreshëve të Italisë, të ligjëtimeve arbëreshe e të folklorit arbëresh; histori e mendimit pedagogjik shqiptar dhe e shkollës shqipe; vlerësues dhe studiues i palodhur i ndihmesave dhe përfaqësuesve të shkencës e të dijes shqiptare në rrjedhë të shekujve, artikullshkrues në të gjitha organet e shtypit shqiptar të kohës; kumtues i pamungueshëm në të gjitha veprimtaritë shkencore me rëndësi vendore, kombëtare e ndërkombëtare për fushat, që ai i mbulonte me kompetencën dhe dijet e tij të jashtëzakonshme. Për këtë flasin qartë veprat e shumta që na ka lënë, por sot, në këtë Konferencë shkencore/përkujtimore me rastin e 100-vjetorit të lindjes së tij, po përpiqem të them disa **vlerësime e vlera** të tij, duke u nisur nga një **pyetje-nyjë**: Ç'më ka lidhur mua me prof. dr. Jup Kastratin?

Së pari, një element vendorist e patriotik: ai kishte mbiemrin **Kastrati**, derë e mirënjohur e qytetit të Shkodrës, e cila, ashtu si edhe plot të tjera, si *Kopliku, Rrjollli, Repishti, Reçi, Hoti, Gruda* etj. mbanin e pohonin me krenari origjinën e vet prej Malësisë sonë të Madhe, kurse unë jam nga **Bajza e Kastratit**, një qendër e njohur jo fort larg Shkodrës dhe me një pozicion disi ndërmjetës midis "Maleve" e "Gropës së Shkodrës".

Jup Kastrati lindi, u rrit, jetoi e punoi derisa mbylli sytë në qytetin e Shkodrës, të cilin ai e deshi dhe e përfaqësoi kurdoherë me dinjitet të lartë, porse ai mbante me krenari edhe mbiemrin Kastrati, që i kujtonte origjinën e hershme prej maleve tona, të cilat miku e studiuesi ynë i paharruar edhe i deshi njësoj si qytetin e tij. Për këtë, ndër të tjera, na flet edhe një pjesë e mirë e veprimtarisë së tij shkencore, sidomos ajo që lidhet me dialektologjinë, me onomastikën dhe me kumtimet rreth temave që i përkasin malësisë sonë.

Prof. Jupi ishte nga ata studiues që jo vetëm e deshi malësinë shqiptare, po edhe i begeniste dukshëm punën dhe nismat shkencore të mësuesve dhe veprimtarëve të zonave të ndryshme: ai kishte miqësi me shumë arsimtarë e ish-studentë nga viset e ndryshme dhe nuk përtonte të merrte pjesë në sesione shkencore, kudo që të ishin: në Kabash të Pukës, në Laçi të Kurbinit, në Koplik, në Lezhë etj. dhe përgatitej për kumtimet që merrte përsipër njësoj si për konferencat a kongreset e mëdha kombëtare e ndërkombëtare, duke fituar kështu dashurinë dhe adhurimin e një yjësie të tërë arsimtarësh dhe njerëzish që kishin rastin ta dëgjonin kur kumtonte dhe diskutonte ai.

Më 23-24 shtator 1996, me prof. Jupin kemi qenë së bashku në Sesionin shkencor "Sofra e letërsisë dhe e artit", të organizuar në Koplik dhe ai mbajti kumtesën e tij

Vlerësime, shënime dhe disa kujtime nga
udhëtimet studimore dhe veprimtaritë shkencore
**Ndihmesa të prof. Jup Kastratit
në lëmin e dialektologjisë dhe të
onomastikës shqiptare e arbëreshe**

Prof. dr. Gjovalin Shkurtaj
Akademik Emeritues

interesante e të bukur "Edith Durham dhe Malësia e Madhe", e cila ishte e para në radhën e një vargu kumtesash kushtuar dukurive të ndryshme historike, letrare, gjuhësore e etnologjike të Malësisë së Madhe, si dhe fjalën e mbylljes¹, të cilat edhe janë botuar më pas në përmbledhjen përkatëse nga Qendra Kulturore "Edith Durham" e Koplikut.

Së dyti, sepse, duke u profilizuar në fushën e dialektologjisë, qysh kur isha ende student dhe punoja për temën e diplomës për të folmen e Kastratit, nga më të parat dhe (asokohe) ende nga të pakat studime që pata si model pune e si bazë krahasuese, ishte pikërisht studimi i Jup Kastratit "Mbi disa tipare të së folmes së Thethit".

Më 1962 studiuesi ynë i paharruar fitoi gradën "Kandidat i shkencave filologjike" me studimin "E folmja e Thethit", një punim interesant dhe i shkruar në një kohë kur dialektologjia shqiptare ishte krejt në fillimet e veta dhe njohja e të folmeve të tilla anësore si ajo e Dukagjinit, ku përfshihet e folmja e Thethit, sillte një ndihmesë të të mirëseardhur e me vlerë. Po atë vit, në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike, ai do të kumtonte pikërisht rreth temës "Mbi disa tipare të së folmes së Thethit"², e cila, bashkë me studimin e V. Cimohovskit për të folmen e Dushmanit dhe të E. Lafes për të folmen e Nikaj-Merturit, deri më sot mbeten burimet kryesore të botuara për të folmen e Shalës e të Dukagjinit.

Kam shkruar edhe më 2004, me rastin e 80-vjetorit të dilëndjes së tij një kumtesë pikërisht kushtuar studimit të tij për të folmen e Thethit dhe do të ritheksoj edhe sot disa prej atyre vlerësimeve që i takojnë Jup Kastratit për atë studim.

Thethi apo siç e thonë malësorët *Thethi i Shalës* mund ta tërhiqte studiuesin për bukuritë e tij natyrore, si një nga vendverimet

¹ Shih: Qendra Kulturore "Edith Durham", *Malësia e Madhe një visar shqiptar*, Materiale të Sesionit shkencor e "Sofrës së letërsisë dhe artit", Koplik, 23-24 shtator 1996, Logoreci, Tiranë, 1977, f.17-28 dhe f.155-157.

² Shih: J. Kastrati, *Mbi disa tipare të së folmes së Thethit*, në "Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike", Tiranë, 15-21 nëntor 1962, f.255-260.

më të këndshme e shëndetkëndellëse të Shqipërisë, porse ai gjente aty edhe një pikë të qëlluar dialektologjike, sepse përbën pikërisht cakun ku ndahen dy degëzime të gegërishtes veripërendimore: *Shtegu i Dhenet* (1826 m. lartësi mbi nivelin e detit) është i vetmi udhëkalim nga Malësia e Madhe, që mbetet në anën veriore e perëndimore, në Shalë, që shtrihet drejt pjesës verilindore dhe, në të vërtetë, edhe gjuhësisht dallohet e ndahet disi, qoftë edhe në pika të imëta, pikërisht sepse Shala merr diçka edhe nga tiparet e gegërishtes verilindore.

Studimi i së folmes së Thethit ndjek po atë "liturgji" ose metodë kërkimore të zbatuar gati masivisht në përshkrimet tona dialektologjike dhe që, pavarësisht nga mëtimet e deklarimet e ndonjë "modernisti", vijon të jetë sa tradicionale aq edhe e patundshme përsa u takon vlerave e dobisë që solli për dialektologjinë, sidomos kur ajo ishte në fillimet e saj. Pra, ai nis me një përshkrim të shkurtër gjeografik e historik të Thethit, paraqet përbërjen dhe shtrirjen e nëntë lagjeve të tij, duke i përmendur me emër dhe ashtu si shqiptohen në të folmen e vendit: *Gjelaj, Gjeçaj, Nikgjonaj, Akol*, që i takojnë anës së sipërme dhe quhen edhe me një emër të përbashkët *Katundi*, pastaj vijjnë lagjet e anës së poshtme: *Ndreqaj, Ulaj, Kolaj, Grunas* ose *Aliçaj* dhe *Ndërlyçaj*. Të gjitha këto lagje, sipas studiuesit tonë, quhen edhe me emrin *Fusha*.

Kam qenë edhe unë në Theth dhe në pjesët e tjera të Shalës për anketime dialektologjike në vitin 1980, dhe, në një farë mënyre, kam pasur edhe rastin të kaloj po në ato shtigje e të takoj, ndoshta, edhe të njëjtët njerëz që kishte pasur si informatorë edhe prof. Kastrati. Mund të them se lënda e studimit për të folmen e Thethit, si dhe përshkrimi i tipareve kryesore të saj, ndonëse autori nuk qe mirëfilli dialektolog, po të shprehemi me një mënyrë të thëni të shqipes së moçme, "nuk ka të fëjyem" dhe është mjaft i saktë dhe i shembullzuar më së miri. Punimi për të folmen e Thethit është cituar e përmendur shpesh në të gjitha studimet përgjithësuere rreth dialekteve të shqipes dhe mbetet edhe

sot e kësaj dite një pikë referimi me vlerë për të folmen e Shalës. Autori është ndalur në tiparet fonetike të së folmes së Thethit sipas metodës tradicionale të zbatuar edhe në gati të gjitha përshkrimet e të folmeve të shqipes. (Asokohe ende nuk kishte marrë udhë mëtimi i përshkrimeve me metodën e sistemit të *çifteve dyjare* a bigëzimeve të fjalëve që pranëvihen për të dallohen nga fonemat për të nxjerrë inventarin fonologjik të së folmes, por, pavarësisht nga kjo, mund të themi se inventari i fonemave zanore dhe bashkëtingëllore të së folmes së Thethit, në punimin e Jup Kastratit del i qartë dhe i rrokshëm jo vetëm për specialistët po edhe për një log të gjerë studiuesish të gjuhës).

Në mënyrë të qartë ai na paraqet sidomos disa prej dukurive më kryesore që veprojnë në atë të folme, si hundorësia e zanoreve. Ai thekson se hundorësia është "e rëndomtë" në zanoret: **â, ê, î, û** dhe jep shembuj konkretë, duke përcaktuar edhe pozicionet apo fqinjësinë tingullore në kushte e së cilës ndodh hundorësia. Kështu, për zanoren **â**, si kusht të hundorësisë përmend rënie e bashkëtingëllores **n** (*patâ, bibâ, rikâ, gjâ, zâ, shullâ*) dhe thekson se me këtë tipar Thethi "afrohet me Malësinë e Madhe", gjë që është shumë e vërtetë. Përveç shembujve të tjerë, me hundorësi të shkaktuar nga rënie e bashkëtingëllores **n** (*âsht, bâke*), dhe rasteve ku hundorësia është edhe sot fryt i ndikimit të bashkëtingëlloreve hundore **n, m** që vijnë pas zanoreve, Kastrati jep edhe raste të hundorësisë para bashkëtingëllores -j (*kopâj, shkullâj*). Të njëjtën gjë ai konstaton edhe për zanoret e tjera hundore: **ê, î, û**.

Me interes është aty edhe konstatimi se në atë të folme zanorja e patheksuar **ë** "nuk ndigjohet fare" (*ba:ll, pu:n, i:fort, dja:l, da:rk*), ndërsa në pozicion pastheksor, e ndodhur para bashkëtingëlloreve **l, r, n** merr timbrin e **e-së** (*diten, naten, dhelpen*). Po ashtu, autori përshkruan si tipar të së folmes së thethit praninë e zanores **y** (*dy, brryl, fyt*).

Togjet e zanoreve në Theth janë **ue** (*grue, krue, thue, luej, kërkuen, truell*), **ye, ie**, duke u dalluar kështu nga Malësia e Madhe ku, në vend të togut **ue** dalin togjet **uo** dhe **ua**.

Autori jep në atë studim paraqitjen e tipareve fonetike diferencuese të së folmes, duke u ndalur edhe në pjesën kushtuar sistemit morfologjik si dhe leksikut. Po lejohemi të përmendim, ndër të tjera, edhe ndonjë nga dukuritë morfologjike të së folmes së Thethit, që anojnë më fort nga pjesa verilindore, si veta e tretë e së pakryerës së foljeve, me mbaresën **-ke**, të cilën autori ynë e përshkruan si formë ku "janë përzie e pakryemja e dëftores dhe ajo e habitores" (*thankesh, thanshnye, thanke, thanshim, thanshit, thanshin*).

Me interes është edhe sprovat që bëjnë autori edhe për të gjetur e përcaktuar vendin e së folmes së Thethit në kuadrin e ndarjes dialektore të shqipes, duke shprehur sa vijon:



Në Maqit te varri i De Radës, 1981

“Tue përfundue mund të thomi se e folmja e Thethit, tue u gjetë në mes të Malsisë së Madhe (nga njena anë) dhe Shalës së Dukagjinit (nga ana tjetër), *shkon me gegnishten veripërendimore, pamvarësisht nga ndonjë ndikim nga gegnishtja verilindore*, në fonetikë, si p.sh. në kalimin e zanores **a** në **o** (*ko punue, konari* = kandari, *lon* = ata lanë); në kalimin e zanores **u** në **i** (*luftue* = luftue, “*tui luftue me do zapti*” kangë popullore) ose në leksik, veçanërisht në huazimet sllave”.

Me interes për dialektologjinë shqiptare janë edhe një numër studimesh të tjera të Jup Kastratit, si p.sh.: “*Të dhënat e të folmeve të arbëreshëve të Italisë për historinë e gjuhës shqipe*”³, “*Mbi ekzistencën e difongut në gjuhën shqipe*”⁴ dhe “*Diftongu në gjuhën shqipe*”⁵, trajtim me vlerë për fonetikën, por edhe për dukurinë në fjalë në dialektet e shqipës, “*ë-ja atone në shqipet*”⁶. Mendime dhe vlerësime me interes edhe për dialektologjinë, prof. dr. Jup Kastrati ka shprehur edhe në disa artikuj kushtuar onomastikës arbëreshe, si: “*Jeronim de Rada për toponiminë historike shqiptare*”, kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor për toponimet në Kabash të Pukës, 21 maj 1977; “*Të dhëna e toponime për Lezhën në “Fjamuri i Arbërit” të De Radës*” etj.

Së treti, sepse gjatë viteve që kam qenë punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë (1967-1989), prof. Jupi udhëtonte shpesh në Tiranë dhe, gjithmonë, sa herë që vinte në Institut për mbledhje redaksie etj., ai do të kthente në zyrën tonë ku ishte dhe prof. Eqrem Çabej. Kolegët e miqtë nga Shkodra, sidomos prof. Jupi e prof. Kolë Ashta, e kishin gati si rit të vinin për ta takuar Çabejn, i cili, kishte respekt të veçantë për ta. Me mirësjelljen e tij të njohur, Çabej ngrihej në këmbë, u qeshte shtegu i ballit teksa përfaleshin e pyeteshin për shëndetin e familjen, pastaj, po ashtu si një farë riti, vinte pyetja e tyre: “*Me se po merresh, Profesor?*” Vazhdonin, pastaj, me shkëmbimin e separateve nga botimet më të reja në revistat shkencore përkatëse dhe takimi mbyllej me një dalje në kafe e ku, ne më të rinjtë, zakonisht nuk shkonim, me qëllim që miqtë nga Shkodra ta shijonin plotësisht “qokën” e bukur me “Nestorin e gjuhësisë shqiptare”.

Nuk di pse, por, qysh nga hera e parë që e kam takuar, prof. Jup Kastrati më është dukur *më i afërt, më miqësor dhe më i hapur* se të gjithë burrat e mëdhenj me të cilët kam pasur rastin të punoj, të bashkëpunoj ose të ndodhesha së bashku në veprimtari të ndryshme shkencore, brenda e jashtë Shqipërisë.

Dhe, në fakt, gati gjithmonë, takimet e mia me prof. Jupin kanë qenë në raste konferencash, kongresesh ose sesionesh shkencore, ku ai ishte i kudogjendur dhe gjithmonë me referime e kumtesa, në të cilat spikatnin dijet e tij të shumta dhe aftësia për të kumtuar këndshëm e duke gërshetuar erudicionin shterues me saktësisë në përpikmërinë e prurjeve e të citimeve. *Një orakull i vërtetë*.

Për herë të parë kemi qenë së bashku si pjesëmarrës e kumtues në në qytetin e Lezhës, në dhjetor të vitit 1967, në një sesion shkencor në kuadër (e në prag) të Konferencës së Dytë të Studimeve Albanologjike. Pastaj, me prof. Jupin, në rrjedhë të viteve, kam pasur nderin e kënaqësinë të kem qenë shumë herë së bashku: në konferenca shkencore e në udhëtime studimore të paharrueshme, si në Kongresin e Drejtshkrimimit të Gjuhës Shqipe (1972), në Konferencën Ndërkombëtare të Studimeve Ilire, në Konferencën e Studimeve Etnografike dhe në shumë të tjera. Por, kujtime të pashlyeshme dhe që, sot, mendoj se kanë edhe vlerë dëshmuese për figurën e prof. Jup Kastratit, kanë qenë:

1) Pjesëmarrja në sesionin shkencor me

temë “Puka dhe shkolla” në Kabash të Pukës, në vitin 1978, dhe prej asaj veprimtarie ruaj edhe një fotografi të bukur, ku kemi dalë bashkë me prof. Jupin, prof. Eqrem Çabejn dhe prof. Mahir Domin.

2) Udhëtimi studimor njëmuor te arbëreset e Italisë, 8 prill deri më 6 maj të vitit 1981, në Kalabri (në qytetin e Kozencës e në disa prej qendrave kryesore të asaj krahine), ku, gjithashtu, kam pasur nderin e privilegjin të isha së bashku me prof. Jupin e prof. Dhimitër Shuteriqin dhe, me atë rast kemi dalë në një fotografi përpara varrit të Jeronim de Radës në kishën e Maqit. Mbj mend se atë ditë qendra e Maqit dhe rrugët e rrugicat e tij ishin mbushur me njoftimet e mëdha për veprimtarinë shkencore “*Mbalë De Radës*” (Mbi De Radën) e ku, prof. Jupi e prof. Shuteriqi, i mbajtën kumtesat e tyre *gjysmën arbërisht e gjysmën shqip e italisht*, duke ia përshtatur mjedisit vendor arbëresh në të folmen e deradiane, që ata e njihnin më mirë se kushdo tjetër, sepse kishin një jetë që ishin marrë me studimin e gatitjen për shtyp të veprave të De Radës.

Hoteli “Imperial” në qendër të Kozencës, ku bunte grupi ynë studimor, për ditë të tëra ishte kthyer në një “Mekë” shqiptarie. Aty vinin poeti Karmel Kandreva, publicisti e politologu Mario Bruneti, veprimtari i studiuesi (pastaj edhe politikani Shënmitrot Damiano Gualgliardi, etnologu e folkloristi Antonio Bellushi, veprimtarë kulturorë nga katundet arbëreshe kozentine, si Alfio Moccia, Camillo Mosciaro, profesorë universiteti si Francesco Solano e Francesco Altimari. Dhe, e bukura ishte se ata, ndonëse në jetën e tyre të zakonshme kishin edhe dasitë e grupimet e tyre partiore e ideologjike, për hir të pranisë sonë, bashkoheshin pa ngurrin në hollin e “Imperialit” dhe pinim së bashku një *qelq verë arbëreshe* e një pikë raki shqiptare.

Ndërkaq, të grupuar sipas profileve përkatëse, ditët i kalonim me punë intensive: prof. Jupi me prof. Shuteriqin e prof. Ali Xhikun në Bibliotekën Çivike të Kozencës, si dhe në bibliotekat e qendrave të tjera, si në Frasnitë te A. Bellushi, në Vakaric në Bibliotekën “Filomena Faraco”, kurse unë dhe dy kolegë të tjerë, si hulumtues të terrenit, shkonim për ekspedita në të folmet arbëreshe të katundeve Shën-Benedikt, Marri, Maqi, Mbuzat, Strigar, Ungër etj. Ka qenë ai një udhëtim studimor i frytshëm dhe i paharrueshëm. Prof. Jupi, ashtu si edhe për të gjitha veprimtaritë e tjera ku merrte pjesë, nuk ka mënuar edhe të shkruajë e të vlerësojë gjetjet e tij dhe të krejt grupit gjatë asaj periudhe njëmuore kërkimesh bibliografike e arkivore në Kalabri.

3. Kam qenë së bashku me prof. Jup Kastrati edhe në shumë konferenca e sesione shkencore të mbajtura në qendra të mëdha, si në Prishtinë, në Kozencë etj., po edhe në qyteza e zona të vogla, si në Laç të Kurbinit etj, si dhe kam pasur nderin e privilegjin të isha pedagog i ftuar prej tij për ligjëratë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe ku, gjithmonë, bashkë me studentë e pedagogë të katedrës që ai drejtonte, merrte pjesë dhe, madje, në shenjë respekti mbante edhe shënime me stilografën e tij historik ngjyrë-vishnje, që nuk mund ta harroj. “*Noblesse oblige*” - thonë me të drejtë francezët. Ai ishte shef i katedrës, mbante titullin profesor e gradën “doktor i shkencave” dhe, për të më respektuar, mbante edhe ndonjë shënim. Me këtë gjest fisnik, prof. Kastrati, faqe pedagogëve dhe studentëve që ndiqnin leksionin e të ftuarit, jepte edhe shembullin e nderimit e të *etnografisë së komunikimit* në mjediset universitare, duke i dhënë të ligjëruesit të ftuar një emocion e ndjenjë të paharrueshme mirëpritjeje e vlerësimi.

Dhe, për ta mbyllur fjalën time, besoj se shpreh një realitet të pamohueshëm duke thënë se prof. dr. Jup Kastrati ishte një Bir i Madh i Shkodrës, një emër i dalluar në fushën e letrave shqipe, të cilin e kujtojmë dhe do ta përkujtojmë gjithmonë me respekt e vlerësimet e larta që meriton me veprën dhe veprimtarinë e tij të vyer që ka lënë pas.

(Vijon nga faqja 13)

Ravigu - universi i realiteti letrar

Prania e Ravigut, epiqendra e tekstit, në një hapësirë të shtrirë të romanit “Çmimi i atdheut”, si dhe plasimi si një karakter i përveçëm, stoik dhe i dashuruar me jetën, me atdheun, e shndërron në një roman tipik të personazhit/personazheve, me dritëhije dhe uljengritje, të gdhendura si karaktere. Në faqet e librit, Ravig Domani, vjen si universi i sipërmarrjes për të rimarrë dhe shtuar pyetjen e përtjetshme: Ç’është atdheu? Mbi të gjitha për të parashtuar marrëdhënien e këtij momenti, pra për bërë pyetjen, se cili është çmimi i atdheut? Gjendur në mëdyshje epokale, në jetën personale dhe shoqërore, e dëshmuar në libër, e figuron si qendër e universit të romanit. Nga njëra anë, Ravigu është pikëveshtrim për të parë dhe perceptuar, të kaluarën e largët të fisit, të kaluarën e mbushur me akte trimërore dhe në ballë të zhvillimit, duke qenë gjithherët dalëzotës të atdheut. Në anën tjetër, figurimi i plotë, i dritëhijeve personale, karakteriale dhe shoqërore, konturojnë një figurë konkrete, të lidhur me realitetin e kohës, me tokën dhe atdheun, ndonëse bart një natyrë komplekse. Njeriu, përfaqësues i të pasurve, që kanë një histori krenare, është një baba i dhembshur, gjë që del në marrëdhënien me të bijën, si dhe me vogëlushen e Adnanit, e sidomos ky tipar njerëzor zbulohet në letërkëmbimin me vajzën. Po ashtu, Ravigu është një bashkëshort mendjehapur, e “pranon” ikjen e gruas gjermane, me djalin dhe vajzën. Në faqet e romanit përshkruhet se është një dashnor i zjarrtë, adhures i të bukurës, në jetë dhe në art, veçmas i bukurisë femërore, çka zbulohet në skenat e përndezura me Magdalenën, të cilën e quan Laureshë. Kjo figurë interesante dhe komplekse, fanitet si një Esmeraldë, personazh i romanit “Katedralja e Parisit”. Ravigu, ndërkaq është i lidhur me tokën, jo pse ka mbaruar shkollën për agronomi, e prandaj ka ngritur një fermë shëmbullore, por mbi të gjitha e dashuron tokën, si porosi e të parëve, e prandaj nuk e braktisi as në kohën e luftës, as më ardhjen e komunistëve, përbindëshave që shkatërruan pronën dhe atdheun.

Fundi tragjik, që shpërfaqet në episodin: “Ravigu e shtyu me duart e lidhura. U ngjit vetë të mëkëmbësja e drunjtë dhe pastaj te stoli, që priste me një pamje vajtimtare; e vuri litarin në qafë me duart e tij, pastaj thirri me tërë fuqinë e mushkërive: roftë atdheu! Pas atyre fjalëve i dha stolit një të shtyrë dhe u lëkund në ajër...” (2023: 399), që sjellë për lexuesin atdhetarinë e protagonistit të romanit, e cila shënon një gjendje të ngritur letrare, që lidhet me një amanet: “...ta doni atdheun edhe kur ai ju vret”, një klithëm e Dhimitër Paskos, që merr vlerë emblematike në këto kohë tepër të trazuar. Kalvari ku endet fati i Ravigut, pasi në kapitullin e parë, ku koloneli ukrainas Bespallov, paralajmëron: “Gjërat e para që komunistët të marrin, në pritje që të të fusin plumbin, janë paratë dhe drithi.” (2020: 10), gjë që ndërkaq rifromulohet në kapitullin njëzet e katër, kur pasi i kanë marrë fermën, pasurinë, e kanë futur në burg, duke e akuzuar për sabotim. Fraza: “Ata iu përgjigjin se shumë shpejt do të vinin inxhinierët sovjetikë dhe do të përfundonim në bajga. Ky që çmimi që duhet të paguaj për atdheun.” (2023: 388), që vjen si një moment ku fillimi dhe fundi i romanit, pikëtakohen duke ravizuar një parashtrim ciklik të tekstit.

Poezi dhe muzikë

Elementë të shtuar në romanin “Çmimi i atdheut”, janë poezia dhe muzika, si dy anë të shoqërimit të fateve të personazheve, si dhe të krimit të një dekori më të gjerë estetik. Sipari i poezive, të ndërfitura në pentagramin narrativ, hapet me vargjet: “Sy të zi, sy përvëlues/Sy të bukur që të fusin datën/ju dua dhe ju kam frikë/Patjetër jena

pa n’sahat të ligë.” (2023: 38), që përkon me këngën e ciganit Valer. Në një situatë tjetër, kemi haikun: “Gjithë kohën i lutesha Budës/Ndërsa vrisja/Mushkonja”, të poetit japonez Kobojaski Ira. Pastaj ndeshim një këngë napolitane: “Kur ngrihet hëna në Marekiare/edhe peshqit ia nisin dashurisë./Dallgët e detit lodrojnë/dhe nga gëzimi ngjyrën ndryshojnë...” (2023: 179), si tregues i hapur ndaj muzikës dhe artit. Kënga tjetër vjen me varge popullore: “Ulu mal, o ul mal, o të dali hëna.” Nota humorit përçon dyvargëshi: “O mirë se vjen!/ O mirë se vjen, o gjerman aga!”, për të ardhur te prania e vargjeve të Naim Frashërit: “Krujë o qytet i bekuar,/prite, prite Skënderbenë./Po vjen si pëllumb i shkruar/të shpëtojë mëmëdhenë.” (2023: 282), një rimarrje poetike. Për të mbërritur te paradoksi: “Me trimat e Stalinit/Me ideal në gj./Armatat e Hitlerit/I bëmë shkumb e hi.” (2023: 314). Materia poetike shkon gjithsej në tridhjetë e tre vargje. Për krijimin e sfondit, përveç këtyre vargjeve, rol të posaçëm ka edhe muzika, e cila shpërfaqet në dy forma:

A – Si bashkëshoqëruese e vargjeve, sepse janë tipike tekste këngësh, duke përçur nëntekstin e këngës si kronikë shpirtërore e genies.

B – Nëpërmjet përmendjes së kompozitorëve më të famshëm të botës, që zë fill me “vals in “Ndarja” të Lisenkos” (2023: 35), për të vijuar me situatën: “Nuk e zgjidhni Brahamsin për të bërë dashuri. Ishte shumë i shpejtë.” (2023: 57), për të vijuar më tutje: “Serenata” e Shubertit.” Një pohim tjetër: “Sa herë luhej “Valsi i Perandorit” i Johan Straussit, vinte të më merrte ndonjë ushtarak i pashëm.”, e diku tjetër “Valsi i shiut”, i Shopenit, pastaj Vivaldi, Listi, për të ardhur të “Histori dashurie” Bethoven.

Gjurmë të leksikut autorial

Gjatë leximit të romanit “Çmimi i atdheut”, ma tërhoqi vëmendjen leksiku i autorit, që ecën në dy rrugë, të rikativizimit të fjalëve të rralla, si dhe të natyrës së fjalëfirmimeve autoriale. Për të krijuar marrëdhënie me këtë prurje, po e sjellë për lexuesin atë pjesë të leksikut konceptualisht të autorit, në mesin e të cilave veçova fjalorin më tipik, që krijon atmosferën e kohës dhe hapësirës, ku ndodhin ngjarjet, si dhe figurojnë protagonistët: *bamirëtorja, kockathyerse, aromonte, korrëshirëse, vendndalesa, letërpara, vdekëtorja, ngulamendje, furracakët, femërorësinë, sisëvarura, lëkurëerrët, folëmarrësin, mugëtua, mesorinë, grackuar, mburramane, përkyçse, gjysmëcigane, kokëprurësin, përnjollje, tundeshjundëse, mëngjesoi, trashëfimore, jonxhishte, bukëlidhur, vdekëtorja, kikërimat, ndenjëtore, binsen, mirëzë, gjimbjatëse, vithemëdha, furracakët, ramëdorësa, rrepishtje, përnjollës, pritarit, kafepjekës, anashkëmbas, zezërima, shpatulloret, fetarisë, nënrrogozëria, përnjollje, vrakohës, përlëngu, këmbimtoje, fjalina (parrulla), varrimtoje, muetnin, hashashtarët, burimtori, dhënator, shtrigëronte...” e shumë raste të tjera, që e pasurojnë fjalësinë e autorit. Përkujdesja gjuhësore, të ndërmend idenë e Tomas Eliotit, si dije dhe përvojë, kur shprehej: *...detyra e poetit si poet është vetëm e tërthortë për popullin e tij: detyra e drejtpërdrejtë është e lidhur për gjuhën e tij; së pari ta ruajë dhe së dyti ta zgjerojë dhe ta pasurojë...*[4], si një akt i mbijetesës së letërsisë, si tregues i pasurimit prej letërsisë.*

³ Shih: Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës e të kulturës së tij, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1988, f.299-306.

⁴ Shih: *Buletin për shkencat shoqërore*, Tiranë, 1952, nr. 4, f.108.

⁵ Shih: *Buletin për shkencat shoqërore*, Tiranë, 1954, nr. 2, f.70-90.

⁶ Shih: *Buletin për shkencat shoqërore*, Tiranë, 1956, nr. 1, f.228-255.

⁷ Shih: Vjetari “Lissus”, nr.6, Lezhë, 1993, f.70-81.

HIJA E BARDHË E BURRAVE

Sa herë vija tek lumi
Vështroja ujërat e shkumëzuar
E bëhesha burg fjalësh
Me dritë të shuar.

Pastaj erdhi një kohë
Kur lumi më dukej si burrë
E burrat si lumenj.

I vështroja me vëmendje
T'u lexoja hijet e bardha
Që lëshonin nga kryet
Dhe ëndërroja
T'u ngjaja një ditë.

Tashmë, që mbart mbi supë
Hijet e tyre
Sa herë i kujtoj
Përtërihem
E mbushem me dritë.

LUFTA IME

Lufta ime ka filluar me bërryla
Kur mësuesja na vuri mbi bankë një
abetare të vetme
Dhe ne, shtynim njëri – tjetrin
Të zotëronim fletët e saj.

Por ende se kujtoj, kush e përdori i pari
atë bërryl
Unë apo shoku im i fëmijërisë.

Më vonë, u vështa me luftë deri në
dhëmbë,
E kërkoja me vringëllimë
Të zotëroja territore ëndrrash dhe
pushtet.
Teksa me bisht të syrit shihja ca të tjerë
Fërkonin duart rreth e rreth meje
E shijonin paqen e tyre të qetë.

Kjo m'i bënte betejat pluhur udhësh e
më zhyste në verbëri
Derisa një ditë i shpalla luftë luftës sime
E fillova të shijoja paqen brenda vetes
Pa fërkime duarsh,
Pa brohorima fitoresh,
Pa ngjyra marrëzish.

Por ende s'e kujtoj, kush e përdori i pari
atë bërryl
Unë, apo shoku im i fëmijërisë.

JAGODINA E ZEZË

Jagodina në breg të lumit
Shtatë nuse në vah të kumit
Shtatë nuse vanë e shkuan
Me qefin u mbuluan
Si u bëre moj kail
Bëre dhëndër një lumë xhahil.
(Popullore)

Kur këndonin kukuvajkat mbi oxhakët e
shtëpive
Vija tek bregu i lumit të shikoja portretet
e nuseve
Që vizatonin peligorkat mbi ujëra.

Ishte koha kur nga qiejt
Binin shira të vdekur
Dhe valëzat e bardha
Bëheshin qefin për nuset e reja.

Shtatë shtëmbat e mbetura në vaun e
kumit
I mbushte e i zbrazte era përditë
Me vaje e rënkime.

Pastaj kthehesha i pikëlluar
Duke menduar për kukuvajkat,

NURI PLAKU

Këmbanat janë
ujkonja urbane

Cikël poetik



peligorkat
Nuset e mbytura dhe Jagodinën e zezë
Që bëhej lot i zi
Në syrin e nënës sime.

PEIZAZH VJESHTE

Gjoli po tretet pakë nga pakë brenda
pikëllimit të vetë
Gjallesat struken në prehrin e vdekjes
Në pritje të vjeshtës së vjedhur.

Fijet e thara të barit
Pëshpërisin në breg
Sekrete të verdha stinësh.

Lejlekët kanë ngecur diku në shtegtim
Me një këngë bretkose ngulur në sqepe
Si gjemb i hidhur.

O Zot, çfarë moti ka ardhur
Gjoli i vdekur,
Ha jetën që ka lindur!...

GJURMË

Mesnata m'i verbon bebëzat e syve me
xixa yjesh
E më rrëmben me përdhunë
Në një shteg të vjetër ujku.

Udha shkon në faqe mali, por drurë nuk
ka
As ujqër, as ujëra, as gjurmë gjallese
Ka vetëm gurë pa hije, të ngritur në
këmbë
Si burra të ringjallur nga magjia e zezë.

Asgjë nuk ka,
Asgjë nuk pipëtin.

Veç vdekja më shfaqet e më thotë:
- Më merr mbi supë
Sa të kaloj
Mëkatin tim.

DY DIMRA

Janë ende dy dimra të mbetur midis
nesh.
E hedhin tinëz
Sqotë e suferinë.

Njëri fshehur në syrin e përlotur të kaut
Tjetri fshehur
Në shtegun e hasmit tim.

ATDHEU IM I PALOSUR MË DYSH

Nga strehëza e shtëpisë sime
Pikon muzikë e hazdisur shirash...

Ime shoqe shtron drekën

Mbi mbulesën e palosur më dysh
E vallëzon në heshtje
Të duket e lumtur...

Tashmë përdorim gjysmë tavoline.
Gjysma tjetër mbetet bosh
Në pritjen e largët të fëmijëve
Endur nëpër botë.

Pjatat ngelen të paprekura
Lugët bëhen lopata varke
E më çojnë në humbëtirë.
Ngrihem i lodhur e shkoj të dremis
Në qoshen time të zakonshme.

Para syve më shfaqet atdheu i palosur
më dysh
Bash si shtroja e ngrënies mbi tavolinë
Ulet në karriget e boshatisura të
fëmijëve
E dremit bashkë me mua i zhytur në
mendime.

Nga strehëza e shtëpisë,
Pikon muzikë e hazdisur shirash
E befaz ngulet
Një shtizë vetëtime.

PORTRETIN TIM E VIZATON NJË
PEMË

Ulem në bordurën e ftohtë të trotuarit
Para një peme të vetmuar, pa gjethe, pa
hije, pa zogj
Para një peme me arsye të venitur
Që sajton në erë ca penela degësh
E vizaton portretin tim mizorisht.

Ulem e presë të kalojnë të njohurit e mi
Të shkëmbejë dy fjalë të munguara prej
kohësh
Por tashmë askush s'ka ngelur
Veç kjo bordurë e ftohtë dhe kjo pemë
me arsye të venitur.

Dikur, ky trotuar ishte Olimpi im
Mbushur me xixëllonja përhëndetjesh.
Që lëshonin dritën e vërtetë të qytetit
Ku shihja të shkoja edhe një fije të hollë
gëzimi
Në birën më të imët të mërzisë.

Ndërsa tashmë, banorët po ndërrohen
përditë
Të ardhurit bëhen të huaj të largët
Të mbeturit bëhen të huaj të trishtët.

Dhe vijë e ulem te kjo bordurë guri e
ftohtë
Para kësaj peme të vetmuar, me arsye të
venitur
Që ma vizaton portretin mizorisht.

IKJE

Shkula zemrën e mbushur me vrer
E vura të kullojë
Mbi pragun e braktisur të shtëpisë.

Avionin e parë që mora
E bëra mik
Deri në vdekje.

Tashmë në gjoksin e boshatisur më
pulson
Një lëmsh udhësh
Me njërin skaj të lidhur te këmbët
Skajin tjetër,
Në gjuhëzën e një këmbane kishe.

Avionin e parë që mora
E bëra mik
Deri në vdekje.

JAM I FTILLUAR

Më rrëmben herë – herë vrulli i ikjes së
moshës,
E më bën të drithërohem si krahë zogu
në fluturim.
Në vesh më gjemojnë daulle të grisura
beduinësh
E zë të ftillohem për udhën e fatit tim.

Rrufe e zezë ma vizaton portretin mbi re
shirash
Mbi dhëra, shoh hijen time që përpëlitet
e plagosur
Ndaloj një çast të ftillohem, dëgjoj e
dëgjojem
Zhytem në dritë e sërish nga drita
rimarr udhën e nisur.

Në squetulla më mbijnë flatra furtune
Portreti mbi re, më shfaqet si
shëmbëlltyrë e harruar
Hija ime e plagosur ringrihet mbi dhëra
e ujëra
Eci e dëgjoj, dëgjoj e dëgjojem. Jam i
ftilluar!

TË BRAKTISURIT

I shoh të baresin kokulur nëpër udhë,
Duke kënduar me zë të ulët
Me buzë të dridhura
Një lutje të re
Nxjerrë nga një lutjesori i ri.

I shoh përditë të braktisurit
Me cigare harruar në cepin e buzëve
Në buzët e dridhura që murmurisin nën
zë
Një këngë – lutjeje, për pak dashuri.

Të këndosh një këngë me buzë të
dridhura
Është më shumë sesa vetmi.

KËMBANAT JANË UJKONJA URBANE

Një ulërimë ujkonje ka ngecur mbi degët
e pemës
E drithëron zemrën e zogut në fole.
Ku është rojtari i pyllit vallë, ta qetësojë
Atë shpend të tmerruar?

Ah, frika e zogut më kujton zemrën time
Kur u drodh dikur
Nga ulërima e një këmbane
Që thërriste emrin e saj...

Këmbanat janë ujkonja urbane
Ujkonja prej bronzi të rrahur nga tinguj
të kobshëm
Që ushqehen me lot njeriu.

Ulërima ngeci atëherë në degët e
kujtesës sime

E tani zgjohet herë pas here
Duke thirrur barbarisht atë emër.

E unë jetoj
Me drithërimën e saj
Futur thellë në zemër.

GRUA E HESHTUR

Kurrë nuk më thua sa shumë më do
Kurrë nuk më pyet sa shumë të dua.

Veç shkrihesh thellë brenda meje,
Si ujërat e pemës që shkrihen brenda
trungut
E shfaqen në rrathët e moshës
Vetëm pas vdekjes së drurit.

Grua e heshtur
Mesjetë e ngujuar
Në zemër të gurit.

NYJE

Sa herë shkojmë në parkun e qytetit
Na përshëndesin ca drurë ahengjesh.
Ti thua "më përshëndesin mua"
Unë them "të përshëndesin ty."

Teksa drurët shkundin
Një këngë zogu
Që bëhet nyje,
Për ne të dy.

LISAT

Lisat janë idhujt e mi mëkatarë!
Sa herë takohemi
Më rrëfejnë sekrete
Nga origjina e kryqit.

Unë ju premtoj
Dëshminë time
Në ditën e mbrame të gjyqit.

ZARI

Eja ta hedhim zarin
Në prushin e shuar të syve tanë.

Kur ta hedh unë
Do shohim fatin tënd
Kur ta hedhësh ti
Do shohim fatin tim.

Veç zari do të jetë
Loti im!

HELM I IM I BUKUR

Sa herë kalon para portës sime
Kindat e fustanit tënd vallëzojnë
hareshëm
Me gurët e sokakut.

Shpoma mollëzën e gishtit
Me majën e qerpikut
Të më dalë
Helmi i gjakut.

DHIMBJE

Unë tashmë e mas kohën me sahat gjaku
Punuar nga rubini i lotit tënd
Që pikoi dikur
Në ashtin e zemrës sime.

Sahat gjaku
I kurdisur
Nga një fjollë psherëtime.

Poetja Khosiyat Rustamova

MUND T' I HUMBASËSH NJERËZIT DHE DUKE I DASHUR

nga *Fatbardh Amursi*

Khosiyat Rustamova nga Uzbekistani njihet ndërkombëtarisht si poete, por ajo ka vënë në skenë dhe drama, njëherësh dhe botuese e një reviste letrare, ku ka botuar shumë autorë shqiptarë: Kadare, Rudolf Marku, Sadik Bejko, etj. Së fundmi autore e librit "Find me in hearts" (Më gjeni zemrave), shoqëruar me një parathënie nga Gjekë Marinaj, veç poezive ka dhe një Ditari, si rast i pandodhur në librat poetik, i cili të shërben për njohjen e autores. Ndryshe nga matematika, ku nga të njohurat shkohet tek e panjohura, në poezinë e Rustamovës, ndodh ndryshe: nga personazhët e panjohur shkohet tek autorja e njohur. E panjohura për të s' është pengesë, por një kurioziteti. Guxon të futet në territore të panjohura, si një avion, i cili, nuk komunikon me kullën e orientimit, pasi pista për t' u ulur është gjëja e fundit, që i intereson. Kështu ndodh me të gjithë ata, që kanë punë me qiellin.


Në poezinë e Rustamovës mbizotëron errësira, e cila përshkallëzohet deri në kufijtë e depresionit, ku vetja i duket, herë: "Si një plumb që humb tagrin", sepse: "Djajtë e natës e kanë trembur". Por kjo nuk është e gjitha. Fuqia përjetuese, si një prush emocional që bëjnë të dridhesh e detyrojnë errësirën të kthehet në një sfond, ndërkohë që: "Kopshtet japin gjithë dashurinë e tyre.", ndjekur nga pyetje: "Pse nuk ke pushuar së mbledhuri lule?" dhe vjen përgjigjja: sepse "Jeta po shpenzon shumë për mua,/Ndoshta duhet të rritem më shpejt". Kjo rritje s' është vetëm moshë, por dhe nivel përfaqësimi, arritje, aty ku majat i kanë zënë të tjerët. Vështirë se e kupton: i dashuri ia lehtëson shpirtin apo i shton dhimbjen?! "Dua të bërtas e megjithatë hesht./Po tërhiqem përgjithmonë deri në fund të skenës". Gjithsesi e jeton dramën në një atmosferë lirizmi. "Jam thjesht një skicë e lodhur e një artisteje", shkruan ajo por sfidën nuk e ndal. Në dramën e pasioneve ajo s' kërkon fajtor, duke i munguar shpirti hakmarrës, gjë krejt e rrallë aty ku shpirtat egërsohen për hiçgjë. "Ti je i pafajshëm dhe unë nuk kam faj;/Kështu peshon zemërimi i Zotit". S' besoj se gjendet gjekundi një amnisti shpirtërore e këtij dimensionit. Duket

sikur vizaton portretin e saj në xham, edhe pse era s' e lë avullin të luajë me gishtat e saj. "Era erdhi rastësisht dhe shpejt u largua." Gjithsesi gjurma mbetet. Edhe qielli është i gërvishur, si me qenë në botën e rrokaqiejve të Manhatanit. Si për ironi të zbrastësisë në shpirt: "Arra bosh mbushin gjoksin/E vjeshtës që po largohet". Kudo afron paqtim, edhe në raport me atdheun: "Ti je zemra ime, mëmëdhe, derisa të vdes./Nuk ka armiq mes meje dhe teje". Një varg i mrekullueshëm, kur bota është plot me armiqësi dhe shpinëkthyesit po i gëzohen deheroizmit.

Ndërkohë që ka nevojë për afërsi, dënohet me distancë. Ndaj: "Kujtë dërgohen të pushojnë.../Por ka një kalë që duket sikur rri në rrugë./Ecën i lodhur;/Nuk ka dritë në sytë e tij./Refuzon ushqimin dhe ujin duke u dridhur." Dhe më tej: "Një qen po vinte pas meje.../Ka shumë qen rreth e rrotull./Kam frikë nga qentë./Por, qentë nuk janë burra." E friksojnë vetëm demonët e natës. Dhe për t' u shpëtuar s' gjen strehë tjetër më të sigurt nga zemra e njerëzve. Pasioni dhe vuajtja krijojnë gjendjen e diellit me shi, duke shpresuar në daljen e ylberit të radhës. "Një ditë të shkrova një letër dhe të thashë se ende të dua, kur s' kishim folur për gati tre muaj"-i shkruan djali vajzës. Në të gjithë poezitë apo copëzat poetike të librit ka pak erotikë dhe shumë vuajtje. "Por unë nuk do të dorëzohem para krenarisë suaj! Ju nuk mund të më mposhtni!"-këmbëngul ajo, duke u udhëhequr me shumë nga krenaria se sa nga sedra. (Nëse dashuria mund të krahasohet me fuqinë tërheqëse të tokës, sedra mund të matet me fuqinë shtytëse të karburantit, që e nxjerr anijen kozmike jashtë orbitës.) "Çdo hap i rrugës sime është plot me pyetje në formë njeriu!" apo: "Ndërsa zhvillova dëshirën për të jetuar më gjatë, fillova të jetoj në drejtim të kundërt të akrepave të orës." S' ka moment më të keq, se sa: kur koha s' punon më për ty dhe ti, duhet të përballesh dhe me ata, që i ke patur në anën tënd. Në këto situata, ndodh që: "Mund t' i humbasësh njerëzit edhe duke i dashur", ku secili udhëton në një anije tjetër,

të plasaritur. Mund të luash me valët e kësaj jete për një kohë të gjatë, mund të luash dhe me vdekjen, pasi s' dihet se cila dallgë ka për të qenë fatale për ty, këshillon autorja. Dhe kjo dallgë një zot e di, se prej nga e merr fuqinë?! Mund të parashikohen tornadot, por jo urrejtja e Medeas.

Kishim dëgjuar për "armiqtë imagjinarë", por për "të dashur imagjinar" është rasti i parë që has, pasi edhe platonikët, që i realizojnë dëshirat me imagjinatë, i drejtohen një personi konkret. Edhe më i fantaksuri, Don Kishotit, do i shfaqej në krahu një Dylqinjë. Nuk mund të dashurohesh me hijet, qoftë dhe fantazma e babait, sikurse i shfaqet Hamletit. "Përveç ne të dyve, të gjithë ishin të huaj. Ne të dy ishim si salmoni që noton kundër rrymës! Ne po i përgjigjeshim mizorisë së jetës dhe po e duartroktonim atë me lotët tanë!" Shumë prej atyre, që i lexojnë këto rreshta, mund ta konkretizojnë me veten. Shpesh trishtimi arrin "pikën e vdekjes", pa u kthyer në zi: "Ndonjëherë dëshiron të vdesësh, por, nuk gjen dot arsye." Kështu ndodh, kur pasioni ia lë vendin urrejtjes. "Të kam harruar dhe shpresoj që edhe kjo plagë të shërohet së shpejti, duke mos lënë asgjë në vendin e vet." por: "Dashuria e poezia nuk do të më lërë të qetë. Çdo fjalë është si një dragua gati për të më gëlltitur." Por, vendi i prehjes është i bekuar, kur: "Vdiqa në fjalët e mia." Ndihet më e rëndë nga pesha e trupit të saj, se ka me vete dhe peshën e dashurisë, se kujtimet i do më shumë nga ai që ikën. "Unë qava, e doja dhe e pranova dhimbjen e poezisë", e cila hap plagë, ku vuajtja s' i përket më një personi. "Sepse e humba veten kur të gjeta ty", një varg i rrallë ky, që s' e gjenë në shumë e shumë poezi erotike. "O zot! Nëse kam mëkatuar duke shkruar poezi, nuk kishte rrugë tjetër për të folur me botën." Dhe bota në këtë rast, duhet ta pranojë si një heroinë të virtytit. Ja dhe çasti i arratisjes për në botën e madhe: "Në aeroport pagova pak më shumë për valixhen time shtesë dhe bagazhe të tjera. Kujtimet nuk kontrollohen apo skanojnë në aeroporte. Nëse do të skanohehin si ngarkesa, kujtimet e mia do të ishin shumë të rënda për fluturim."-shruan ajo në Ditarin e saj, duke besuar e bota drejtohet nga dashuria. "Nxitoni, le të largohemi nga toka ...Sa kohë duhet për të paketuar gjërat tona dhe për t' u veshur? Të mos harrojmë asgjë! Sidomos librat tanë!" Shfaq dashuri, duke mos ia patur nevojën fjalëve dhe ndjenjave të sëmurura. "Ne nuk kemi ardhur në këtë botë vetëm për të ecur nëpër të! Ne kemi synime. Ne kemi ëndrrat që duhet të realizohen."-është i gjithë mesazhi që del nga Ditari me copëza poetike. Kur pasionet kalojnë përmes zemrës, pavarësisht vuajtjeve, asnjëherë nuk ka për të patur fajtorë.



CEZARI

Sa herë futej nata,
n'orën e vet t'menstruacioneve,
Cezarit t'madh i dilte gjumi.

E linte zonjën ngjumë,
i hidhte një shikim miklues
trupit t'lakuriquet t'zonjës,
gjinjve t'saj grandiozë,
edhe dilte n'ballkonin
edhe ma grandioz t'pallatit.

Për çudi,
tuj e shikue qiellin e lamë t'Romës,
e tuj e pa edhe hanën,
n'çastin që bahej ma e verdhë se një lule-
dielli,
ma e bukur se njani gji i zonjës,
Cezarit, gjithëherë, i vinte n'mendje ky
mendim:

"Ç'po m'ndodh, o Zot!
Sa herë dal me shetitë,
me pi pak jetë, pak ajër,
n'alenë e gjanë t'këtij qyteti t'bekuet,
m'vihen nga mbrapa
do këlyshë t'vegjël.
Larg qoftë - nuk due me thanë se jam qen!
Unë jam veç një këlysh.
Por... ç'due me saktësue, asht kjo:
gjithë këlyshët e botës,
lejnë me yllin, me parafatin,
me i shkue, gjithnji mbrapa,
një qeni t'caktuë, që duket qen,
po asht veç këlysh..."

Aq shumë e dëshpëronte Cezarin, ky
mendim,
sa kur futej ndhomë t'fjetjes,
bahej qindpërqind impotent,
edhe s'mundte me i ba gja zonjës,
kështu që... zonja detyrohej...
me u ba... hanë e qiejve...

DITA QE DRITË E PAPAME...

Dita qe dritë e papame,
dielli hante një copë t'vetvetes,
e n'ballë t'legjioneve,
defilonde krenar, Cezari,
mespërmas Romës.

N'nji skaj t'nji sheshi grandioz,
një pëllumbar i varfën,
me një torbë gruni n'qafë,
i qeshun mes një tufe pëllumbash,
e pa perandorin natë defilim ekzaltues,
edhe i foli mendja:
"Dynja e çuditshme, po për Zot!
Gjithë bota asht e Cezarit,
përveç Cezarit!..."

(Qe ai pëllumbar,
një mbret i ramë,
a një ciceron i panjoftun?..)

CEZARI I MUNGUET

N'dritë hane, ndrit pallati, perandoria,
e ndhomën e perandorit
frymon heshtja.

Ndezun gjithë qirinjtë,
avullon uji i vaskës.

Avullon n'vaskë
edhe trupi ngjyrëqumësht i Livias,
por ç'e do, ç'e do, kur Cezari mungon
(jo trupi, po Cezari që mendon):
"Oh, Zot! Asht kaq e bukur Livia,
kjo grueja ime e ligjshme.
Por, kot! Ma grue se gruen, e kam senatin.
Senatin e shkërdhej unë,
e Livian rogtari!..."

SHAZIM MEHMETI

Dimni asht, me një kambë n'mue

Poezi



BAHU MIKU YT!...

Bahu miku yt!
Dil, shiko, shijo!
Mendja do ujë, mendja do dritë.
Drita, gjithëherë ka qenë,
drita vazhdon me qenë,
një mike e mirë.
Dielli asht kurues i madh.
Ai lumë atje, gurgullon kaq bukur.
Pema matanë lumit,
me grykën e atij zogu këndon.
Muret janë kaq përmbytëse.
Betoni, po aq.
Poashtu asfalti.
Shikoje atë malin tutje,
si nis me u ba shqiponjë,
si nis me u ba me flatra,
si mëton me u përqafue me qiellin.
Ma larg, ma larg,
e rame n'mendime,
asht një kodër e vogël,
rrethue me ujë,
mbështjellë me dritë.
Atje, natë kodër,
një fëllanzë, mbi dëllënja lodron.
Me padurim t'pret, ajo fëllanzë.
Me padurim t'pret,
me t'i pa, me t'i përpi sytë...
me ba prej teje
një zog këndues...

PARA SE ME E ZBULUE VETEN...

Para se me e zbulue veten,
n'zemër e n'mendje,
Ademi e përtypte
mendimin për Evën.

E përtypte papushim,
derisa një ditë,
i ranë gjithë dhambët.

Kur e zbuloi Evën,
Ademi qe
pa asnjë dhambë n'gojë.

Kështu ndodhi,
dhe trupi i Evës iu shfaq i lëmuët,
i rrëshqitshëm, i ndritshëm,
pa asnjë njollë,
pa asnjë kafshim,
mu si fytyra e hanës,
nditën e parë t'bamjes.

Ndodhi kështu,
dhe u verbue Ademi, nga ajo dritë,
iu morën mendtë,
dhe mbi atë dritëmish t'lëmuët,
i rrëshqitën kambët...

PËRSËRI PËR CEZARIN

Sa herë e zinte veten ngusht,
sa herë i shkante mendja te paburnia e
vet,
Cezari mbushte një dhomë t'madhe me
robinja,
edhe lakuriq dilte para tyne.

"Unë jam Cezari, unë jam pushteti!",
u thoshte ai robinjave,
e robinjat... robinjat e shikonin dëshpërue-
shëm,
dhe i kafshonin gjuhët, i ulnin kokat,
tuj dashtë mos me folë me za:
"Asnjifarë burri! Asnjifarë burri!"

Por, Cezari,
që qe jo vetëm pushtetar,
por edhe dijetar,
e kuptonte se ç'duhej ba
me heshtjen e robinjave,
kështu që i merrte ato një nga një,
i fuste n'nji kthinë t'errët,
dhe ua priste gjuhët, cicat.

Kështu sigurohej ai,
që perandoria me vazhdue
me mbetë perandori,
robinjat mos me mbetë gra,
dhe Cezari me mbetë Cezari...

DORËZIM

Nata u lodron mbi krye,
si një balerinë e zezë.

Ajo ia prek duert,
e shikon n'sy,
e shikon drejt n'sy,
ia thotë premë:
"Jam kaq e lodhun!
M'asht kaq e vështirë,
me vazhdue me jetue ma tej!"

Ai ul shikimin,
fsheh lotin, sytë,
e nuk ia thotë:
"Asht kaq e pamundun!
Asht kaq e pamundun!..."

M'KALOJ, MEZI, KJO NATË E DIMNIT...

M'kaloi, mezi, kjo natë e dimnit.
Tashti, jam ngjendje, me pa n'vetete.
Tashti jam n'mundësi, me pa ndryshim.
Shoh si po zbardh, ky mëngjes.
Ky mëngjes, m'ngjanë me një foshnjë,
që i çel sytë, e sheh dritën,
s'pari herë n'jetë.
E shoh, e lakmoj.
E lakmoj, e admiroj.

Asht mrekulli.
Asht vet drita e Zotit, ky mëngjes.
Plisin e bardhë t'Taulit,
vendue, ndrequn mbi vetull,
he pirrolla i qoftë!
Ky mëngjes ka ba natë gjumi, e unë jo.
Ky mëngjes asht teshtima e natës, e unë
kush?
(Mbetet me pa, mbetet me pa,
a ka me ma thanë dita...)

ÇASTI I VETËM I MARIËS

I këndonte trupi.
I këndonin edhe veshët, flokët.
Ujëdritë i bahej mishi.

S'pari herë,
amësi jete po bahej,
po bahej ujësi drite.

Lamë, lamë sytë,
ndritën e Tij,
ajo bahej veza,
që t'kuqen niste me e pjekë,
n't'bardhën e vetes...

DIMNI ASHT ME NJË KAMBË N'MUE...

Dimni asht, me një kambë n'mue.
Gjithnji e ma pak ha.
Gjithnji e ma pak ndigjoj.
Gjithnji e ma shumë mërdhij.
Gjithnji e ma keq shoh.
Gjithnji e ma pak botë, gjej përreth meje.
Gjithnji e ma pak botë, gjej mbrenda meje.
Gjithnji e ma shumë due, dëshiroj.
Për besë, nuk ka si Zoti.
Zoti asht balancues i madh.
Zoti, kaq bukur, kaq artistikisht,
m'i zavendëson mungesat
me dëshirimet.
Zoti, kaq bukur ma lehtëson rrugëtimin
drejt fundit t'dimnit...
Pafund, pafund e falënderoj!...

KËTU KA NJË HAPËSI...

Këtu ka një hapësi.
Këtu ka tym dhe njerëz.
Mbrenda meje nuk ka njeri.
Prej vetes, dalë, ikun.
I lirë, si zogu i hinit
matanë qiellit.

Matanë, fërkohen
dy rrasa t'mira eteri.
Këndej shkrep
ky mendim i keq.

(Jam, a jo?
Jam unë, a nuk jam unë?..)

NJERI I MIRË

E pohoj: kam qenë pak budalla.
Që domethanë, njeri i mirë.
Përtej t'mirës, njeri i mirë kam qenë.
Madje, kam qenë, edhe ma përtej t'mirës.
Por, punë budallai më e mira, po për Zot.
E mira, ma ka thye kokën, ditë për ditë.
Keq jam i dëshpëruët.
Ma keq se keq jam i dëshpëruët,
ndaj kam vendosë me u ba vëlla me djallin.
S'paku, njashtu kam me mujtë me u shfrye
disi.
S'paku, njashtu kam me mujtë,
me ia thye kokën djallit,
paçka se edhe djalli mue.
Do ta bajmë me barabar.
Si vëllau... me vëllaun...

BORXHLINJ

Amerika ka borxh. Kina ka borxh.
Rusia ka borxh. India ka borxh.
Kanada ka borxh. Japonia ka borxh.
Gjermania ka borxh. Anglia ka borxh.
Franca ka borxh.
Borxh kanë edhe gjithë shtetet tjera,
që janë, ma t'vegjël dhe ma borxhlinj se
këta.
Shkurt fjala, gjithë bota ka borxh...

Logjikshëm, shtrohet pyetja:
"Kush i jep borxh botës?
Unë, ti, ai, apo ndonji tjetër mjeran si
ne?..."
Epo, jo. As unë, as ti, as ai,
po Zoti që di me qenë
nji bankier, nji borxhdhanës,
a nji kredidhanës brilant!...

(Ruaje Zot, Zotin!
Ruaje Zot, Zotin, mos me vdekë!
Se... përndryshe...)

KAQ BUKUR T'BUZËQESH MËNGJESI,
E NUK E SHEH!...

Kaq bukur t'buzzqesh mëngjesi,
e nuk e sheh!
Kaq zognisht t'këndon ky lumë,
e nuk e ndigjon!
Je n'breg t'këtij lumi, je n'breg t'kësaj
magjie,
e nuk e di ku je!
Ti je i zhgënjyhet prej vetes,
ma keq se Zoti prej bijve t'vet!
Ti mendon, se ma, nuk ke çka me ba.
Ti mendon se nuk ke si me e mundë ditën.
Nuk merr përsipër me ndryshue diçka.
I jepesh, pa kushte, apatisë tande.
Ban prej shikimit tand nji tjetërsi.
Nuk sheh çasht.
Nuk ndigjon ç'zanon.
Tjetër gja ndodh, tjetër gja t'ndodh.
Tjetër gja asht ba qenia jote.
Qenia jote asht ba nji zhgënjim i papamë.
Asht kaq gja e keqe me qenë jashtë vetes.
Asht kaq gja e keqe me qenë veç n'vete.
Nuk t'jepet me u ndalë, nuk t'jepet me
ndërrue gja.
Nuk t'jepet me i thanë vetes "Mjaft!".
Ti ke nevojë urgjente, për nji ndihmë!
Ti je nevojë urgjente, për nji ardhje n'vete!
Ti ke nevojë urgjente,
me t'u ndalë mbi sup, nji zog drite!
Por, i kanë vra, tashma, zogjtë e dritës!
I kanë vra, i kanë vra!
Nuk ka ma zogj drite, të t'ndalen mbi sup.
Nuk ka ma zogj drite,
të ta pëshpërisin n'vësh kangën e shpëti-
mit...
Zgjohu, pra, bahu vetja, bahu ti!
Akordoj gjithë telat!
Telat e syve, telat e veshëve,
telat e zemrës, telat e mendjes!
Ba, ba diçka,
qoftë edhe me shumë vuetje,
qoftë edhe me shumë gabim!
N'mos mujtsh me ba gja tjetër,
haje mutin tand!
Oh, ti nuk e di, ti nuk e di!
Ti nuk e di se tahma e mutit tand,
asht shumë ma e durueshme,
se tahma e zhgënjimit tand...

KY LUMË ASHT HESHTUN...

Ky lumë asht heshtun.
Hana ka vdekun.
Nata asht ba unë.

Po errëtohet, po ngryset nata -
nata i merr tiparet
e nji plaku t'dëshpëruet.

E shoh natën, dhe m'bahet mendja ujë.
Ma pak, e ma pak, m'ndigjon gjuha.
Me ma pak zemër bahem.
Gjithnji e ma pak, jam unë.
Nuk këndoj ma.
Nuk flas ma.
Nuk leh ma.
Cijas.

DHURATA HOTI

Ungjilli sipas meje

tregim



Zoti, i madhi e i plotëfuqishmi, i pagabueshmi e i papërsëritshmi, përderisa po shfletonte krijimet e tij, papritmas, vërejt një dhomë të kuqe që s'mbante mend ta kishte krijuar a menduar kurrë. I habitur sa më s'ka, por edhe i entuziazmuar dhe kurioz, sepse kjo nuk kishte ndodhur kurrë, ai vëzhgoi këtë pjesë misterioze që nuk e mbante mend, por si ishte e mundur që diccka e tillë t'i kishte ikur atij që s'i ikte asgjë, ai disi u ndje falenderues që kishte diccka që po e ccudiste. Dhoma e kuqe ekzistonte brenda universit të tij, megjithatë ishte vecmas gjithçkaje, dhe dukej që pjesa tjetër e krijimit të tij nuk mund të ndërhynte në këtë dhomë. Nuk ishte shtëpi a ndërtesë, ishte vetëm një dhomë e vetmuar në qendër të universit, me një derë të zeze, e lyer me një ngjyrë që ende dukej e freskët, apo kishte mbetur e tillë sepse nuk ishte përdorur. Brenda kësaj dhome, ndodhesha unë, e ulur në një divan prej plishi të shkëlqyeshëm të zi, një mace e bardhë që po lëpinte putrat, indiferente ndaj gjithçkaje, dhe një dhi ngjyrë hiri. Përreth mureve të dhomës, të vendosur në rresht nga tri në secilën anë qëndronin krijesa trupa të së cilave u ngjanin femrave deri të pjesa e barkut, ndërsa në pjesën e poshtme të trupit kishin penisë. Të gjitha kishin veshur nga një pelerinë të bardhë që u varej krahëve, e qëndronte e lidhur me një shirit të gjatë të kuq. Flokët e tyre të gjata pambarim, lëkura e tyre e bardhë ndricconte dhomën, ato pëshpërisnin fjalë të padëgjueshme, të cilat përsëriteshin prej njëra tjetrës me pak sekonda dallim.

Sapo pamë njëri-tjerin, Zoti e unë u habitem tejmase pwr ekzistencën e njëri-tjetrit, ai pak më shumë sepse fundja ai ishte Zoti. Gjithsesi shpejt e mori veten dhe më pyeti se pse dhoma ime nuk kishte dritare. Unë e pavetëdijshme për ekzistencën e dritareve e pyeta se pse nevojiten. Nuk e kuptova se pse u duk sikur iu thye zemra kur unë u përgjigja. Më vështroi me gjithë mëshirën hyjnore në sytë e tij dhe më pyeti nëse e njihja lumturinë. Në atë moment e kuptova që mungesa e dritareve më

kishte mbyllur mundësinë për të përjetuar lumturinë por edhe dhimbjen dhe u bëra e vetëdijshme për të dyja, apo më mirë të them për mungesën e tyre. Nuk e di pse kjo fjalë më bëri ta shoh në një drite sensuale. Mu duk sikur ndjeva dhimbjen e gjithë botës brenda tij, trishtim sharmant dhe një lloj kimie shumë karnale. E dëshirova dhe ai që di gjithçka e lexoi dëshirën time Në dyshemenw e ftohtë të rrethuar me mure të kuqe, unë dhe Zoti bëm dashuri përderisa dhija dukej sikur na shikonte me ngulm, ndwsa macja flinte e ngrihej e lepinte putrat, shtriqej, por pa na vënë veshin, e pa interesuar aspak nëse ishte Zoti, djalli apo një fqinj i ri.

E pyeta veten se cfare ndodhte me botën ndërsa zoti bënte dashuri, dhe vetëm në atë moment u bëra e vetëdijshme që ai kurrë nuk më ishte prezentuar dhe se në momentin që ai kishte hyrë në dhomë, unë kisha marrë për të mirëqenë shenjëtërin e tij si diccka që kishte mbushur dhomën me një të vërtetë të padukshme e të padëgjuar. Fillova të mendoj nëse Zotin e kisha krijuar unë, ose të paktën këtë Zot, karnal e konfuz, të cilit i iknin ekzistenca brenda krijimit të tij. Ky mendim sikur e pushtoi dhomën dhe perderisa po ndjeja penetrimet e tij, hapa sytë dhe përballë, ngerthyer mes këmbëve të mia pashw veten, ose atë që e mendoja si vetja ime. U afrova drejt krijesës që po shihja, e eksituar, ekzaltuar, dhe pashë ngultas në sytë e saj dhe imazhi që mu reflektua ishte Zoti, ashtu sikur e kisha parë pak momente më herët. Në vend të trupit tim pash trupin e tij, pastaj u shëndrova në embrion vetëm për tu transportuar në hapësirën e pamasë të universit, ku një qetësi shurdhuese më bën të kuptoj që jam krejtësisht vetëm, anipse papushim kërkoj për një frymë tjetër, por pas pak e shoh që universi dhe gjithçka tjetër është krijuar prej mendjes sime dhe unë jam vetëm, krejtësisht vetëm, vetmia njerëzore kurrë nuk mund të krahasohet më këtë që po përjetoj tani dhe ndoshta e kam përjetuar gjithmonë.

Për të zbutur dhimbjen e këtij zbulimi u përpjeka të kujtoja momentin kur Zoti

kishte hyrë në dhomën time dhe më kishte pyetur për dritaret. Mendimi për mungesën e dritareve tashmë mw po zinte frymën, po më frikësonte, por nuk jam e sigurtë a isha e frikësuar prej mungesës së dritareve apo asaj ccfarë do të shihja nëse do të kisha të tilla. Nuk e di sa zgjati, sepse koha nuk ekzistonte deri në momentin që fillova të mendoja për të dhe në momentin që u bëra e vetëdijshme për kohën, ajo mori formën e realitetit tim dhe jeta ime u shpërfaq, duke tentuar të më bëjë të harroj kuptimin dhe Zotin në të cilin isha shëndrruar.

Mendova për dritën, detin, muzikën, kuajt, kërmijtë, telefonat, armët, mallin, kripën, rrugët, kafen, të qeshurën, mëngjesin, filmat, natën, puthjen dhe sakaq, krijesa që kisha përballë meje që mbante pamjen që mendoja që e kisha, u zbeh deri sa u zhduk dhe unë e kuptova që ajo dhe dhoma e kuqe kishte një rreng që ia kisha punuar vetes nga papërballueshmëria e vetmisë. Unë jam një Zot i vetmuar, një Zot - fëmijë i trishtuar që shpreson në një ekzistencë të barabartë që diku, dikur, mund t'i ketë ikur. Që të mund të luaj pastaj me të si më një bashkëmoshatar duke iu mburrur për të gjitha krijimet si lojëra kreative që do ta fashionin. Një dhimbje therëse më përshkoi mes trupit, ose asaj që e konsideroja si trup por në të vërtetë ishte krejt bota, realiteti që më ishte mërëzitur. Filloi të më mungonte, të më dhimbte, mungesa e iluzionit që më kishte lumturuar dhe vendosa që për ta përjetuar përsëri, duhej të shkatërroja gjithçka, të shëndrrohesha në asgjë dhe të lindja prap.

Kuptimi i gjithë kësaj sikur hapi një dritare në dhomë, të cilën nuk po e shihja, por po e ndjeja ajrin që përshkonte dhomën. U shëndrrova në fjalën e parë që nxit krijimin, u shëndrrova në tokë, qiell, hanë e diell, në krijesën e parë, në njeriun e parë, në mëkatën e parë, në vdekjen e parë, në stërgjyshen time, nënën time, embrionin në barkun e saj, u bëra unë - bebe, qava, qesha, fjeta, u zgjova, eca, vrapova, u rrëzova, pastaj dhimbja e kënaqësia, sa e vështirë të dallohesha njëriun prej tjetrës kur ke harruar që gjithçka vjen prej dicckasë së vetme, pastaj rritja, dashuria, mllëfi, urrejtja, paknaqësia, dështimi, bukuria, ngërqet, klithamat, lotët, orgazmat, thyerja, shkatërrimi dhe rikuptimi që asgjë nuk përfundon. U shëndrrova që ccdo njeri, planet, element, krijesë e atom që ka ekzistuar derisa u ktheva e ndjeva dorën e tij që rrinte ngjitur pas shpinës time, tek më përshkonte barkun, një lloj ëmbëlsie e dhimbshme që nuk dija pse më befasonte, kur sapo kisha përjetuar gjithçka që mund të përjtohet. Pa mundur të rezistoj më shumë, hapa sytë në vend të dhomës së kuqe, isha në një dhomë të errët, ku pas disa përpëlitjesh së syve arrita të dalloj një shkëlqim të kuqërremtë. Ishin drita të vogla që u përngjanin atyre të vitit të ri, të cilat ishin ngjitur rreth një pasqyre të madhe që ndodhej përpara meje, ku pashw veten, ndërsa përbri meje rrinte shtrirë ai. Në një kënd të dhomës, një disco ball po reflektonte dritat e kuqërremta nëpër trupat tanë, ajri i dhomës kundërmonte erë cigaresh, prej derës që nuk ishte e mbyllur mirë dëgjoheshin disa zëra, koka po më dhimbte dhe isha e uritur, por kurrë nuk kisha qenë më e lumtur. Mendova se kush kujdesej për botën ndëkohë që unë rrija e shtrirë pranë tij, e te këmbët e mia macja u zgjua, u shtrij me indiferencë ndaj pranisë time, me këmbë më shtypi këmbët për të bërë vendin e saj dhe mes gërr gërr-ave e zuri gjumi sërish. Unë jam zoti, në pushime verore.

E QUAJTI BUDALLAÇKA

Ajo shtypi butonin e ashensorit dhe priti. Prapa saj dëgjoi ca zëra të flisnin si fshehtas në gjuhën e vendit...duhet të ishin një çift italianësh të rinj që po i çuqurrisnin ëmbëlsisht njeri tjetrit. Ktheu paksa, me delikatesë kokën. Një biondine lozonjare e një djalosh bojalli paksa i ndrojtur por simpatik. Dukeshin moshatarë. I buzëqeshën. Edhe ajo u buzëqeshi. Dera e asensorit u hap dhe në të gjithë kuadratin e asensorit të vogël, u duk si në ekran një figurë...asaj ju duk si një fytyrë e njohur mashkulli...ishite me flokë të gjatë e fytyrë të zeshkët tipike indiane. Tek dilte, ai ju buzëqeshi të treve, i përshëndeti me kokë e pothuaj njëherazi edhe alla orientale me dy duart kryqëzuar mbi gjoks...Në hollin e hotelit e prisnin dy goxilla bodyguardë me shtatlartë se ai.

Ajo e ai çifti i ri italian, hynë në ashensor. ...E zhytur në mendime të saj jo fort të gëzueshme atë mëngjes, ajo papritur ndjeu bezdi nga çifti që i ish dukur simpatik aty poshtë...pak më parë...

"Che cosa? Che cosa?" ("çfarë-çfarë?!" ju përkthye asaj), po i përsëriste për të disatën herë mu pranë fytyrës, biondina të dashurit... Dukej sikur po i frynte në buzë...aq afër...sikur nga çasti në çast do ja merrte frymën, do ta puthte... "o Dio..." shtoi biondina, kësaj rradhe duke rënkuar. Ai diçka i pat thënë pak më parë në vesh...e ajo sikur nuk donte ta besonte...

"Çfarë tyrylyçke" mendoi Ajo duke kuptuar se kundër dëshirës, po ndjehej e eksituar paksa...Dhe sa e ëmbël e e dashur i ish dukur aty poshtë...Kushedi sa e bezdisur do i bëhej me kohën atij djalosht simpatik, që buzëqeshte me ndrojtje pas çdo pasthirmme të së dashurës, duke parë fshehtaz e si me turp nga ajo...femra e huaj. Ishin pothuaj ngjitur ata të dy e ajo...

Ajo me mend, e quajti vajzën bionde Budallaçka...

...Patën rastisur të ngjiteshin në të njëjtin kat...Ashensori nuk kish ndaluar mirë akoma kur ata të dy u hodhën gati me vrap jashtë në koridor. Ajo përpara e ai pak si me turp nga pas. U varën në parmakët e hollit të atij kati e po shihnin, me kërshtëri poshtë...sidomos ajo...ish varur krejt e dukej sikur do binte nga çasti në çast poshtë...

...Dhe befas asaj i vetëtiu në kokë e kuptoi gjithshka."Ai që patën parë...ai që doli nga ashensori, duhet të kish qenë ai... aktori i famshëm indian i filmave me xhungël...me tigra e me elefantë...ai që u merrte zemrat lady-ve angleze...ai me ca sy si të verdhë në të gjelbër...me gjarpërin e hipnotizuesin brenda tyre njëheraz...

...Ajo.. po digjej edhe ajo nga kureshtja për ta parë edhe një herë...po nuk po e lejonte veten të shkonte edhe ajo... si ajo Budallaçka te parmaku...gjithmonë nuk i kishte duruar dot fetisheet, të famshmit, aktorët sidomos... kish një përbuzje për ato turmat idiote të fansave që çmendeshin për një autograf a selfie... Pat arsyetuar shpesh herë me veten për efektin mediatic të të famshmeve tek mediokrit...çmendurinë zënë fill a arritur kulmin në Amerikën hollivudiane ndofta... Në fund të fundit është efekti magjik i medias më shumë se vetë i famshmi...aktoriaktori sidomos...në pjesën më të madhe thjesht imitator...me ndjenja të cekta e fluturake, i paqëndrueshëm e fundja mediokër në fundjetën e vet...

...pat pasur përsihate të gjatë për aktorin...

...pat qenë e lidhur për do kohë edhe ajo me një aktor...nuk është se nuk i njihje edhe nga afër..." mendonte...

Ajo ishte a e konsideronte veten, një lloj virgjëreshe karshi dhunimit a përdhunimit mediatic të cilit nuk i rezistonin dot femrat...e jo vetëm kokëboshet...edhe ca të tjera inteligjente...Ajo e dinte, e ndjente që nuk ishte snobish, ndjehej e veçantë, e dinte me siguri...ishite mospërfillëse, ...së paku e kish provuar se nuk ish si të tjerat. Edhe atë

YLLI PANGO

Dy tregime



aktorin ajo e pat lënë.. torollakun...

... i shpëtoi si kurdoherë tundimit(sado të vogël...njeri ishte edhe ajo)...a joshjes së famës...u largua për gjatë koridorit...hapi derën e dhomës... I shoqi (i dashuri) e priste në dhomë, i shtrirë në krevat, me të dy këmbët ngritur lart mbi dy jastëqe... po shihte tv...

"Hej" i tha ajo... dhe papritmas sikur diçka e shkëputi nga dera që porsa hapi...kërceu pas, e tërhoqi prapë derën me forcë nga jashtë..." ku shkoni moj" i briti ai nga brenda... vrapoi e shkoi u var edhe ajo te parmaku për të parë poshtë...krah për krah me "budallaçkën" italiane e boyfriendin e saj...

...Poshtë në holl aktori ish rehatuar në një kolltuk të madh, rrethuar në një farë distance nga dhjetra njerëz që prisnin të bënin selfie a të merrnin autograf...Bodiguardët nuk i linin njerëzit të afrosheshin shumë...i shtynin disi me kujdes...aktori nuk ish ende në gjendje tu jepte fansave dashamirësinë e duhur, sado formale(fansave do u mjaftonte edhe ajo)...Ai po intervistoehej. Kamerat e kishin kryqëzuar e ai ndjehej si jo më mirë rehat...këmbë mbi këmbë në kolltukun principal...

...Pat mbriritur dhe policia (i patën parë policët në hotel që të djeshmen kur mbriritën, po nuk patën kuptuar pse, ndofta ndonjë kriminel i kapur aty "patën menduar)...

...Aty nga nata e vonë, kur të shoqin (a të dashurin), e pat zënë gjumi me kohë, Emy Principal, kështu quhej gruaja e re, e gjallë dhe e re edhe sot, vazhdonte kundër principeve të saj, të endej në holl si rastësisht. Ulej e ngrihej kohë pa kohë nga kolltuku ku pat qenë ulur ai, dilte jashtë në ajër të pastër... pinte cigare, kthehej brenda...Pat ardhur një orë kur në holl kishin mbetur vetëm recepionisti i përgjumur që i hidhte herë herë vështrime kurioze e ajo...

...Derisa më në fund...vonë fare, ndoshta ndaj të gdhirë... indiani "mediokër" u shfaq mes dy bodiguardëve duke ju marrë këmbët. Dukej të kish pirë...

Ajo e ndjeu veten zonjë të situatës e i mori atij autograf. Gati si me urdhër. Ai pati dashamirësinë të bënte me të edhe selfie. Madje aktori pati kënaqësinë ta përfshinte për beli tek selfionin. Patëm harruar tu themi se për rastësi gruaja e re, Emy Principal, ishte edhe e bukur. "Edhe sexy" do të shtonte aktori. ...Ajo e shoqëroi aktorin duke u ngjitur së bashku me këmbë dy kate më lart, e duke biseduar paksa anglisht...vetëm paksa për tema të lehta a të cekta. Kështu deri në derën e dhomës së tij. Aty ajo i tha atij natën e mirë e bëri të largohej. Gjysëm a krejt i dehur, aktori e kapi për krahu e tentoi ta fuste disi me delikatesë brenda. Ajo u ngrys pak, e tërhoqi

krahun pa delikatesë dhe u largua pa e kthyer kokën pas. Në fund të fundit për aq i ishte dashur ai. Një selfie(thjesht për qejf të saj, jo si ato budallaçkat që binin rrëshqanthe)... Ai autografi kot...sa për ti bërë qejfin...dhe si mbyllje... një bisedë e vogël sa për të rikuptuar a vërtetuar edhe një herë atë që ajo e dinte prej kohësh, e kishte të sigurt... se çfarë ishin këta...shkurt "tip i lehtë"...dhe aq...

...Pasi ai pat mbyllur derën e dhomës e bodiguardët ishin larguar, ajo siç e pamë ish kthyer e tani po hynte lehtë e pa u ndjerë në dhomën e saj dhe natyrisht edhe të të dashurit... apo ndoshta edhe të burrit të saj(kjo ende edhe sot ka mbetur e pasqaruar). Mashkulli i dhomës së saj gërrhiste në gjumë të thellë e të patrazuar. Dukshëm pa e ndjerë mungesën e saj...

Ajo hezitoi pak...u pa shpejt në pasqyrë ...pastaj doli nga dhoma, mbylli derën lehtë nga pas...dhe u ngjit sërish në katin më sipër... Trokiti lehtë në derën e dhomës së aktorit që u hap pothuaj menjëherë...

...Aty brenda ajo ju dha atij, natyrshëm...(natyrisht) e pavirgjër dhe jashtë çdo principi a paragjykimi të mëparshëm negativ për aktorët a njerëzit e mëdhenj...

LAJMI KEQ - LAJMI MIRË

...Më pat mbetur merak që në shoqërinë time të kafes së pasdites, askush nuk mi lexonte poezitë. Ndonëse unë nuk jam poet profesionist e as poet me çmime. Thjesht një veteriner me një dell modest poetik. Gjithsesi më është thënë se poezitë për barin e gjelbër, jonxhën, viçin e palëpirë...e natyrisht poezitë kulmore mbi lopën e bulmetin...nuk i kam të këqia.

Gjithsesi ndër miqtë e mi, me të cilët pi kafen e pasdites, asnjëri syresh nuk më ka lexuar askurrë, as edhe një poezi. Në fillim kam qenë i keqardhur por pastaj e gjeta rrugën e paqtimt e mora vet-ngushëllim.

-Së pari ata nuk kanë faj, sepse në kohrat e sotme nuk para lexohet poezi. Madje as poetit të njohur Barbun, ndonëse ish-spiun e fitues i sa e sa çmimeve, nuk i lexohen më poezitë. Natyrisht e kam fjalën për "lexuesit", që ai u a fal vëllimet poetike...Sa për shitje vëllimesh poetike as që bëhet fjalë. Pastaj nuk duhet harruar: kjo mosshitje a ky moslexim, është bërë tashmë një vuajtje mbarëkombëtare e poetikës sonë. Thuhet edhe mbarëbotërore. E ky është mbingushëllim...

-Ngushëllimi i dytë vjen ngase askush nga miqtë e mi nuk ka lidhje me letërsinë jo më si profesion, por as si prirje...madje

as si keshasje(qejf). Njeri nga miqtë fjala vjen është merceolog. Tjetri gjykonjë... Një tjetër ka prirje të thekur për poker e sado që gjithnjë humbet, cilësohet si asi kombëtar i bllofit. I katërti keshaset me raki...dhe teori konspiracioni, ...natyrisht me të dëgjuar se leximi ka kohë që e bezdis...

...Kam natyrisht edhe lehtësime të tjera; ndër të cilat faktin që nuk mund të pres që miqtë të lexojnë poezi të mia, kur e di mirë se ata janë gjithnjë të zënë me punëra. Ata nuk gjejnë dot kohën as të lexojnë në celular, në rrjetet tona sociale, ndonjë vlerësim pozitiv, qoftë edhe dy-tre rreshta për poezitë e mia baritore. Madje as "like"-t e ndoca dashamirësve, nuk u a ze syri asnjëherë. Madje as atëhere kur një shoqatë veterinarë, mobilizoi gjithë anëtarët e saj, e në shenjë solidariteti profesional, më siguroi nja 100 like në facebook...prapë, as këto, asnjë nga miqtë e kafes së pasdites; nuk i pat vënë re...

...Kësisoj u magjepsa kur tek pinim kafen atë ditë, njeri nga miqtë, ai merceologu, më tha duke u rrufisur, se...e pat ...jo lexuar por përpirë, një kryeshkrim në faqe të parë gazete, ku unë shahesha me rrënjë e me degë, madje dhe nga nëna e nga baba, gjyshi e gjyshja, ...shahesha nga një pensionist-profesionist, lidhur me një poezi timen, ku siç shkruante ai, denigrohej qumështi i Gramshit në raport me çka prodhoni lopët në Librazhd. Madje ai e cilësonte poezinë time jo veç fyerje lokale, por mbarëkombëtare dhe propozonte padi penale se edhe Gramshi siç thosh me të drejtë ai, pjesë e kombit qe apo jo.

Nuk pat mbriritur mirë ky miku të më jepte kurajën e ngushëllimet, kur mbririni i dyti, ai i pokerit që më tha se pat humbur një parti pokeri, pasi i ish dashur një kohë jo e shkurtër për të dëgjuar të bijën ti lexonte shkrimin kundër poezisë time e pastaj për të analizuar ai vetë...E më pas për të arritur në konkluzionin se ai nuk qe një shkrim dokudo i një pensionisti pa rëndësi, por punë e një grupi të tërë, që "donte të ma fuste thellë e më thellë". "po po të ta fusin..." përsëriti ai me entuziazëm, duke fërkuar duart ndërkohë që porosiste një dopio raki.

I treti ndër miqtë, nuk di pse mungonte atë ditë(ai i ka pasur gjithmonë merak biografik e këqia)...

...I katërti si zakonisht erdhi. Erdhi dhe ma bëri zemrën mal. Ai bashkëjetonte prej kohësh me një bionde ardhur nga Myzeqeja me të cilën i bashkonte mbi të gjitha përbetimi për të mos lexuar kurrë...kurrëfarë gazete e as shikuar kurrëfarë televizioni. Veç atë ditë nuk dihej pse qe bërë përshtim...

...E patën dëgjuar lajmin mbi poezinë time të mallkuar në TV, në pasqyrën e shtypit të ditës...e ai pat rendur vrikthi të blinte gazetën te qoshku, në qosh të sheshit para shtëpisë. Pastaj e patën lexuar; Në fillim e pat lexuar ai, e ajo pat dëgjuar; pastaj e pat lexuar ajo e pat dëgjuar ai...më pas e patën lexuar në duet të dy. Së fundmi i kishin gjetur një melodi e e patën lexuar-kënduar..." me trishtim së toku"...siç tha ai...

Nuk po ju them, veç këtij informacioni dhënë nga ay vetë, se si më ngushëlloi a ç'më këshilloi ky mik me vlera. Veç vura re me kureshti se ndryshe nga zakoni i përditshëm i kafes së pasdites, atë ditë ai porositi verë dhe i kërkoi kamerierit ti sillte nga ëmbëltoja aty pranë, një tri leçe...për ta shoqëruar...

...Tek pinte verën miku shtoi, se kish harruar të më thoshte...që për gazetën me shkrimin anti-poetik kundër meje, patën porositur me bashkëjetuesen një kornizë. Për ta kryqëzuar atë shkrim në mur. Ndërkohë bashkëjetuesja pat vrapuar poshtë për të blerë edhe një kopje të dytë të gazetës. Ata kishin menduar ta vendosnin atë në një tryezkë të vogël poshtë kornizës...në mënyrë që vizitori i rastit, pasi të arrinte ti zinte syri gazetën me titullin e madh me emrin tim në faqe të parë... të mundte pastaj, pa qenë nevoja të hapnin kornizën, të lexonte në brendësi, shkrimin në faqen përkatëse...të gazetës së dytë...

Lajmi kishte marrë dheun por me sa duket vetëm unë s'e dija. Unë, koleksionisti, si dhe i ati, miku im i ngushtë, i cili për pesë vitet e fundit, pasditeve, punonte fort me të birin, duke i dhënë kulturën e tij të gjerë. Për pasionin aq duhet, sa të futet krimbi. Dhe pikërisht asaj dite kisha gjetur të bëja një intervistë me të. Qemë përgatitur prej kohe dhe ai më priste në krye të rrugës, me shallin e hollë të bukur, hedhur nën jakën e xhakëtës, që i jepte një hir të veçantë dhe unë mu për këtë e admiroja më tepër. Vishej me shije dhe thua se çdo rrobë i shkonte me fytyrën që ngjallte ëndje e gëzim dhe trupit pak a shumë të mbushur dhe të fuqishëm. Anash tij dy hije që ai thoshte se i njihje si veten. Gjithnjë priste po aty. Këdo. Edhe veten, edhe kur nisej për rrugë të largët. Me të qeshur më thoshte se hija e tij e brendshme shfaqej jashtë me dritë, ndërsa hija e shkaktuar jashtë prej dritës, errësohej dhe sikur kërkonte vend për t'u fshehur. Dhe e gjithë kjo tollovi më kish gjetur mua, thosha. Jo më kot m'u vetëti të koleksionoj. Kanë gjetur rrugë dhe janë zhdukur ikona, vepra arti, veshje, madje edhe tavane e punë të tjera të rralla. Do gjejmë një lokal dhe unë do të rrëfehem. Për gjithçka. Dua që ta kesh në dorë jetën time. Të falem, mik. E nesërma do të qe e vonët për mua. Nganjëherë duket se po kërkoi djallin. Ndoshta. Ky ishte një nga ata që po e kërkoi me qiri, por ja që e kisha dhe e kam brenda vetes.

Edhe pse hijet s'dukeshin më, ai e gjeti një mënyrë për t'i zbuluar. Rubi ishte aq interesant sa edhe dita s'të dukej më e gjatë, apo e lodhshme. Se gjithnjë do të gjente një mënyrë ndryshe.

- Kristi, mos u merr aq fort me mua, por, megjithatë, fundja, le t'i kryqëzojmë ca gjëra, pse jo edhe fatet tona, një fije e padukshme na lidh, një fije magjike e marramundur dhe që kurdoherë fishkëllen. Është nga ato të *Njëmijenjë netëve* ajo! Me nga njëmijenjë i kemi të gjitha gjërat ne! Apo jo? Njëmijenjë ankime, njëmijenjë këshilla, njëmijenjë prekje nëpër trup se mos kushedi kemi marrë ndonjë plagë, sikur të kthehemi nga lufta. Hë, si thua? Bukur?

- Bukur Rub. Kur ti fillon dhe të hipën në kokë kështu si sot, unë dridhem, bëhem si i çmendur... Mjaft më, o njeri!

- Atëherë duhet ta kuptosh që unë këtë dua! Të zbulojmë edhe më shumë njëri-tjetrin. Se botën e kanë zbuluar të tjerët. Ne kemi ngelur speciet e vetme pa u zbuluar. Unë do të zhvishem lakuriq së brendshmi. Është ca e zorshme, por, pa merak, e bëj me qejf. Mund të shndërrohem edhe në një fetar të bindur, ti më njeh mirë. Kështu jam prerë. Ka filluar një botë tjetër për ne, një botë krejt e re. Kapitalizmi, fenomeni që ka ndryshuar botën! Prandaj me që jemi ende në kohë, sapo jemi zgjuar, le të hedhim hapat e duhur. Është e nevojshme, si thua?...

- Jam gati edhe unë të ngarkoj mbi shpinë njëmijenjë ikona!

- Dje kishin vjedhur kishën e Vodicës! S'i kishin lënë gjë pa marrë. Edhe gurin me kryq në oborr, që është, ti e di, aq i madh sa mezi do ta shkulte një traktor.

- E ne na mbetet t'i biem më gjunjë Shën Mërisë së Virgjër...

- Jo ne edhe lutemi, edhe veprojmë. Nuk jemi nga ata...

- Le të zhdukemi, jo vetëm po edhe me hijet tona. Unë, për vete, se ti s'di të lutesh, do t'i përgjërohëm me lot në sy Jezu Krishtit!

- E di, or mik, ti, besoj edhe drurëve iu lutesh po njëllonj.

- Edhe atë e bëj! Po të bindem se ata, drurët, kanë shpirtra s'do ta ruaja veten, do ta besoj menjëherë.

- Ç'na bëre! Fillojmë, sa të mbërrijmë te skuta jonë.

Skuta jonë ishte një restorant fushor, si një kasolle fshati, me shumë kthina e labirinte, i bërë enkas për intimitet. Po të ishe aty me njeriun e zemrës s'kishe për ta mbledhur veten as për një javë, gjaku të




bëhej ujë dhe mezi do të të mbanin këmbët! Aty ishte foleja jonë, vendi i fshehtë ku mund të rrinim veçuar nga të tjerët dhe e dinim, bota të përmbysë, s'kish për të na gjetur kush! Dhe herë-herë qeshnim: si s'më dëgjove njëherë *njëri* e, si s'më dëgjove njëherë *tjetri*!...

- Po, Krist, - më tha, - sikur e ke mendjen tek ikonat e vjedhura e të shitura, te veprat e artit, te çdo gjë me vlerë që të dhimbsej fort.

E di. I kam gjetur adresat dhe mësuesi im, mentori më mirë, Tod Mbuhuri, me përfytyrimin e allasojtë për të nesërmen,

që ia përshkonte mendimin një refleksi i hollë, e pat këshilluar që kur të mbetej vetëm në dhomë, ndoshta edhe me qirinjtë e ndezur për aromë, llambën e abazhurit te koka ose aty pranë, stilografin duke e shtrënguar fort në dorë, blloqet e shënimeve deng, shishen e bojës edhe si relikte po mbi tryezë, stilolapsat dhe lapsat sëritur afër letrave të pa shkruara që prisnin me beft, të dukej si sundues dhe kjo le ta zhgënjente ca, ta hidhëronte, se, fundja ai veç sundues i atyre sendeve ishte, po edhe i mendimit, nuk them, veç për kurr gjë tjetër... Qeshte (kishte



XHEVAIR LLESHI

endem nëpër re me tim bir

Përsiatje – si një roman

Onufri

një të qeshur të veçantë, i bëhej gropë faqja!) dhe unë nuk ngopesha me të qeshurën e tij. Tod Mbuhurin e kishim mik të dy. Epo, e di, miqësia ashtu pjek e ngjan...

E gjetëm skutën tonë. Vura në punë magnetofonin e gjetur, që unë e quaja të shenjtë dhe, për të pasur atë të gatshëm për të bërë njëmijenjë gjëra, madje të thejja edhe ikonat, në qoftë se nuk arrija gjë për atë që kisha vendosur. Për mua mbret ishte dokumenti historik, artefakti, për to respektoja si i krisur çdo lloj mendimi, edhe më të varfrin e tyre. Ato më sillnin në kujtesë mënyrën si vija në takim, si tallesha (në fakt ajo nuk qe tallje) me ndonjë mik timin që tani kish zgjidhur nga zakonet dhe qe bërë me mjekër e që mua kjo më çmendte, pasi nuk arrija dot t'ia gjeja shkakun. Atëherë, bashkë me Rubin nuk linim dy gurë bashkë, harroheshim pas verës dhe mendimeve që na rridhnin lumë. Nuk ndjenim lodhje fare, s'kishim gjumë, frymëzimi ishte aty pranë nesh, secili në vetvete kishte një bust Apoloni dhe kuptohet që na përfshinin me laçkë e plaçkë muzat, që natyrshëm flakërinin në reflekset e zjarrit tonë shpirtëror. Pikërisht kjo qe bërë një lidhëse për ne. E padukshma muzë! E bukur dhe e mahnitshme, që nuk bënte dot ndryshe pa i futur hundët tek ne. Në faqet kashtore të kasolles-restorant, me ajrin plot afshe që kryqëzonte vështrimet me efektet lozonjare të dritës në një dalldi rrëmbyese, na mblodhi të dyve sa një grusht, para fjalëve të koleksionistit dhe gazetarit (por që të dy ishim edhe koleksionistë, edhe gazetarë, si dy komplementarë të zgjedhur nga dora e fatit...). Mendimi i tij sikur nxori flatra dhe u ngrit si zë, si dritë mugu apo muzgu, si dhimbje që s'ka për t'u shëruar kurrë, si refleksi i drithëruar nga tmerrri i asaj që kish ndodhur dhe po ndodhte sot, gjithashtu edhe si dorë që shkruante e shkruante pa mbarim, duke dëshmuar për nesër, brenda këtij çasti të pambarimtë. E kish patur dhe ai një dashuri dikur, një dashuri fluturake, brenda në një shtëpi të huaj, sepse ai s'kish punë me të tjerat, vetëm me atë ndjesi drithëruese, ku vuante dhe qe gati të ngarkohej si murg, nën sundimin e sprijave të tij, që e mbytnin me hijet e tyre lozonjare e përplot sqimë, gjithnjë me një temperaturë të lartë.

Vinin dhe shkonin miq tek unë, të afërt e të largët, e një natë erdhi dhe ajo... ah... mëkati i tij! Ai kurdoherë priste një shenjë edhe prej një zogu në dritare, madje edhe prej diellit kur i hidhej sa në fytyrë, tek faqet me kashtë të kasolles. Zëri i kthjellët. Top fare. Tregonte se si një profesor i arteve kishte rënë prë e duarve të gjata, kishte çuar lloj-lloj veprë arti të kishave ose të muzeumeve dhe jetonte në llagëmet e kryeqyteteve të Evropës, i cili pasi kish studiuar jetën e Pjetrit të Madh, që donte ta imitonte sidomos ato kohë kur orgjitë e tij kishin gjetur pasqyrim edhe në familje. *Ishte koha kur Leforti pat njohur dhe futur Pjetrin në familjen e gjermanit Monso, ku jetonin dy motra, Ana që Pjetrit i pëlqeu shumë: një koketë mendjehollë dhe me sjellje të çlirtë, që gjithçka e bënte dhe që atë e tërhiqte pa masë, vesk si të saj in nuk gjeje dot askund. Madje iu zvodh e shoqja, iu largua vatrës familjare, por që sidoqoftë u detyrua të tregohej i vetëpërmbytur në të gjallë të së ëmës. Ishte koha kur punët përziheshin me shkrehjen plot zdërrhallje: në verën e vitit 1689 Pjetri e braktisi kantierin detar të Perejasllavlit, ndonëse mjeshtrë Karshiten Brandti me urdhër të carit e vazhdoi punën e nisur për ndërtimin e anijeve, madje arriti të lëshonte në det dy fregata dhe dy jahte... Ja atij donte t'i ngjante edhe heroi im. I qe tiposur dhe nuk ia shqisje dot nga mendja. Do ta ndiqte pikë për pikë dhe një ditë, mendonte, do të bëhej, pa le t'i ngjante hënës që aq shpesh e bënte krejt blu, si hije. Se drita nuk ndizet kot në shpirt...*

Mes fotografisë dhe historisë ka një ngjashmëri strukturore. Ashtu si historia, fotografia nuk i detyrohet natyrës individuale të gjërave, por u përkushtohet ngjarjeve. Ashtu si fotografia, historia është ndërmjetësja që përmbys akrepat e kohës dhe vë në të tashmen diçka nga e kaluara. Si njëra edhe tjetra ndajnë sëbashku, si në një pasqyrë të pastër, refleksin transparent të botës në një proces modest, duke vënë në pah objektin e zgjedhur, ndërhyrjen në opsione, në shpejtësi dhe thellësi, në kuadrim dhe ndriçim. Konkluzionet e kësaj homologjie strukturore të historisë dhe fotografisë përjashtojnë çdo qasje tjetër, përveç asaj historike, sepse te fotografia gjendet një terren i favorshëm për të shpjeguar figura, kronika dhe ngjarje historike.

Në teori, fotografia është strukturalisht historike dhe çdo fotografi, për nga natyra, është "histori". Duke u dhënë një formë tangente fakteve, fotografia fabrikon dokumentin, lëndën e parë të historisë. Ajo regjistron elementet nga e kaluara, një gjest, një çehre, një grimasë, një tension, edhe pse spontaneiteti i çastit fikson veçse një pozë të shkurtër.

Imazhi dhe, para së gjithash, fotografia spontane e çastit, e realizuar si kapje nga fluksi i lëvizjes së përhershme, është modeli përfaqësues i një realiteti të zhdukur dhe tregon raportin tonë me të kaluarën. Ky raport i ndërprerjes bashkon më të largëtën me më të afërtën, duke i vënë ballë për ballë. Atëherë kërkohet një punë e gjatë plot erudicion dhe durim për të përfunduar anketimin dhe rindërtimin e një objekti historik, një fakti, një momenti, një epoke, një njeriu, një grupi, me gjithë forcën që përfaqëson. Ndërhyrja e fotografisë në realitetin historik është e ngjashme me manipulimin e së kaluarës nga historiani.

Midis veprave teorike që i kushtohen fotografisë, vepra e Roland Barthes-it "La Chambre claire", e publikuar më 1980, është më e lexuara dhe më e cituara, e cila ka kontribuar gjithashtu edhe në modifikimin e perceptimit të mediumit. Sigurisht që jehona dhe popullariteti i ideve të shprehura në këtë vepër shpjegohen po të kemi parasysh autoritetin intelektual të Roland Barthes-it, që shquhej për refleksionet e thella teorike në këtë fushë të krijimtarisë artistike.


Duke e ftuar lexuesin në kërkimin ontologjik të fotografisë, semiologu Roland Barthes, me një tonalitë vetjak, ndërton një ese familjare, ku vdekja e nënës së tij luan një rol kryesor. Vepra dallohet nga kombinimi i një pyetësori esencialist me komentet e bëra për vepra dhe autorë të njohur dhe të frymëzuar nga kritika e artit. Roland Barthes-i e shikon praktikën fotografike si një të tërë të vetme të bashkuar dhe kërkon themelet në një estetikë të veçantë që karakterizohet nga një fenomenologji e gjurmës, e parakuptuar të ruajë në kohë pasqyrimin e një realiteti të kaluar.

Kjo tezë gjeti jehonë në punimet e kritikes së artit amerikan, Rozalind Krauss, ose, më tej, në ribotimin e artikujve të filozofit gjerman Walter Benjamin. Kjo konvergencë, që bashkon për herë të parë autoritetet e njohura akademike ose të kritikës, krijoi një entuziazëm në mjediset e specializuara.

Por propozimi më i shquar është fiksimi i momentit artistik të kapjes artistike, sipas formulës "kjo ka qenë", formulim që lindi duke u nisur nga fotografia e nënës së autorit, për të cilën

ROLAND BARTHES-I DHE ANTROPOLOGJIA E IMAZHIT FOTOGRAFIK

nga Xhyher Cani, Phd



ajo tërësi fjalësore është karakteristika kryesore e dispozitivit fotografik që nuk mohon dot se "gjëja ka qenë aty".

Fotografia të magjeps me guximin për të pasqyruar të vërtetën, të hipnotizon me fuqinë e saj natyrore të autenticitetit. Ky efekt i reales, sipas shprehjes së Roland Barthes-it, ngjan të realizohet në një konsensus të gjerë, sa në opinionin popullor, aq edhe te teoricienët e fotografisë. Duhet thënë, se rryma të ndryshme mendimi kanë qenë interesuar në mediumin e realizimit dhe kanë kontribuar gjerësisht në forcimin e idesë që fotografia nuk mund të mendohet jashtë lidhjeve të forta që e bashkojnë me realen.

Që në faqet e para të "La Chambre claire", Barthes-i pohon, në fakt, mbizotërimin e referuesit në refleksionin e fotografisë. Barthes-i e përkufizon referuesin fotografik, si një indicie reale dhe të brendshme, me të cilën fotografia është përfaqësuar dhe të cilën e bart njëherazi. Shkurt, referuesi aderon dhe është pikërisht ky aderim që ngjizet në shpirtin e shikuesit, duke përfutur bindjen, se objekti i fotografuar ekziston realisht dhe, duke e emërtuar me grupin e fjalëve, të njohura tashmë në historinë e fotografisë si formula "kjo ka qenë", një lloj konkretizimi i së kaluarës, i një realiteti dhe i së vërtetës që ndërtohet në sytë tanë. Logjikisht, kjo përsiatje takohet në të gjitha imazhet e prodhuara realisht. Ajo çka fotografia riprodhon në pambarim, ndodh veçse një herë; ajo përsërit mekanikisht, por nuk mundet kurrë të përsëritë esencialisht.

Barthes-i kishte gjithçka për të qenë një antropolog dhe, padyshim, që në thelb ai ishte, edhe pse nuk e kishte identifikuar veten në këtë profil

studiuesi. Nga ana tjetër, Barthes-i, duke vëzhguar me saktësi të përpiktë, zotëronte, si shumë antropologë, fuqinë e interpretimit dhe përfaqësimit të këtij vëzhgimi, në veçanti për imazhin fotografik.

Duke vëzhguar me kujdes fotografitë e shtypit, Roland Barthes-i zbulon në "La Chambre claire" që ekzistojnë dy nivele leximi të imazheve. Niveli i parë identifikohet nëpërmjet një kahjeje të shfaqur që vërtetohet nga legjenda e fotografisë, të cilën semiologu e quan "Studium"; dhe niveli i dytë, që Barthes-i e quan "Punctum".

Në radhë të parë, refleksionet e Barthes-it mbi fotografinë janë kërkime mbi "domethëniën" në fotografi, një lloj pyetësori mbi "Studium-in" rreth kësaj maske kulturore që çdo fotografi ofron dhe të cilën Barthes-i përpiktë ta zbulojë dhe ta shpjegojë. Pastaj do të vijë kërkimi i "domethënieve" së esencës së fotografisë, të "Punctum-it", duke kërkuar përkufizimin në fotografi të këtij detaji domethës.

Studimi i fotografisë ngjan me studimin e një terreni të dijes dhe kulturës që kërkohet ta shqyrtojmë dhe njohim. Imazhi i fotografisë vjen e na inkorporohet si afeksion apo një si një "detaj" që na "plagos" por, më së shumti, na emocionon dhe na magjeps. Ky kategorizim i dyfishtë barthesian transpozohet në fushën e antropologjisë si koncept dikotomik mes asaj "se çfarë paraqitet në intelektin tim" dhe, nga ana tjetër, "se çfarë ofrohet në afeksionin tim".

Në mënyrë lapidare Barthes-i përmbledh dallimin mes "Studium-it" dhe "Punctum-it", duke pohuar, në fakt, se pjesa më e madhe e fotografive kuptohet në sajë të dijes mbi të.

"Studium-i" në një fotografi përmbledh elementet që lejojnë një spektator të njohë subjektin dhe estetikën e fotografisë. "Studium-i" gjithmonë është i koduar në funksion të një kulture të mëparshme, dhe kjo kulturë që zbulon "Studium-i", shpreh një kontratë të realizuar mes krijuesit dhe konsumatorit. Ndërsa fotografitë e pajisura me "Punctum", pasqyrohen me elemente të paparashikueshme, që e "godasin" spektatorin dhe e emocionojnë personalisht në funksion të sensibilitetit të tij. Barthes-i thotë se për të parë mirë një fotografi "duhet ngritur koka dhe duhen mbyllur sytë", duke ruajtur kështu në kokën tonë imazhin fotografik, me nota afektive, por gjithashtu intelektuale.

Fotografët mund të na japin një qasje të jetëve të kaluara, të ngjarjeve të largëta apo vendeve të harruara. Ata mund të na ndihmojnë të kuptojmë kulturën, historinë dhe identitetin e personave që paraqesin. Fotografia ndërton një marrëdhënie të privilegjuar me kohën dhe na shërben për të kujtuar dhe celebruar, si garanci kundër një kujtesë të dobët që deformon sendet dhe ngjarjet, duke i transformuar apo fshirë ato pjesërisht apo tërësisht.

Në fakt, përdorimi i fotografisë, me atributin e ndërtimit të së kaluarës, nuk ka vertetësinë e kujtesës së përsosur. Fotografia thërret, aderon, asociohet përmes një ekspansioni të imazhit më shumë se ripërtërin të kaluarën. Ajo luan rolin e saj në bashkëshoqërimin e imazheve të së kaluarës dhe ndan kujtimet, duke nënvizuar pafuqinë tonë në raport me kohën që rrjedh papushim.

Imazhi fotografik është një objekt, ku vijnë e takohen, artikuloohen ose përplasen sipas rrugëve të ndryshme, pulsua memorial dhe kërkimi i identitetit. Njohja e imazhit të vetes, si një imazh me objektivitet të sigurtë, zbulon një imitim teknologjik. Kështu, në rastin e portretit, fotografia shihet me pasojat përbërëse të vetë gjinisë (gjykimi estetik dhe moral që sjell), kur ajo vetë nuk është veçse një gjurmë fizike dhe kimike, realizuar nga një proces optik dhe mekanik. Kjo është arsyeja për të cilën te Barthes-i fotografia zotëron një status njëherazi të privilegjuar dhe problematik.

Regjimi semiotik i përgjithshëm i imazhit fotografik evidentohet në mes të një tensioni që ndërhyr në shume nivele. Në nivelin e aksionit kohor të imazhit, ky tension virtual shfaqet mes raportit të pranisë ikonike aktuale dhe thellësisë së të kaluarës. I njëjti tension gjendet në nivelin e strukturimit të imazhit, që varion mes fushës pothuajse perceptivë dhe figuracionit ikonik.

Pikërisht ky tension shpjegon karakterin kontradiktore të raportit të fotografisë me kohën që shfaqet në dy pole: në atë tregues dhe në atë ikonik. Pjesa më e madhe e fotografive variojnë midis dy poleve të përshtkruara dhe Roland Barthes-i tenton pikërisht këtë status semiotik, në të njëjtin kohë tregues dhe ikonik, si një alternativë e pastër, ku imazhi fotografik tenton herë në kahjen nostalgjike të së kaluarës së humbur, dhe herë drejt sublimes jashtë kohës.

Në analizën barthesiane ngjan i parapëlqyeshëm imazhi fotografik, si rikrijim i çastit, si një përvojë e kohëzgjatjes, si një transpozim në hapësirën e kuadrar me tensione të shumëfishta kohëzgjatjeje, cilësisht të dallueshme, në një dukuri të quajtur "polikronizëm".

Gjithashtu, Barthes-i përkufizon dritën në të njëjtën kohë në dimensionin ontologjik dhe në atë fizik. Ai kujton që

drita nuk ka të njëjtin funksion në pikturë dhe në fotografi, madje **në fotografi drita është një dukuri fiziko-kimike**, që lidh hapësirën dhe kohën me një dritë të ngjashme me pulsmin e largët të yjeve.

Dëgjojmë shpesh të flasin për një lexim të fotografisë dhe ky lloj formulimi nuk na shokon. Por çfarë do të thotë të lexosh një fotografi ose, më thjesht, çfarë do të thotë leximi i një imazhi. Aksi i paradigmes linguistike në tematikën e shenjës së fotografisë është një përjasje e Barthes-it në gjithë rendin kronologjik të veprës së tij, duke filluar nga *“Mythologies”* (1957), pastaj *“Le message photographique”* (1961), *“Rethorique de l’image”* (1964) dhe, **së fundi, në “La Chambre claire”**(1980).

Për filozofin dhe semiologun Barthes një fotografi “është një mesazh që në nisje nuk ka kod të domethënies së veçantë”. Mesazhi i fotografisë zhvillohet më pas, në një formë të tillë që ai merr një domethënie kur pajiset me “referuesin”. Në fillim, shpjegon Roland Barthes-i, qëllimi i fotografisë është të na furnizojë një dokument *brut* dhe real. Duke u thelluar pak më tej vërejmë se ka një shumicë domethëniesh të dyta që shoqërojnë dhe skicojnë një mitologji të përgjithshme të kohës tonë. Një imazh është polisemik, kujton Barthes-i, dhe ka shumë kuptime, por duhet mësuar që këtë polisemi ta lexojmë me shpirt kritik. Ne mund të dallojmë dy tipa perceptimi: imazhi si support dhe imazhi si referent. Në optikën e këtyre dy nocioneve, Roland Barthes-i do të saktësojë me terma latine përvojën e imazheve fotografike. Nocioni i parë *“Studium-i”* shënon perceptimin global të gjithësecilit për objektin e përfaqësuar. Spektatori do të njohë në imazhin fotografik një interes të lidhur me një tematikë të shënuar kulturalisht. Pikërisht në *“Studium”* unë interesohem për fotografitë, qoftë kur i marr si dëshmi politike, qoftë kur i përveçtoj si tablo historike, sepse kulturalisht unë marr pjesë në figurat, në minierat, në gjestet, në dekorat, në aksionet, nënvizonte Barthes-i.

Nocioni i dytë i emërtuar *“Punctum”* vjen e “thyen” nocionin e parë; spektatori kalon nga një tërheqje tërësore **në një vëmendje të detajuar të objektit të përfaqësuar.** *“Punctum-i”* është një detaj që nuk përthithet në një perspektivë tematike ose në një efekt të qëllimshëm dominant, por ky detaj shënon një gjurmë që “shqetëson” tonalitetin estetik të përgjithshëm të imazhi dhe kapet në menyrë të ndjeshme nga ai që e percepton. Detaji i *“Punctum-it”*, “të shpon, të ther, të vret”. Megjithatë *“Punctum-i”* nuk kapet menjëherë me një shikim. Ai zbulohet nga spektatori, kur ai pushon së shikuari ose zhvendos shikimin e tij. Zhvendosja e shikimit e bën më të vëmendshëm spektatorin përballë kuptimit domethënës të imazhit. Ndërkohë që *“Studium-i”* shfaqet në një hapësirë që zbërthen tiparet domethënese të imazhit, *“Punctum-i”* zbulon në menyrë të ndjeshme jashtëfushën e fotografisë.

Në pjesën e dytë të *“La Chambre claire”*, Roland Barthes-i vijon refleksionet, duke evokuar përvojën e zizë të vdekjes së nënës së tij. Përballja me imazhin e së ndjerës kthehet në një suport të një refleksioni në marrëdhëniet mes vdekjes dhe imazhit fotografik. Fotografitë arrijnë në identifikimin e nënës, por jo në gjetjen e thelbit të saj, se çfarë ishte ajo vetë. Perceptimi i fotografisë korrespondon atëherë me një punë dinjitoze të Sizifit. Kërkimi i thelbit të genies së dashur

në këtë përqendrim shpirtëror është i kotë, prandaj duhet rifilluar papushim. Unë e rinjoha ndryshueshmërisht, por jo esencialisht, pohon Barthes-i. Fotografia më detyron të futem në një punë të dhimbshme me tendencë drejt identitetit të saj, **në mjedisin e imazheve pjesërisht të vërteta dhe totalisht të rreme**, konkludonte Barthes-i.

Kjo përvojë e lejoj atë të rivijë në nocionin e *“Punctum-it”* dhe jo të reagojë me një detaj, por me atë që Barthes-i do ta emërtojë *“noemë”* të fotografisë; me terma të tjerë, thelbi i imazhit specifik në një fotografi. *“Noema”* vërteton se kush ishte i fotografuar. Fotografia nuk thotë domosdo se kush nuk është më, por vetëm, sigurisht, se kush ka qenë. Kështu nocioni i *“noemës”* do të çojë në vërtetimin e imazhit të ekzistencës së referuesit. Roland Barthes-i dallon kështu gjuhën nga fotografia, për faktin se fotografia vërteton në menyrë të pakundërshtueshme një referues të së kaluarës; dhe, **në përmbledhje**, fotografia është vetë auto-identifikimi.

Një gjuhë është një funksion komunikimi, ku kufijtë janë të përcaktuar nga shoqëria, kultura dhe shija mbizotëruese. Ky komunikim implikon një kod, një sistem shenjash të përbashkëta dhe të përsëritura. Shenja linguistike është një imazh akustik i bashkuar me një domethënie, domethënë me një koncept. Në rastin e gjuhës njerëzore, shqiptimi i shenjës linguistike parakupton një qëllim paraprak ose domethënës. Barthes-i evidenton një element që themelon një pjesë të interesit shpjegues në fotografi, siç është *“Studium-i”*, që ka në themel të tij një mesazh social dhe kulturor.

Në këtë optikë mund ta shohim fotografinë si një vektor për të shprehur një mendim. Në rezonancë me këtë refleksion, Barthes-i e shikonte fotografinë si bartëse të një mendimi që e shtyn spektatorin të reflektojë në etapën e *“Punctum-it”*. Në fakt, jashtë çdo kodi linguistik shoqërisht

të përcaktuar, *“Punctum-i”* zbulon lëvizje të subjektivitetit, ai prek unin e receptuesit. Ky kapërcim i kodit në sajë të *“Punctumit”* zbulon një potencial komunikativ të fotografisë, që përmbys fushën e komunikimit gjuhësor.

Konceptimi i Barthes-it mbështetet fillimisht në njohjen e kushteve teknike të fotografisë në gjysmën e dytë të shekullit XX. Fotografia është një teknikë e kapjes të rrezeve të dritës të emetuara nga një objekt real dhe ridërgimin e këtyre rrezeve të dritës deri te syri i spektatorit. Në këtë frymë perceptivë, referuesi vihet në praninë e së kaluarës.

Imazhi dokumentar prodhon një lloj sensacioni të dokumentit. Fakti që një burim i një ngjarjeje gjendet në histori dhe jep iluzionin marramendës “se prek realen”, është në kontekstin e leximit dokumentar. Fotografia, si çdo dokument arkivor, fikson një gjendje nga e kaluara, një stopim të kohës më shumë se një transferim të realitetit. Siç tregon përdorimi krijues i imazheve të regjistruara, perceptimi i përmasave arkivore, edhe pse mund të jenë të mundura, nuk janë të imponuara nga natyra dhe forma e tyre. Ky lexim historik kërkon një mobilizim të informacionit kontekstual që nuk varet nga dokumenti si i tillë, por nga raporti që ndërtohet me të në funksion të ngjarjeve të mëpasme.

Përfundimisht, duke analizuar emocionin e përjetuar para disa fotografive, Roland Barthes-i aplikon tri lloje praktikash në tri këndvështrime; atë të operatorit (fotografit), të spektatorit (ne që shikojmë) dhe spectrum-it (objekti i fotografuar) që korrespondon me tri aksione: të realizosh, të shikosh dhe të provosh. Duke mos qenë fotograf, autori nuk e konsideron perceptimin e operatorit, por përqendrohet mbi dy aspektet e tjera dhe kryesisht mbi atë të spektatorit, të cilin tenton ta kuptojë dhe ta shpjegojë përmes dy akteve kryesore që konçidojnë pothuajse me dy pjesët e librit. Pjesa e parë

ndërtohet përmes një eseje paraprake dhe të përgjithshme, bazuar mbi emocionin, përmes nocioneve të *“studium-it”* dhe *“punctum-it”*, ndërsa pjesa e dytë është më vetjake dhe evidenton esencën e vërtetë të fotografisë në një kërkim prustian, duke u përqendruar në dukurinë e “noemës”.

Teoria esencialiste e Barthes-it e shenjon fotografinë si realizim të plotë të fatit të imazhit, ku Barthes-i nuk kërkon të hartojë një teori universale të fotografisë, por të ndajë me ne zbulimet e tij. Barthes-i ndërthur refleksionin intelektual dhe sensibilitetin e tij vetjak, duke e veshur gjithë veprën e tij mbi fotografinë me petkun e dijetarit me efekte emocionale dhe humaniste. *“La Chambre claire”* është një vepër e veçantë që prek zemrën e përvojës njerëzore të fotografisë. Barthes-i, përmes veprës së tij të qartë dhe emocionuese, na fton të reflektojmë jo vetëm mbi imazhet që shohim, por gjithashtu edhe mbi ato që bartim, ato që vazhdojnë të na magjepsin edhe pasi i kemi parë.

Post scriptum

“[.....]Por, një mbrëmje nëntori, pak kohë pas vdekjes së nënës së tij, Barthes-i rregulloi fotografitë”

Ai gjeti një fotografi të fëmijërisë së nënës së tij, të vitit 1898, në të cilën shkroi me shkronja të mëdha, duke e titulluar simbolikisht: **Fotografia e Kopshtit të Dimrit.**

Kjo fotografi paraqiste nënën e tij pesë vjeçe, me një fytyrë, ku shfaqej ëmbëlsia e saj, bukuria dhe pafajësia, çka e bënin fotografinë unike. Për të “rigjetur” nënën e tij të dashur, atij i duhej të ngjitej në kohë, në realitetin që ai kishte jetuar, kur ajo ishte e plakur, e dobët dhe e sëmurë. Në këtë kontekst, figura e saj tjetërsohet në imazhin e religjiozes dhe mbretëreshës, e poeteshës apo gruas hyjnore.

Është pikërisht kjo **Fotografi** që bëhet udhërrëfyese i librit dhe do ta udhëheqë Barthes-in për të reflektuar mbi esencën dhe karakterin e artit të fotografisë.

Duke mos pasur asnjë fotografi të nënës së tij të plakur, Roland Barthes-i tregon këtë portret, të fotografuar nga Felix Nadar-i, i cili nuk dihet, gjithsesi, nëse është ai i nënës apo gruas së fotografit. Imagjinata dhe “pasaktësia” riprodhon kështu imazhin e nënës së munguar nga ikja e saj. Sipas Barthes-it, është “njëra nga fotografitë më të bukura në botë” ...

... dhe Roland Barthes-i vendosi këtë legjendë:

“Kush është, sipas mendimit tuaj, fotografi më i madh në botë? – Nadar-i.”

Bibliografi e konsultuar
Roland BARTHES, La Chambre claire. Note sur la photographie, Paris, Éditions de l'Étoile/Gallimard/Seuil, 1980.

Roland BARTHES, *Mythologies*, Paris, Seuil, 1957.

Roland BARTHES, *Réthorique de l’image*, Communications, 1964.

Roland BARTHES, *Le Message publicitaire*, in *Œuvres complètes*, tome 2, Paris, Seuil, 2002.

Roland BARTHES, *L’effet de réel* [1968], *Le Bruissement de la langue. Essais critiques IV*, Paris, Seuil, 1984.

Roland BARTHES, *Le discours de l’histoire* [1967], *Le Bruissement de la langue. Essais critiques IV*, Paris, Seuil, 1984.

Roland BARTHES, *Creatis*, Revue photographique, nr. 4, 1977.

Susan SONTAG, *La Photographie* (1977), trad. de l’américain par G.-H. Durand et G. Durand, Paris, Seuil, 1979.

Walter BENJAMIN, *Petite histoire de la photographie* (1931), trad. de l’allemand par A. GUMBERT, *Études photographiques*, n° 1, novembre 1996.





Karikaturë nga Arben Mexsi